

FGJH

REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS



2/2020

Botohet për herë të dytë në qershor 2020

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

E-mail: redaksia_fgjh@fgjh.edu.al

www.fgjh.edu.al

©Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, në bazë të ligjit nr. 9380, dt. 28.04.2005 të shtetit shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, transmetohet apo përdoret me asnjë formë a mjet pa lejen me shkrim të botuesit. Punimet e paraqitura në këtë botim shprehin mendimet dhe qëndrimin personal të autorëve. Redaksia nuk mban përgjegjësi për pikëpamjet e autorëve në shkrimet e tyre.

ISSN 2664-7346

BORDI EDITORIAL

Drejtor i Përgjithshëm

Prof. Dr. Artur SULA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Kryeredaktore

Dr. Viola ADHAMI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktore shkencore

Prof. Asoc. Mirela PAPA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Redaktorë

Prof. Asoc. Maklena NIKA (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

Dr. Albert SHEQI (Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)

BORDI SHKENCOR

Prof. Dr. Maks DAIU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Elida TABAKU

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Viktor RISTANI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Sofia DELIJORGJI

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Dr. Brikena KADZADEJ

(Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës)

Prof. Asoc. Lindita SEJDIU-RUGOVA

(Fakulteti i Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Prof. Enrico LUSSO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Marco NOVARINO

(Fakulteti i Gjuhëve dhe Letërsive të Huaja dhe Kulturave Moderne, Universiteti i Torinos, Itali)

Prof. Dr. Ahmet GÜNŞEN

(Fakulteti i Letërsisë, Universiteti Trakya, Turqi)

PËRMBAJTJA

ARTIKUJ

5

Kalke togfjalësore dhe sintaksore
në gjuhën shqipe
Brunilda Dashi

17

Bilinguizmi: Nga fëmijëria në
moshën madhore
Aida Zoto

30

Mësimi i gjuhëve të huaja në shkollat
shtetërore të Shqipërisë
Alva Dani

48

Prirje hermetike dhe përkime letrare mes
Zorbës dhe Ungaretti-t
Flavia Kaba

56

A janë përkthyesit profesionistë specie në
zhdukje për shkak të teknologjisë?
Anna Maria Vasili

65

Implementimi i materialeve autentike në kurset e gjuhës së huaj
tekniko-shkencore dhe teknikat që ndihmojnë në përvetësimin e
elementëve të saj gjuhësore
Sonila Piri
Enkela Dalipi

79

Rëndësia e dosjes për vlerësimin e nxënësve në
gjuhë të huaj
Emilda Roseni
Miranda Ereni

89

Vendi i greqizmave në terminologjinë shkencore
Entela Vouliu

96

Vëzhgime mbi fjalët vendëse dhe sivendëse në
shqipe, të pasqyruara në fjalorët shqip-rusisht
e shqip-anglisht
Eda Shehu

107

Kontributi i alfabetit dhe i fjalorit të «bashkimit»
në lëvrimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe.
Marinela Prifti

124

LIBRA TË RINJ SHKENCORË

130

AKTIVITETE SHKENCORE NË
FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA

KALKE TOGFJALËSORE DHE SINTAKSORE NË GJUHËN SHQIPE

Prof. Brunilda Dashi

Departamenti i Letërsive dhe Kulturave moderne
Fakulteti i Letërsisë dhe i Filologjisë
Sapienza Universiteti i Romës, Itali
E-mail: brunilda.dashi@uniroma1.it

PËRMBLEDHJE

Ky studim analizon kalket togfjalësore dhe sintaksore në gjuhën shqipe të frymëzuara nga modele të gjuhës italiane. Meqenëse huazimi dhe kalku janë dy fenomene gjuhësore të mëvetësishme, që aktivizohen natyrshëm në kushtet e ndërndikimit të gjuhëve në kontakt, paraqitja e shkurtër dhe përqasja e tyre në këtë punim synon të nxjerrë në pah arsyet që e shtyjnë shqipfolësin të kalojë nga fenomeni i rëndomtë i huazimit të leksemave të modelit tek ai, më kompleks, i përkthimit të tyre me material gjuhësor vendës, duke respektuar strukturën dhe semantikën e gjedhes. Përgjithësisht dukuria e kalkut është prodhimtare në shqipe dhe paraqet një gamë të gjerë lentimi, ku nuk mungojnë risitë kategoriale që nuk sugjerohen nga modeli por që diktohen nga historia e vetë gjuhës amtare. Në krahasim me tipologjitë e tjera të kalkeve strukturore, kalket togfjalësore dhe sintaksore, për shkak të specifikës së formimit e të përdorimit të tyre, përbëjnë kategorinë më pak të lëvruar të këtij fenomeni të ndërndikimit gjuhësor. Ndeshen kryesisht në organet e shtypit e në televizion dhe nuk janë regjistruar në fjalorët shpjegues, pra nuk janë pranuar nga norma letrare. Sidoqoftë, kalket togfjalësore të përmendura në këtë studim po bëhen gjithmonë e më të pranishme në shqipe, disa prej tyre hasen shpesh në përditshmërinë e shqipfolësve, ndërsa kalket sintaksore janë vërtet sporadike. Hulumtimi i këtyre kalkeve vë në dukje veçoritë dhe përshtatshmërinë e lentimeve, ndërkohë synon të jetë dëshmi në të ardhmen e qëndrueshmërisë së tyre në gjuhën marrëse. Fjalët celës: huazim, kalk, leksemë

ABSTRACT

The following study analyzes syntagmatic and syntactic calques in the Albanian language under the influence of Italian linguistic models. In view of the difference between linguistic borrowings and calques, both of which activate naturally within the mutual influence of languages in contact with one another, a brief presentation of these phenomena is illustrated in this research paper along with a comparison of the two. The study's purpose is to highlight the reasons leading the Albanian speaker to shift from the ordinary phenomenon of a linguistic borrowing to a more complex one, namely the translation of foreign lexemes with the aid of native linguistic material, while preserving the structure and the semantic meaning of the foreign models. Overall the appearance of calques proves to be fruitful in Albanian and offers a wide range of new words

that do not lack linguistic innovations not deriving from the foreign model, but from the history of the receiving native language. When dealing with linguistic influence among languages, the syntagmatic and syntactic calques, unlike other types of structural calques, represent the most neglected field. The press and television broadcasting are the media where these phenomena are commonly found, yet these words are not registered in explanatory dictionaries. Hence, they are not accepted by the literary norm. Nonetheless, the syntagmatic calques presented in this paper are becoming increasingly current in the Albanian language. Some of them can be found in the day-to-day life of Albanian speakers, whereas other syntactic calques are indeed sporadic. The examination of these lexemes demonstrates the peculiarities and the adequacy of these linguistic creations, and at the same time it intends to become a future account of their stability in the receiving language. Keywords: borrowing, calque, lexeme

1. Ndërndikimi gjuhësor: huazimi dhe kalku

Në rrethana ndërndikimi gjuhësor midis popujve me një traditë shumëshekullore marrëdhënies historike dhe kulturore¹, rrjedhoja e parë është huazimi i zërave nga gjuha që perceptohet me prestigj kulturor më të lartë, dhe, në rastin tonë, kjo gjuhë identifikohet me italishten. Huazimet italiane, tashmë në numër të konsiderueshëm², shpesh janë të nevojshme sepse plotësojnë mangësi leksikore të gjuhës shqipe; mosprania e konkurrentëve në gjuhën marrëse e ndihmon shumë qëndrueshmërinë e italianizmave. Prurje të tilla, sidoqoftë, nuk parashikojnë një njohje të thellë të gjuhës model. Ky nivel njohjeje i gjuhës së huaj mbetet gjithnjë sipërfaqësor dhe shqipfolësi mjaftohet me një vjelje thjesht leksikore për të plotësuar nevojat e tij.

Ndodh shpesh që shqipfolësi, nisur nga pozitat e një niveli më të lartë të njohjes së italishtes, të arrijë të identifikojë përbërësit e fjalës italiane dhe të përpiket t'i përkthejë ata me gjegjësin e shqipes, duke krijuar një fjalë të re me material gjuhësor vendës, që respekton strukturën dhe semantikën e modelit.

Aktivizohet kështu, në kushtet e ndërndikimit gjuhësor, dukuria tjetër 'më e rafinuar dhe omplekse'³ se huazimi (designazione), fenomeni i kalkut gjuhësor (significazione). Nëse huazimi presupozon disnivel kulturor midis dy gjuhëve në kontakt, kalku, pra shqipërimi, tregon se gjuha marrëse ka material gjuhësor gjegjës me potencial imitues lentimi, prandaj ulet dukshëm disniveli midis gjuhëve në kontakt.

- 1 Khs. P. Di Giovine, Un millennio di storia linguistica albanese: l'influsso lessicale della lingua italiana, «L'Italia dialettale», rivista di Dialettologia italiana, vëll. LXIX (Seria e Tretë, V), Edizioni ETS, Pisa 2008, ff. 107-139.
- 2 Khs. B. Dashi, Italianismi nella lingua albanese, Dipartimento di Scienze documentarie, linguistico-filologiche e geografiche, Sapienza Università di Roma, Centro di Studi albanesi, Edizioni Nuova Cultura, Roma 2013.
- 3 Khs. M. Fanfani, Calchi, në Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano, vëll. I, Istituto dell'Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma 2010, f. 164.

Motivimi i shqipfolësit është për t'u lavdëruar, sepse zëri i ri pasuron inventarin leksikor të gjuhës amtare. Dhe me të vërtetë, puna e çmueshme e formimit të fjalëve të reja të kësaj tipologjie ka edhe shtysën e leksikut italian.

Përdorimi i materialit gjuhësor vendës, që mishëron strukturën dhe semantikën e gjedhes, e bën neologjizmin pothuajse të padallueshëm nga lentimet e mirëfillta brenda gjuhës; prandaj dhe veçori e këtyre leksemave-kalk, qofshin edhe komplekse, është vështirësia e dallimit nga simotrat vendëse.

Kalku është një fenomen gjuhësor i hershëm në gjuhën shqipe dhe akoma pak i hulumtuar⁴. Ai dëshmohej që në tekstet e para letrare, duke filluar nga Buzuku, sepse vetë tipologjia e shkrimeve të shek. XVI-XVII - përgjithësisht, përkthime - e ka lehtësuar ndjeshëm aktivizimin e kësaj dukurie, që ka arritur një lëvrim maksimal në pesëdhjetëvjeçarin e fundit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasurimin e leksikut të shqipes. Fenomeni gjuhësor është më i përhapur nga sa mund të mendohet dhe identifikimi i kalkeve nuk është gjithmonë i thjeshtë e i parashikuar.

Sipas skemave të pranura nga studiuesit e fenomeneve të ndërndikimit⁵, për lehtësi klasifikimi, kalket ndahen në kalke strukturore dhe kalke kuptimore (semantike). Nga ana tipologjike kalket strukturore mund të jenë kalke fjalësh të prejardhura ose të përbëra, gjysmëkalke (semicalchi) dhe kalke hibride.

Një grup më vete kalkesh strukturore përbëhet nga kalket frazeologjike. Duhet thënë qartë se kategoria e kalkut frazeologjik nuk është e nevojshme në gjuhën marrëse, nuk plotëson mangësi leksikore dhe nuk e pasuron inventarin e saj leksikor, por përbën një prurje të arsyeshme dhe të përshtatshme, do të thoshim, që gjuha të zhveshë petkat e provincializmit dhe të modernizohet si simotrat evropiane, aq më tepër nëse këto togje fjalësh, të hyra në shqipe nëpërmjet italishtes, kanë përdorim ndërkombëtar.

Strategjitë e ndryshme të realizimit të kalkut, sipas specifikave të gjuhëve në kontakt, i nxisin studiuesit, për lehtësi analizimi, të përcaktojnë nënndarje të tjera kategoriale: nga mënyra e realizimit, kalket strukturore mund të jenë kalke të përsosura (calchi

4 Për një bibliografi thelbësore të studimeve të dukurisë së kalkut në gjuhën shqipe khs. E. Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, vëll. I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1982, ff. 117-127, me një bibliografi të shkurtër në f. 121, shënimi 1; N. Topalli, Kalke njësisish frazeologjike, «Gjuha jonë», Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1988, n. 2, ff. 53-58; F. Leka, A proposito degli italianismi nell'albanese, në Albanistica novantasette, a cura di I. C. Fortino, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale - Istituto Universitario Orientale, Napoli 1997, ff. 26-28. Për një histori të shkurtër të fenomenit të kalkut në gjuhën shqipe dhe për një klasifikim tipologjik të kalkeve khs. dhe B. Dashi, I calchi linguistici nella lingua albanese. I calchi strutturali, në «Bollettino di Italianistica», Rivista di critica, storia letteraria, filologia e linguistica, n.s., anno XII, n. 2, Carocci, Roma 2015, ff. 77-116; B. Dashi, I semicalchi strutturali e i calchi strutturali ibridi nella lingua albanese, në «Linguistica e Letteratura», XLII, 1-2, Fabrizio Serra editore, Pisa – Roma 2017, ff. 269-290; B. Dashi, Calchi fraseologici nella lingua albanese, në «Bollettino di Italianistica», n.s., anno XIV, n. 1, Carocci editore, Roma 2017, ff. 108-124.

5 Për këtë argument khs. bibliografinë e cituar nga R. Gusmani, Saggi sull'interferenza linguistica, vëll. II, Le Lettere, Firenze 1983, ff. 4-5; M. Fanfani, Calchi cit., ff. 164-165.

perfetti), pra të rikrijojnë me përpikëri strukturën dhe semantikën e modelit në gjuhën marrëse dhe kalke jo të përsosura (calchi imperfetti), kur nuk arrijnë të përsërisin, për arsye të ndryshme, modelin origjinal.

Grupi i fundit tipologjik i kalkeve strukturore përmbledh kalket, që do t'i quajmë, togfjalësore (sintagmatici) dhe kalket sintaksore, objekt vëzhgimi i kësaj trajtese të shkurtër.

2. Kalket togfjalësore

Kalket togfjalësore kanë si strukturë bazë lentimi një togfjalësh të gjuhës model. Veçoria kryesore e këtij togfjalëshi është pavarësia e gjymtyrëve të tij. Ky është dhe dallimi thelbësor me kalket frazeologjike, që janë togfjalësha të barasvlershëm me njësi leksikore, prandaj dhe studiohen sikur të ishin fjalë të vetme, si zëra në fjalor.

Shqipfolësi nuk përkthen në gjuhën e vet çdo lloj togfjalëshi të gjedhes. Vëmendja e tij tërhiqet nga togje fjalësh që i konsideron “të veçanta”, që nuk i ka në gjuhën e vet, por që ka dëshirë t'i përdorë në kontekste specifike. Ndërkohë vëren se këto togje shkruhen a citohen shpesh bashkë dhe i percepton sikur të jenë shprehje të mirëfillta, pra, njësi frazeologjike. Në të vërtetë, në italishte, këto lloje sintagmash nuk klasifikohen në fjalorë si shprehje idiomatike a lokucione⁶, por shpjegohen si një kombinim i dy a më shumë fjalëve, që përdoren shpesh bashkë, saqë mund të konsiderohen si gjymtyrë të lidhura, d.m.th. gjymtyrë të bashkëpranishme (co-occorrenze⁷), ku semantika e njërës gjymtyrë kushtëzohet nga prania e gjymtyrës tjetër.

2.1 Togfjalëshi emëror

Ka strukturë emër+emër ose emër+mbiemër dhe përfshihet gjerësisht në kategorinë e kalkut togfjalësor. Përgjithësisht, struktura sintaksore mjaft e ngjashme e dy gjuhëve në kontakt e lehtëson realizimin e kalkut togfjalësor. Gjymtyrët leksikore të gjedhes përkthehen me gjegjëset e barasvlershme dhe radhiten në të njëjtën mënyrë në gjuhën marrëse. Për këtë arsye, shumica e kalkeve bëjnë pjesë në kategorinë e kalkeve të përsosura.

Është përhapur tashmë dhe përdoret qëndrueshëm togu vizë turistike/ vizë pune “shënim zyrtar me vulë të posaçme në pasaportë, me të cilin lejohet të kalosh kufirin dhe të shkosh në një shtet tjetër për turizëm ose punë”, sipas modelit visto turistico/ visto

6 Khs. F. Faloppa, Modi di dire, në Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano, vëll. II, Istituto dell'Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma 2011, ff. 908-910; po aty, F. Masini, Polirematiche, parole, ff. 1109-1112.

7 Khs. F. Faloppa, Collocazioni, në Il Vocabolario Treccani, vëll. I, vep. cit., Roma 2010, ff. 229-232.

di lavoro⁸ [“Gazeta Shqiptare” 13 korrik 2005: 7]: risia terminologjike zyrtare futet në përdorim pas viteve ‘90.

Ndeshet në gjuhën e përditshme dhe në shtyp togfjalëshi deliri i madhështisë (mjek., psikol.) “dalldi, shastisje, pështjellim mendor mendjemadhësie”, nga delirio di grandezza [“Shekulli” 22-7-2013]: përcaktori në gjinore i përshtatet rregullave sintaksore të shqipes, kur koka e sintagmës është e shquar: delir-i (togu me kokë të pashquar ndiqet automatikisht nga rasa rrjedhore: delir madhështie). Nga mënyra e rindërtimit të modelit origjinal, ky kalk ngjet me kalkun hibrid, që formohet me një leksemë të huazuar (jo të përkthyer), por në të vërtetë nuk është i tillë, sepse italianizmi delir është regjistruar më parë në FGJSH. Gjuha shqipe ka shumë huazime italiane të stabilizuara. Dhe nuk është i rrallë fenomeni i përfshirjes së tyre (khs. delir) në fenomenin tjetër të ndërndikimit gjuhësor, atë të kalkut, sidomos në mungesë të një fjale gjegjëse të barasvlershme vendëse. Realisht, lentimi i këtyre kalkeve ka një lehtësi të veçantë që shqipfolësi percepton në mënyrë të pavetëdijshme. Kjo varet nga “familiariteti” që këto leksema i ofrojnë, duke qenë se janë zëra të njohur, të përdorur, të pranuar nga norma letrare dhe të regjistruar në fjalorët shpjegues. Për të qenë më të saktë, megjithëse nuk ndryshon asgjë nga ana kategoriale, do të ishte më mirë të flitej në raste të tilla për një ndërndikim të përsëritur: huazim dhe kalk me huazim. Huazimi, si gjymtyrë e togut, rimerret sërishmi në gjuhë, kësaj radhe në momentin e formulimit të kalkut, pra gjithmonë në një mjedis dygjuhësor.⁹

Jo rrallë kriminaliteti përcaktohet në organet e shtypit dhe në programet televizive si krimi i organizuar “veprimtari kriminale e një grupi në një kohë të caktuar”, nga togfjalëshi crimine organizzato [“Bota shqiptare” 16-31 tetor 2013: 7, Top Channel 11-12-2013, 19.39, “Shekulli” 27-5-2014, 27-6-2014].

Kalku ana e errët e (grevës [së urisë]) “diçka që është e vështirë të kuptohet ose të interpretohet” përcjell me besnikëri në gjuhën marrëse edhe kuptimin e figurshëm të modelit italian il lato oscuro di (fig.) [“Shekulli” 6-6-2014].

Kalke të tjera janë të kushtëzuara nga kontekste specifike. Mund të përmendet nga arti i kuzhinës: letër kuzhine “letër thithëse e mbledhur zakonisht në një rrotull”, që përkthen me përpikëri, me emër në rrjedhore, modelin carta da cucina [2004, Kuzhina sot: 43]: emërtimi i ri hyn në përditshmërinë shqiptare me importimin e kësaj letre;

8 Semantika e zërave shqip është bazuar te Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1980, dhe te Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 2006. Çdo referim etimologjik dhe semantik i zërave italianë të cituar është bazuar tek Il nuovo etimologico. DELI. Dizionario etimologico della lingua italiana di M. Cortelazzo - P. Zolli, seconda edizione in volume unico a cura di M. Cortelazzo e M.A. Cortelazzo, Zanichelli, Bologna 1999, dhe te Vocabolario della lingua italiana di Nicola Zingarelli, Zanichelli, Bologna 1984-2007.

9 Italianizmat e tjerë, që marrin pjesë në formimet e togfjalëshave të regjistruar në këtë punim, janë stabilizuar në gjuhë para pjesëmarrjes së tyre në dukurinë e kalkut (Khs. B. Dashi, Italianismi nella lingua albanese, vep. cit.).

(picë) katër stinët “shtresë e hollë brumi të ardhur, e gatitur me vaj, djathë mocarelë, domate, sardele etj. dhe e pjekur në furrë”, që jep shqip togun (pizza) quattro stagioni [2004, Kuzhina sot: 335]; ose (miell) tipi 00 “miell i bardhë i përfutur nga bluarja e pjesës qendrore të kokrrave të grurit”, që formohet sipas gjedhes (farina) tipo 00 [2004, Kuzhina sot: 253]. Në fjalorin e tij, Elezi regjistron miell zero dhe jep kuptimin “miell i bluar imët” (sic), që s’është përkthimi i saktë i këtij lloji mielli.

Në mënyrë sporadike përdoret në zhargonet profesionale: mbetje hapësinore “pajisje të padobishme që mbeten në hapësirat kozmike”, nga rifiuti spaziali [“Shekulli” 19-3-2014], ose mbetje mjedisore “lëndë kimike a mbeturina industriale që ndotin mjedisin”, përkthim i togut rifiuti ambientali [“Shekulli” 13-7-2017].

Specifika e togfjalëshit emëror, me rendin e përcaktuar emër+mbiemër cilësor, bën që tri kalket e mëposhtme të mos respektojnë modelin origjinar (mbiemër+emër). Ndërhyrja e shqipfolësit diktohet nga një përshtatje e pashmangshme e rendit të gjymtyrëve të modelit në gjuhën e vet. Nga ana tipologjike trajtohen si kalke funksionale por jo të përsosura të kushtëzuara (calchi imperfetti necessitati).

Në raste ndeshjesh sportive kombëtare a ndërkombëtare nëpër gazeta haset finalja e madhe (sport) “ndeshja e fundit, e rëndësishme dhe e shumëpritur”, sipas gjedhes gran finale [“Panorama” 29 qershor 2006: 32]. E njëjta gjë ndodh kur jepen çmime të rëndësishme për arritje të veçanta në fusha të ndryshme të artit: (marrin vesh) lajmin e madh “një lajm shumë të mirë, shpesh të papritur”, që përkthen togun la grande notizia [“Shekulli” 7-12-2018]. Në të dyja këto raste shqipja nuk përdor cilësinë e madh por i rëndësishëm. Zëvendësimi është i panevojshëm. Në fushata zgjedhjesh politike a vendore flitet për të përjashtuarit e mëdhenj “persona me karakteristika të veçanta që janë përjashtuar nga aktiviteti [zgjedhjet] ku janë a duhet të jenë protagonistë”, që përkthen në shqipe sintagmën il grande escluso [“Shekulli” 23-7-2017]: togfjalëshi (gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror) përshtatet me një kryefjalë në numrin shumës, prandaj regjistrohet në këtë numër. Edhe kësaj radhe cilësi është i tepërt në shqipe.

2.2 Togfjalëshi foljor

Ky lloj togfjalëshi është më pak i pranishëm në dukurinë e kalkut në shqyrtim. Për herë të parë në rubrikën Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj në vitin 1991 regjistrohet togu marr spunto “rast a rrethanë që të sugjeron kryerjen e diçkaje”, që përkthen pjesërisht modelin italian prendere spunto [Fjala shqipe: 69, “Shekulli” 18-11-2013, 7-4-2014, “Panorama” 12-10-2013, 22-6-2014]: dukuria e huazimit të zërit spunto është e njëkohshme, kontekstuale, me fenomenin e kalkut. Leksema, e papërshtatur në shqipe, ende nuk është pranuar nga norma; prandaj duhet konsideruar si fjalë e papërkthyer që

përdoret vetëm brenda këtij kalku. Për këtë arsye kalku i përket kategorisë së hibridëve¹⁰.

Një tjetër kalk i një togfjalëshi foljor është [ai] fik (76) qirinj “ka ditëlindjen; kremton ditëlindjen duke fikur qirinjtë e vegjël që vendosen mbi tortë”, sipas gjedhes spegnere le candeline [Ora News 15-10-2020]: me gjithë renditjen e saktë të përbërësve të togut, nga ana kategoriale bëhet fjalë për një kalk funksional por jo të përsosur, sepse prapashtesa zvogëluuese e modelit nuk është përkthyer me gjegjësin semantik në gjuhën marrëse për shkak të specifikës së kësaj gjuhe, e cila nuk e përdor rëndom zërin qirith.

Shpesh sintagmat e kalkuara janë të përsosura, por të panevojshme, dysore, sepse i kanë simotrat e tyre në shqipe, si shkoj në det, që përkthen togun andare al mare [TVA 9-2-2006, 9.00, Çela: 7]: norma letrare parashikon një togfjalësh me një huazim francez: shkoj në plazh (khs. fr. aller à la plage). Mund të shtohet këtu dhe një botë me... “sasi e madhe”, nga un mondo di... [2004, Kuzhina sot: 606]: kalku ruan edhe kuptimin e figurshëm të modelit, por leksema e përdorur në shqipe në këtë kontekst është mal “grumbull a numër i madh sendesh; diçka me përmasa të mëdha”: një mal me...

Shpesh funksioni kuptimor i pazakontë në gjuhën marrëse e orienton shqipfolësin të përdorë thonjëzat, si te togu “çmenden” çmimet “rriten jashtë mase”, sipas gjedhes impazziscono i prezzi [“Gazeta Shqiptare” 16 qershor 2006: 9]. Kur modeli italian ka një përdorim sektorial ai ruhet edhe në replikë: luaj “pisët” (sport) “lojë që shkel kërkesat dhe rregullat e vendosura dhe të pranura”, nga giocare sporco [“Gazeta Shqiptare” 17-11-2013]. E njëjta gjë ndodh me gjedhen që paraqet një kuptim të figurshëm: mbyll “rubinetin”, “diçka që ka si funksion të ndërpresë ose të riaktivizojë një kredi, një ndihmë etj.”, nga chiudere il rubinetto (fig.) [Top Channel 14-12-2013, 19.31], ose e shtunë “e zezë”, “ditë fatkeqësish ose pesimizmi”, që përkthen sabato nero (fig.) [“Shekulli” 7-7-2018].

3. Kalke sintaksore

Ndryshe nga kalket togfjalësore me gjymtyrë të bashkëpranishme (co-occorrenze), kalket sintaksore përbëhen nga togje të lira fjalësh. Shqipfolësi fut në gjuhë lentime që nuk përputhen me rregullat sintaksore të saj. Kalke të tilla, teorikisht, mund të minojnë strukturat e gjuhës marrëse. Shqipfolësi, i ndikuar tej mase nga modeli, e përkthen atë në mënyrë automatike dhe me një besnikëri të tepruar. Në momentin e ligjëritimit ai nuk arrin të kuptojë se lidhja e gjymtyrëve të togfjalëshit të krijuar prej tij, në këndvështrim strukturor ose kuptimor, është e gabuar në gjuhën e vet. Kjo “lajthitje” e rastit është zakonisht fryt i nxitimit gazetaresk. Struktura e modelit bëhet pa dashje mbizotëruese.

Shembujt në shqipe nuk janë të shpeshtë. Me përjashtime të rralla, pjesa më e madhe e kalkeve sintaksore të regjistruara në këtë punim bën pjesë, më saktë, në kategorinë

10 Khs. R. Gusmani, Saggi sull’interferenza linguistica, vëll. I, Le Lettere, Firenze 1981, f. 56; M. Fanfani, Calchi, në Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell’italiano, vëll. I, vep. cit., f. 165.

e kalkut të kushtëzuar nga motivacioni i rremë (calco per falsa motivazione), d.m.th. togje të përkthyer keq, ose, më mirë, të keqkuptuara nga shqipfolësi, i cili pretendon se e njeh mirë italishten, por në të vërtetë nuk arrin të interpretojë drejt semantikën e modelit.

3.1 Folja

Ndër kategoritë gramatikore të përshtatura nxitimthi sipas rregullave sintaksore të gjuhës italiane, folja është më e pranishmja.

Me rastin e vizitës zyrtare të Presidentit italian Giorgio Napolitano, shtypi dhe emisionet televizive përkthejnë nxitimthi fjalën e tij, duke lentuar pa dashje një kalk sintaksor: (do të vazhdojmë) të bëjmë avokaten (për Shqipërinë) [“Shekulli” 5-3-2014]; (do të vazhdojmë) të bëjmë avokatin (e Shqipërisë) [Shqiptariitalise.com 5-3-2014]; (Italia do të vazhdojë) të bëjë avokatin (për Shqipërinë) [Top Channel 5-3-2014], sipas modelit fare l’avvocato (di) me kuptimin “(të jetë) mbrojtës, përkrahës (i...)”. Pra është i gabuar përdorimi i foljes kalimtare bëj (fare) me kundrinë të drejtë në vend të foljes vetvetore bëhem (diventare) ose jam (essere) me kallëzuesorin e kryefjalës: bëhem, jam avokati... Me t’u kuptuar gabimi, të nesërmen del në gazetë interpretimi i saktë i fjalëve të Presidentit, me sa duket, pas konsultimit me ekspertë të gjuhëve në kontakt: do të vazhdojë të japë një mbështetje të vendosur... [“Shekulli” 6-3-2014].

Dëshmia e parë e përdorimit të foljes kam pranë leksemës kujdes del në Mesharin e Gjon Buzukut (kam kujdes) [Ashta: 351]. Kalku, tashmë i përhapur por jo i regjistruar në fjalorët shpjegues, bëj kujdes “kam parasysh, kam kujdes” [Top Channel 4.5.2006, ore 21]; bëni kujdes [newsbomb.al 24-11-2015, lajmifundit.al 5-9-2016, intv.al 28-05-2017, Ora News 7-2-2017, 18-6-2018], përkthen togun italian fare attenzione, renditja është e drejtë, por këmbimi i foljes ndihmëse kam, kryesisht në mënyrën urdhërore (kini), me foljen kalimtare bëj (bëni) është i panevojshëm dhe i bie ndesh traditës shkrimore të shqipes. Shqipfolësi nuk percepton se dhe vetë italishtja s’e përdor foljen fare me kuptimin kryesor të saj, bëj, por me kuptimin e figurshëm prestare “jap, ofroj, i kushtoj”: fare/prestare attenzione “i kushtoj vëmendje, kujdes; jam i vëmendshëm, i kujdesshëm për diçka a ndaj diçkaje; kam kujdes”.

Kalku i kushton prangat “i sjell si pasojë heqjen e lirisë”, jep në shqipe modelin costare le manette [NOA 2-2-2016]: folja jokalmimtare pavetore kushton në kuptimin e figurshëm “do, kërkon, sjell shumë mundime” ngatërrohet me foljen kalimtare homonime kushtoj “vë ose jap gjithçka në shërbim të dikujt a të diçkaje; tregoj kujdes, përkushtoj” (i kushton jetën). Folja kushton lidhet në shqipe me një ndajfolje: pak, shumë, shtrenjtë etj. (rrethanor sasi) jo me një temë emërore në kallëzore (kundrinë e drejtë). Po kështu, rrezikon serinë C (sport) “bën diçka që ka si pasojë kalimin në një kategori tjetër”, frymëzohet nga rischiare la serie C [“Shekulli”, 5-7-2006]: forma jokalmimtare e foljes rrezikoj, e ndjekur nga një kundrimë e drejtë, vë në dukje një veprim

“që mund të sjellë një rrezik” (rrezikon jetën), por jo kalimin p.sh. në një kategori të caktuar sporti, që në vetvete nuk paraqet asnjë rrezik: rrezikon të kalojë në serinë C.

I çuditshëm është lentimi jam me një... “kam marrëdhënie dashurie me dikë”, që sjell në shqipe stare con un... [“Shekulli” 28-6-2006]: autori i kalkut i shton foljes jam, pa e menduar gjatë, kuptimin e foljes së modelit italian “avere una relazione sentimentale”. Parafjala me tregon “shoqërim ose qenien në të njëjtin vend a në të njëjtën gjendje me një tjetër”. Gjithkush kupton, gjatë leximit, se një person shoqërohet me dikë, por nuk mendon se midis tyre ka lidhje afektive, siç hamendëson italishtja. Po aq i pazakontë është kalku sa për të mbetur (në...), sipas tanto per restare (in...) [“Shekulli” 10-9-2012], që përdor foljen mbetem në vend të foljes përmbahem (me trajtë të shkurtër në dhanore): i përmbahem (temës). I panevojshëm është zëvendësimi i foljes së traditës shkoj (shkoj me pushime) me foljen marr në kalkun marr pushimet, nga prendere le ferie [“Shekulli” 13-7-2006, 16-4-2014, “Gazeta Shqiptare” 9-6-2013].

Gazetari i rrëmbyer bie në kurthin e përkthimit tejet besnik të titullit origjinal të veprës narrative Il paese dove non si muore mai, shkruar italisht nga shkrimtarja Ornella Vorpsi: vdiset [Vendi ku nuk vdiset kurrë (sic)] jep modelin si muore [“Panorama” 25-11-2013]: folja jokalimtare vdes nuk ka formë pësore-vetvetore në shqipe, por është fryt i përkthimit të gabuar të një forme të paqenë pavetore të foljes morire: nëse si dice, si fa, si vive kanë gjegjëset flitet (nga flas), bëhet (nga bëj), jetohet (nga jetoj) atëherë si muore ka gjegjësen vdiset (!) (nga vdes).

Nëse gabimet e shqipfolësve në atdhe janë të papranueshme në këndvështrim gjuhësor, ambienti italian, ku jetojnë, e kushtëzon shumë gjuhën e të rinjve shqiptarë. Gabimet lindin nga moslëvrimi i gjuhës amtare në mjediset familjare apo institucionale. Nevoja e përkthimit simultan, për të treguar se e “njohin” gjuhën shqipe, i bën të rinjtë të gabojnë në mënyrë të pandërgjegjshme. Prandaj, ndeshet shpesh (më) bëj një zile [studentë shqiptarë të kursit të gjuhës, 7-3-2006], sipas modelit italian fare uno squillo, tashmë i përdorur dhe në atdhe. Dëgjohet rrallë edhe kam... vjeç [2006], nga avere... anni: është rasti i një studenti shqiptar 20 vjeçar, lindur në Shqipëri dhe mërguar në Itali në moshë të njomë, që përdor foljen kam në vend të foljes jam për të treguar moshën e vet.

Të paktë janë shembujt e përdorimit pa vend të kategorive të tjera gramatikore.

3.2 Mbiemri

Përsa i përket kategorisë së mbiemrave mund të shënohet kalku hera jote e dytë, që përkthen la tua seconda volta [“Panorama” 21-2-2016]: përkthimi i modelit është i saktë, por renditja e gjymtyrëve të togefjalëshit të zgjeruar respekton, me të drejtë, sintaksën e shqipes (pronori dhe cilësori ndjekin emrin) jo atë të italishtes. Nga ana tipologjike, kalku quhet jo i përsosur i kushtëzuar (imperfetto necessitato). Në shqipe përdorimi i mbiemrit pronor është i tepërt, i papërshtatshëm: bëhet fjalë për pjesëmarrjen

e bashkëbiseduesit për herë të dytë në një aktivitet dhe kuptohet qartë që kjo pjesëmarrje është kryer dhe i përket vetëm bashkëbiseduesit, askujt tjetër. Tërheq vëmendjen kalku përzierje e fituar, sipas *impasto ottenuto* [2004, Kuzhina sot: 9]: shqipfolësi ngatërroi mbiemrin prejfoljor e fituar, nga folja jokalimtare fitoj me kuptim “dal fitues; arrij diçka”, me mbiemrin e përfutur, nga folja jokalimtare përfutoj me kuptimin “krijoj, formoj”.

3.3 Ndajfolja

Për kategorinë e ndajfoljeve mund të përmendet kalku jam jashtë “jam përjashtuar nga një grup, një listë etj.”, sipas gjedhes *restare, rimanere fuori* [“Gazeta Shqiptare” 20 korrik 2005: 5]: në shqipe jashtë është ndajfolje vendi (rri jashtë) jo mbiemër escluso (i përjashtuar), si pretendon shqipfolësi i rrëmbyer; ose kalku të punosh me... është shumë bukur, nga *lavorare con...* è molto bello [“Koha Jonë” 1-4-2014]: folja jam ndiqet gabimisht nga ndajfolja (bukur) dhe jo nga mbiemri (është e vështirë, e lehtë, e përshtatshme etj.), që duhet të cilësojë një marrëdhënie pune; ndajfolja bukur ka gjegjësen e vet bene në italishte: këndon bukur “canta bene” ose vishet bukur “veste bene”. Krijon një fjalë të re kalku vështirësisht të pajtueshëm, nga modeli difficilmente conciliabili [Lubonja: 1], ku vështirësisht, neologjizëm i rastit, zëvendëson ndajfoljen vështirë, të normës letrare.

3.4 Parafjala

Për kategorinë e parafjalëve citohet lidhen në martesë “martohen”, nga unirsi in *matrimonio* [“Shekulli” 29-4-2011]: përdorim i gabuar i parafjalës në me foljen vetvetore lidhem: togjet lidh martesë (te zëri martesë) dhe lidhen me martesë (te zëri lidhem) janë regjistruar duke filluar nga FGJSSH; ose në tre ditë, nga in *tre giorni* [“Gazeta Shqiptare” 8 janar 2006: 45]: përveç mospërshtatjes së numërorit me emrin në gjininë femërore (tri ditë), është i gabuar përdorimi i parafjalës në në vend të parafjalës për me kuptimin e “kohës sa zgjat diçka, kur përsëritet, e kohës që duhet për të bërë një punë etj.” (e shoqëruar zakonisht me një numëror).

Përfundime

Si përfundim, mund të themi se lentimi i kalkeve togfjalësore e sintaksore është një fenomen i pranishëm në gjuhën shqipe, megjithëse jo fort i përhapur. Nëse kalket togfjalësore të bashkëpranishme mund të konsiderohen shpesh si një prurje pozitive në gjuhën marrëse, si një risi a modernizim i idiomës mëmë, kalket sintaksore lindin kryesisht nga moskuptimi i saktë ose nga keqinterpretimi i gjedhes italiane. Struktura

sintaksore e ngjashme e dy gjuhëve në kontakt bën që kalket të jenë përgjithësisht të përsosura. Kalku jo i përsosur kushtëzohet herë-herë nga rregullat sintaksore të shqipes që nuk përputhen me modelin. Në prani të një huazimi italian, klasifikimi i mëtejshëm kategorial nuk është automatik dhe nuk mund të përgjithësohet: për të përcaktuar kategorinë e kalkut me huazim italian të qëndrueshëm apo me huazim kontestual, çdo lëtim duhet shqyrtuar si rast më vete.

Burimi parësor për vjeljen e kalkeve strukturore dhe kuptimore, në përgjithësi, janë fjalorët shpjegues, fjalorët dygjuhësh por edhe organet e shtypit dhe televizioni. Po të vërejmë shembujt e përmendur në këtë punim, ndryshe nga kategoritë e tjera të kalkut strukturor, përfshirë këtu dhe kalkun frazeologjik, togjet fjalësore të bashkëpranishme apo togjet të lira nuk janë regjistruar në fjalorë. Domethënia është e qartë. Përdorimi jo vetëm që s'është i qëndrueshëm, sidomos përdorimi i kalkeve sintaksore, por rëndom, siç u vu në dukje, është i papërshtatshëm në shqipe.

Vetëm koha do të vërtetojë stabilitetin e tyre. Një ide e qartë do të krijohet me botimin e përditësuar të fjalorit shpjegues. Ndërkohë këtu hetohet dukuria gjuhësore për të parë zhvillimin e saj në të ardhmen.

BIBLIOGRAFIA:

- AKADEMIA e shkencave e shqiperise (2006), *Fjalor i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- AKADEMIA e shkencave e shqiperise (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- AKADEMIA e shkencave e shqiperise (1991), *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*, «Gjuha jonë», n. 1, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- ASHTA k. *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut* (1555), «Buletin shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», Shkodër, 1964, numër i posaçëm, ff. 119-184; 1965, ff. 59-96; 1966, n. 4, ff. 27-66, ribotim *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, vëll. I, Universiteti i Shkodrës 'Luigj Gurakuqi', Sektori Shkencor i Albanologjisë, Shkodër 2000 (ribotim i edicionit të 1996-s), ff. 281-494.
- CABEJ e. (1982), *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- CELA Z. (2007), *Për dashurinë shkruhet pas vdekjes*, Ideart, Tiranë.
- CORTELAZZO M. & ZOLLI P. (1999), *Il nuovo etimologico. DELI. Dizionario etimologico della lingua italiana*, seconda edizione in volume unico a cura di M. Cortelazzo e M.A. Cortelazzo, Zanichelli, Bologna.
- DASHI B. (2013), *Italianismi nella lingua albanese*, Dipartimento di Scienze documentarie, linguistico-filologiche e geografiche, Sapienza Università di Roma, Centro di Studi albanesi, Edizioni Nuova Cultura, Roma.
- DASHI B. (2015), *I calchi linguistici nella lingua albanese. I calchi strutturali*, në «Bollettino di Italianistica», Rivista di critica, storia letteraria, filologia e linguistica, n.s., anno XII, n. 2, Carocci, Roma.
- DASHI B. (2017), *I semicalchi strutturali e i calchi strutturali ibridi nella lingua albanese*, në «Linguistica e Letteratura», XLII, 1-2, Fabrizio Serra editore, Pisa – Roma.

- dASHI B. (2017), *Calchi fraseologici nella lingua albanese*, në «Bollettino di Italianistica», n.s., anno XIV, n. 1, Carocci editore, Roma 2017.
- di GIOVINE P. (2008), *Un millennio di storia linguistica albanese: l'influsso lessicale della lingua italiana*, «L'Italia dialettale», rivista di Dialettologia italiana, vëll. LXIX (Seria e Tretë, V), Edizioni ETS, Pisa.
- eleZI M. (2006), *Fjalor i gjuhës shqipe*, Enti botues “Gjergj Fishta”, Tiranë.
- fALOPPA F. (2010), *Collocazioni*, në *Il Vocabolario Treccani*, vëll. I, Istituto dell'Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma.
- fALOPPA F. (2011), *Modi di dire*, në *Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano*, vëll. II, Istituto dell'Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma.
- fANFANI M. (2010), *Calchi*, në *Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano*, vëll. I, Istituto dell'Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma.
- gUSMANI R. (1981), *Saggi sull'interferenza linguistica*, vëll. I, Le Lettere, Firenze.
- gUSMANI R. (1983), *Saggi sull'interferenza linguistica*, vëll. II, Le Lettere, Firenze.
- LEKA F. (1997), *A proposito degli italianismi nell'albanese*, në *Albanistica novantasette*, a cura di I. C. Fortino, Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale - Istituto Universitario Orientale, Napoli.
- LUBONJA F., “*Standard*”, Tiranë 4 tetor 2006.
- MASINI F. (2011), *Polirematiche, parole*, në *Il Vocabolario Treccani. Enciclopedia dell'italiano*, vëll. II, Istituto dell'Enciclopedia italiana fondata da Giovanni Treccani, Roma.
- TOPALLI N. (1988), *Kalke njësish frazeologjike*, «Gjuha jonë», n. 2, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- ZINGARELLI N. (1984-2007), *Vocabolario della lingua italiana di Nicola Zingarelli*, Zanichelli, Bologna.

Gazeta –edhe on-line- e *TV* (*Shekulli*, *Gazeta Shqiptare*, *Bota shqiptare*, *Panorama*, *Koha Jonë*, *shqiptariitalse.com*, *intv.al*, *lajmifundit.al*, *newsbomb.al*, *NOA*, *Ora News*, *Top Channel*, *TVA*).

Shkurtime e shkurtesa

Ashta = K. Ashta

Çela = Z. Çela

Elezi = M. Elezi

FGJSH = *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2006.

FGJSSH = *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë 1980.

Fjala shqipe = *Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj*, «Gjuha jonë», Tiranë 1991.

Lubonja = F. Lubonja

BILINGUIZMI: NGA FËMIJËRIA NË MOSHËN MADHORE

Ma. Aida Zoto

Departamenti i Gjuhëve dhe Letërsisë
Fakulteti i Shkencave Humane dhe i Komunikimit Gjuhësor
KU LOGOS
E-mail: zotoaida@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Bilinguizmi, ky fenomen shumëdimensional, i pranishëm në çdo vend të botës, në të gjitha klasat e shoqërisë dhe në të gjitha grup-moshat, na lejon studimin e afërsisë gjuhësore, funksionimin e trurit të njeriut, sjelljen sociale, organizimin e shoqërisë dhe formësimin e sistemeve arsimore. Duke marrë parasysh se përvetësimi i gjuhës së dytë apo dhe të tretë ka ndodhur në kohë të ndryshme të jetës së tyre dhe jo domosdoshmërisht në fëmijërinë e hershme, ai cilësohet si një fenomen fiziologjik dhe mendor dhe shfaqet kur dy njerëz ose dy komunitete që përdorin kode të ndryshme komunikimi dëshirojnë të hyjnë në kontakt, duke shkëmbyer mesazhe me anë të përdorimit të një kodi të përbashkët. Në këtë artikull paraqitet një përjasje teorike e fenomenit të bilinguizmit përmes rishikimit të literaturës kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me qëndrimet dhe gjetjet e studimeve të ndryshme të zhvilluara në disa shtete. Përshkrimi dhe vlerësimi i faktorëve kryesorë, individualë dhe shoqërorë, të bilinguizmit e studiojnë atë si: a) fenomen individual bazuar në moshën në të cilën individi ekspozohet ndaj gjuhës së dytë (cilët individë konsiderohen dygjuhësh/bilingë dhe si b) fenomen shoqëror (cilat janë kushtet politike, ekonomike, kulturore, ideologjike dhe a ka përfitime apo dëmtime tek individi dygjuhësh). Së fundmi, lexuesit - si ata njëgjuhësh, asht edhe ata dygjuhësh të grupmoshave dhe nënkategorive të ndryshme të bilinguizmit - do të njihen me disa nga përfitimet që sjell ekspozimi ndaj bilinguizmit në aspekte të ndryshme personale dhe sociale.

Fjalët çelës: bilinguizmi, format e bilinguizmit, faktorët e bilinguizmit

ABSTRACT

Bilingualism, this multidimensional phenomenon, present in every country, in all society classes and in all age groups, allows us to study linguistic proximity, human brain functioning, social behavior, organization of society and educational systems. Given that second or third language acquisition happens at different times of their life and not necessarily in early childhood, it is termed a physiological and mental phenomenon and occurs when two people or two communities using different communication codes want to communicate with each other by using a common communication code. This article presents a theoretical approach to the phenomenon of bilingualism through the review of international literature regarding the attitudes and findings of various studies developed in some states. Description and assessment of the main, individual and social factors of bilingualism study it as well as: a) an individual phenomenon based on the age at which the individual is exposed to the second language (which individuals are considered bilingual and b) as a social phenomenon (what are the political, economic, cultural, ideological

conditions and whether there are any benefits of exposure to bilingualism). Finally, readers - monolinguals and bilinguals of the ages and sub-categories of bilingualism - will be acquainted with some of the benefits of exposure to bilingualism in personal and social aspects.

Keywords: bilingualism, forms of bilingualism, bilingualism factors

Bilinguizmi

Gjuha përbën mjetin përmes të cilit dy persona që flasin të njëjtën gjuhë hyjnë në kontakt dhe manifestojnë mendimet e ndjenjat e tyre. Bilinguizmi ndodh atëherë kur dy njerëz ose dy komunitete që përdorin kode të ndryshme komunikimi dëshirojnë të hyjnë në kontakt, duke u lejuar njerëzve që u përkasin sistemeve të ndryshme gjuhësore të shkëmbejnë mesazhe me anë të përdorimit të një kodi të përbashkët komunikimi. Bilinguizmi është një dukuri globale dhe analizohet në lidhje me folësit (në nivel individual apo shoqëror), por edhe në lidhje me sistemet e përfshira gjuhësore¹¹. Kështu, arrijmë në përfundimin se bilinguizmi është produkt “i dukshëm” i kontaktit gjuhësor¹² që vazhdimisht evoluon pa e përfunduar kurrë plotësisht ciklin e tij¹³, ndërkohë që në lidhje me aspektet e ndryshme të sjelljes njerëzore, na lejon studimin e afërsisë gjuhësore, funksionimin e trurit të njeriut, reflekton sjelljen sociale dhe organizimin e shoqërisë dhe formëson sistemet arsimore. Në literaturën ndërkombëtare nuk ka një përkufizim unik të bilinguizmit; disa shkencëtarë emëtojnë folës bilingë, ata individë që zotërojnë dy gjuhë në nivel të ngjashëm me folësit amtarë të gjuhëve përkatëse; disa të tjerë emëtojnë folës bilingë, madje edhe ata individë që dinë pak fjalë në një gjuhë të huaj - të tillë mund të konsiderohen turistët të cilët njohin dy - tri fraza dhe njerëzit e biznesit, të cilët njohin dy - tri përhëndetje në një gjuhë të dytë (koncepti “bilinguizëm embrional/ incipient bilingualism”)¹⁴; dhe së fundi, ka dhe nga ata shkencëtarë që luhaten midis përkufizimit maksimalist dhe minimalist¹⁵. Nga sa më sipër dilet në përfundimin se nuk ka një përkufizim të bilinguizmit që i përfshin të gjitha karakteristikat e si pasojë të ketë vlefshmëri të përgjithshme. Megjithatë, tipari i përbashkët që del nga të gjitha përkufizimet është përvetësimi dhe përdorimi i më shumë se një gjuhe nga një individ. Shkaqet që një individ ose një shoqëri i drejtohet bilinguizmit janë të ndryshme. Bilinguizmi mund t’i imponohet individit apo komunitetit nga faktorë të jashtëm, por njëkohësisht mund të jetë opsional apo për shkak të motivimeve të brendshme.

11 Σελλά-Μάζη, Ε. 2001. Διγλωσσία και κοινωνία. Η κοινωνιογλωσσολογική πλευρά της διγλωσσίας. Η ελληνική πραγματικότητα. Αθήνα: Προσκήνιο.

12 Σκούρτου, Ε. 2002α. Δίγλωσσοι μαθητές στο ελληνικό σχολείο. Επιστήμες Αγωγής, Θεματικό τεύχος 2002, 12.

13 Τριάρχη-Ηerrmann, Β. 2000. Η Διγλωσσία στην Παιδική Ηλικία: Μια Ψυχολογιστική Προσέγγιση Αθήνα: Gutenberg.

14 Diebold, Α. R. 1961. Incipient Bilingualism. Language 37, no.1. 97-112. doi:10.2307/411253.

15 Baker, C. 2001. *Foundations of Bilingual Education and Bilingualism* (3rd ed.). Clevedon: Multilingual Matters LTD.

Konkretisht, sipas Mackey (2016), situatat dygjuhëshe shfaqen për shkaqe specifike, që veprojnë në mënyrë individuale ose në kombinim. Si shkaqe të tilla ai shpreh pushtimin ushtarak dhe kolonizimin e një rajoni, marrëdhëniet tregtare që shtrihen jashtë kufijve, epërsinë demografike të një grupi gjuhësor që imponohet de facto, prestigjin dhe pushtetin politik që ushtron një grup gjuhësor, emigracionin për arsye ekonomike, politike e fetare, sistemin arsimor, industrializimin dhe përmirësimin e standardeve të jetesës së folësve që mund t'i çojnë individët drejt adoptimit të gjuhës së prosperitetit, përhapjen e një feje dhe gjuhës nëpërmjet të cilës ajo propagandon rritjen e valës të nacionalizmit, për arsye personale që lidhen me aspiratat dhe motivet personale të folësit. Pra, në varësi të mjediseve të caktuara gjuhësore dhe të situatave sociolinguistike, faktorët që ndikojnë drejt bilinguizmit të individëve mund të jenë polikë, fetarë, socialë apo kulturorë dhe zhvillohen duke u bazuar në gjendjen psikologjike, fiziologjike, emocionale dhe shoqërore të individit¹⁶.

Format e bilinguizmit

Të kuptuarit e fenomenit të bilinguizmit mund të kryhet me sukses, nëse merren parasysh aspektet e mëposhtme të fenomenit: mosha, aftësia gjuhësore, zhvillimi mendor, mjedisi gjuhësor i folësit biling, apo mjedisi socio-kulturor që mund të ndikojë si në aftësitë gjuhësore të bilingut, ashtu dhe në përdorimin e gjuhës prej tij, perceptimi i gjuhëve nga të dyja komunitetet gjuhësore (dominantët/pakicat) dhe në fund, miratimin ose refuzimin e identiteteve të veçanta kulturore që mbartin gjuhët e folësit biling¹⁷. Sipas komponentëve të mësipërm, sistematizimi i formave të ndryshme të bilinguizmit mund të ndahet në katër kategori:

1) sipas kriterëve të mësimi të gjuhës së dytë: a) duke u bazuar në moshën në të cilën është përvetësuar gjuha e dytë bëhet dallimi midis bilinguizmit të njëkohshëm dhe atij të vazhdueshëm. Bilinguizmi i njëkohshëm është i njohur dhe si bilinguizëm i “mirëfilltë” dhe ndodh në ata individë, të cilët menjëherë pas lindjes së tyre, vijnë në kontakt me të dyja gjuhët njëkohësisht në mjedisin ku rriten (shtëpi - kopsht). Në këtë kategori janë fëmijët e martesave të përziera apo fëmijët e pakicave gjuhësore dhe zakonisht nuk ka ndarje midis gjuhës amtare dhe gjuhës së dytë, kështu që personi biling ka dy gjuhë amtare. Ndërsa bilinguizmi i vazhdueshëm ekziston kur përvetësimi i një gjuhe të dytë bëhet në një moshë në të cilën gjuha e parë është stabilizuar, pas vitit të tretë të moshës. Si shembuj mund t'i referohemi fëmijëve, të cilët për arsye të ndryshme, pas vitit të tretë të moshës, kanë ndryshuar vendin e banimit dhe janë detyruar të mësojnë

16 Shkurtaj, Gj. 2009. *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, Tiranë.

17 Σελλά-Μάζη, Ε. 2001. Διγλωσσία και κοινωνία. Η κοινωνιογλωσσολογική πλευρά της διγλωσσίας. Η ελληνική πραγματικότητα. Αθήνα: Προσκήνιο.

gjuhën dominuese të mjedisit të ri; b) një tjetër ndarje kemi në format e bilinguizmit të hershëm, atëherë kur gjuha e dytë është fituar në moshën e para-pubertetit dhe të bilinguizmit të vonë, kur gjuha e dytë është mësuar gjatë adoleshencës ose dhe më vonë; së fundmi c) duke u bazuar në mënyrën me të cilën një person biling përvetëson një gjuhë të dytë, kemi dallimin midis bilinguizmit natyral dhe atij kulturor. Kur një person fiton gjuhën e dytë përmes komunikimit të përditshëm me folësit natyralë, pa ndjekur paralelisht mësimet në gjuhën e dytë, atëherë kemi bilinguizëm natyral ose të fituar. Nga ana tjetër, kur përvetësimi i gjuhës së dytë arrihet përmes mësimdhënies formale duke ndjekur mësimet në një shkollë apo në një kurs, atëherë kemi bilinguizëm kulturor¹⁸.

2) sipas kriterëve gjuhësore: a) Weinreich duke u bazuar në lidhjen që ekziston midis simboleve gjuhësore dhe koncepteve përkatëse semantike dallon tri lloje bilinguizmi - bilinguizmi i koordinuar, i cili përfaqëson rastet kur personi mëson përmendësh simbolet dhe domethënien e tyre përkatëse konceptuale veçmas në të dyja gjuhët. Në këtë rast, personi biling ka përvetësuar dy gjuhët në dy hapësira të ndryshme sociale dhe për këtë arsye ai ka zhvilluar dy sisteme semantike gjuhësore të ndara. Më tej ai vijon me bilinguizmin sintetik, ku shpjegon se shfaqet në ato raste kur në mjedisin e afërt të individit biling alternohen të dyja gjuhët nga i njëjti person në të njëjtën situatë. Kështu simbolet gjuhësore, pra fjalët, në të dy gjuhët janë të ndara, por jo në kuptimin e tyre (kuptim i përbashkët semantik). Së fundmi, flasim për bilinguizëm të varur kur personi mëson një gjuhë të dytë me ndihmën e gjuhës së tij të parë, pra, kur struktura e gjuhës së dytë varet nga struktura e gjuhës së parë; b) dy forma të tjera të bilinguizmit që lidhen me shkallën e përvetësimit të çdo gjuhe janë bilinguizmi ndërveprues dhe ai i balancuar. Individi i cili ka aftësinë për të përdorur të dyja gjuhët, në të gjitha rrethanat e jetës së përditshme me të njëjtën lirshmëri quhet biling ndërveprues, ndërsa individi i cili nuk ka aftësinë për të përdorur të dyja gjuhët, në rrethana të ndryshme me të njëjtën lirshmëri quhet biling i balancuar. Baetens Beardsmore na sjell si shembull bilingësh të balancuar, nxënësit që frekuentojnë shkolla dygjuhëshe, që kuptojnë traditat shkollore në të dyja gjuhët dhe që performojnë në klasë në të dyja gjuhët.

3) sipas kriterëve psiko-socio-gjuhësore: a) disa studime të kryera nga fillimi i vitit 1960, treguan se fëmijët bilingë që zhvillojnë të dyja gjuhët paralelisht nën të njëjtin kujdes, tregojnë një formë shtesë bilinguizmi duke shtuar në repertorin e tyre një gjuhë të dytë, pa ndonjë pengesë në zhvillimin e gjuhës së tyre të parë. Ata arrijnë një nivel të lartë, si në të folur, ashtu edhe në të shkruar në të dyja gjuhët¹⁹. Me pak fjalë, në bilinguizmin aditiv dy sistemet gjuhësore dhe kulturore bashkëjetojnë në

18 Σελλά-Μάζη, Ε. 2001. Διγλωσσία και κοινωνία. Η κοινωνιογλωσσολογική πλευρά της διγλωσσίας. Η ελληνική πραγματικότητα. Αθήνα: Προσκήνιο.

19 Cummins, J. 2003/2005. (μετ. Σ. Αργύρη, εισ.-επιμ. Ε. Σκούρτου), Ταυτότητες υπό διαπραγμάτευση. Εκπαίδευση με σκοπό την Ενδυνάμωση σε μια Κοινωνία της Ετερότητας. Αθήνα: Gutenberg, Β' έκδοση βελτιωμένη.

harmoni në individin biling, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit të tij dhe në zhvillimin e gjuhës amtare dhe të gjuhës së dytë paralelisht. Megjithatë, sipas Lambert, fenomeni i bilinguizmit subtraktiv ndodh kur, për shkak të presionit shoqëror dhe politik të mjedisit, personave bilingë, që në vitet e para të jetës, u imponohet përdorimi ekskluziv i gjuhës dominuese duke neglizhuar gjuhën amtare. Si pasojë është ngadalësuar përparimi në gjuhën e parë, dhe zhvillimi jo i kënaqshëm në gjuhën e dytë. Kjo formë e bilinguizmit zakonisht ndodh te fëmijët e pakicave ku gjuha dhe kultura e tyre nuk vlerësohen pozitivisht nga popullata vendase dhe kjo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me performancën e dobët të këtyre nxënësve, me mungesën e vetëperceptimit dhe me humbjen e identitetit kulturor. Prandaj, në rastet kur vërehet zhvillimi i mirë i dy gjuhëve paralelisht, atëherë bilinguizmi anon ndaj avantazheve, ndërsa në të kundërt, kur të dy gjuhët e bilingut janë minimalisht të zhvilluara, atëherë personi ndikohet negativisht nga fenomeni i bilinguizmit^{20/21/22}; b) Hansegard²³ u përpoq të përshkruajë fenomenin e semilingualizmit të dyfishtë, duke folur për mangësitë në gjashtë aftësitë gjuhësore të mëposhtme: i) në gamën e fjalorit, ii) në saktësinë e gjuhës, iii) në përpunimin e pavetëdijshëm të gjuhës, iv) në krijimin gjuhësor, v) në kontrollin absolut të funksioneve të gjuhës (emocional, njohës), vi) në kuptimet dhe figurat e fjalës. Kështu, gjysmë-gjuhësor (angl. semilingualist) quhet ai person që paraqet mangësi sasiore dhe cilësore në të dyja gjuhët, krahasuar me monolingët. Semilingualisti paraqet fjalor të kufizuar, gramatikë të pasaktë, ngurtësi dhe vështirësi për të shprehur emocione në të dy gjuhët.

4) sipas kritereve individuale dhe sociale: a) termi dygjuhësi (bilinguizëm) është prezantuar nga Ferguson, për të përshkruar situatat ku dy variante të të njëjtës gjuhë (i lartë dhe i ulët) bashkëjetojnë dhe secili kryen funksione të ndryshme shoqërore. Këto dy variante përdoren nga anëtarët e shoqërisë në ambiente të pakufizuara, ku varianti i lartë gëzon prestigj shoqëror ndryshe nga varianti i ulët. Fishman, duke zgjeruar konceptin e bilinguizmit të Ferguson, argumentin se bilinguizmi mund t'i referohet bashkëjetesës së dy gjuhëve të ndryshme dhe duke kombinuar bilinguizmin individual dhe shoqëror përshkruan katër situata gjuhësore^{24/25}. Në rastin të parë, është e mundur brenda shoqërisë ose komunitetit të ketë njëkohësisht bilinguizëm individual dhe

20 Σελλά-Μάζη, Ε. 2001. Διγλωσσία και κοινωνία. Η κοινωνιογλωσσολογική πλευρά της διγλωσσίας. Η ελληνική πραγματικότητα. Αθήνα: Προσκήνιο.

21 Baker, C. 2001. *Foundations of Bilingual Education and Bilingualism* (3rd ed.). Clevedon: Multilingual Matters LTD.

22 Shkurtaj, Gj. 2009. *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, Tiranë.

23 Baker, C & Jones, S. P. 1998. *Encyclopedia of Bilingualism and Bilingual Education Multilingual matters*. ISBN: 1853593621.

24 Δαμανάκης, Μ. 1998. Η εκπαίδευση των παλιννοστούντων και αλλοδαπών μαθητών στην Ελλάδα. Διαπολιτισμική προσέγγιση. Αθήνα: Gutenberg.

25 Calvet, J.-L. 2002. *La sociolinguistique*. Paris, Presses universitaires de France.

shoqëror. Të gjithë anëtarët janë në gjendje të përdorin dhe variantin e lartë dhe të ulët, ku secili variant ka funksione të ndara, p.sh. në shtetin e Paraguit banorët flasin gjuhën gurani, si variant i ulët, por paralelisht përdorin dhe gjuhën spanjolle si variant i lartë. Në rastin e dytë, përshkruhet shoqëria e përbërë nga bilinguizmi shoqëror, por mungon ai individual. Këtu dy gjuhë bashkëjetojnë në një mjedis të caktuar gjeografik, megjithatë, këto gjuhë nuk përdoren në mënyrë paralele nga të gjithë anëtarët e shoqërisë. Kështu, individët, edhe pse janë të organizuar në të njëjtin shtet, mund të përqafojnë të njëjtën fe, të gëzojnë të njëjtat të drejta, nuk janë në gjendje të komunikojnë midis tyre pasi nuk lidhen gjuhësisht. Në rastin e tretë, përshkruhen shoqëritë brenda të cilave edhe pse ka individë ose grupe që në kontaktet e tyre të përditshme përdorin dy gjuhë, shoqëria apo institucionet sociale janë njëgjuhëshe. Këto shoqëri Fishman i karakterizon si të paqëndrueshme dhe në tranzicion, pasi aty ku ka bilinguizëm individual pa pasur shoqëror, pritet mbipopullimi i një gjuhe nga një tjetër me kalimin e kohës. Këtë fenomen e hasim në shoqëritë e migrimit në të cilat jetojnë komunitetet e ndryshme gjuhësore, gjuhët e të cilave nuk kanë vlerë funksionale jashtë kontekstit familjar ose bashkësisë etnike. Së fundmi, në rastin e katërt, përmenden shoqëritë në të cilat nuk ekziston as bilinguizëm individual dhe as shoqëror. Kjo ndodh në komunitetet primitive dhe të izoluara, ku rolet sociale nuk janë të diferencuara²⁶; b) dallimi i bilinguizmit midis elitës dhe shumicës është kryer nga Paulston; sipas tij, kemi bilinguizëm të elitës kur individët mësojnë përveç gjuhës së tyre amtare dhe gjuhë të tjera. Ata përvetësojnë një gjuhë të huaj ose sepse në mjedisin ku ata jetojnë mësimi i gjuhëve të huaja është një element arsimit dhe kulture, ose sepse kështu mund të vijnë në kontakt me folësit amtarë të kësaj gjuhe për të studiuar kulturën, letërsinë dhe historinë e saj, ose edhe për shkak se të mësuarit e kësaj gjuhe lidhet direkt me qëllimet profesionale, ose, më në fund, sepse vetë njerëzit e konsiderojnë mësimin e gjuhëve të huaja një eksperiencë interesante. Raste që mund të përmenden janë fëmijët bilingvë të diplomatëve apo fëmijët e klasës së sipërme. Në anën tjetër, kemi bilinguizëm të shumicës ku njerëzit janë të detyruar të mësojnë një gjuhë të dytë përveç gjuhës së tyre amtare, sepse kështu mund të përballen me kërkesat e jetës së përditshme, pasi gjuha e dytë është e domosdoshme në mjedisin ku jetojnë. Pra, nevoja për të biseduar me pjesën tjetër të popullsisë, për të gjetur punë, për të ardhur në kontakt me autoritetet publike, për të marrë pjesë në ngjarjet politike dhe shoqërore është një nxitje, e cila çon në përvetësimin e gjuhës së re. Prandaj bilinguizmi i shumicës është një situatë e pavullnetshme që përjetojnë minoritetet apo pakicat gjuhësore²⁷.

26 Δαμανάκης, Μ. 1998. Η εκπαίδευση των παλιννοστούντων και αλλοδαπών μαθητών στην Ελλάδα. Διαπολιτισμική προσέγγιση. Αθήνα: Gutenberg.

27 Τριάρχη-Herrmann, Β. 2000. Η Διγλωσσία στην Παιδική Ηλικία: Μια Ψυχολογιστική Προσέγγιση Αθήνα: Gutenberg.

Bilinguizmi në moshën fëmijërore

Studimet sistematike lidhur me bilinguizmin e fëmijës nisën përafërsisht njëqind vjet më parë me studimin e Ronjat (1913), duke vijuar më tej me studimin madhështor nga Leopold (1939-1949). Çështja që ka tërhequr vëmendjen kryesore të studimeve lidhet me pyetjen nëse një fëmijë dygjuhësh/biling apo shumëgjuhësh/multiling arrin apo jo të ketë të njëjtën performancë në secilën nga gjuhët që ai zotëron, ashtu siç monolingët performojnë në një gjuhë të vetme.

Fëmija fiton zakonet e tij gjuhësore në gjuhën amtare deri në moshën 8 vjeç. Nga kjo moshë e tutje, fillon të funksionojë nëpërmjet proceseve njohëse. Analizon dhe krahason përmes gjuhës amtare, e cila punon negativisht në mësimin e një gjuhe të dytë. Kërkimet tregojnë se pas vitit të nëntë të jetës, gjuha amtare është mjeti i vetëm i të shprehurit dhe të menduarit dhe vepron në mënyrë të pandërgjegjshme, si një sistem “mbrojtës”, në prani të një gjuhe të huaj. Ndaj nëse për arsye të ndryshme s’ka arritur të përvetësojë asnjë gjuhë, atëherë mundësia e përvetësimit të tyre më vonë do të humbasë përgjithnjë. Edhe pse me kalimin e kohës vetëdija dhe etja personale për më shumë kultura dhe më shumë gjuhë do të rritet, mundësitë për përvetësimin e gjuhëve do të jenë gjithnjë më të vogla dhe procesi do të rrjedhë me më shumë vështirësi²⁸.

Çdo fëmijë biling është unik dhe nëse nuk ka ndonjë problem me inteligjencën apo stabilitetin e tij psikik, atëherë ai është në gjendje t’i mësojë paralelisht të dyja gjuhët. Duke krahasuar funksionin e të menduarit kreativ midis një fëmije monoling dhe një biling është gjetur se fëmija biling ka më shumë mundësi për të zhvilluar fleksibilitetin dhe kompleksitetin e të menduarit krahasuar me fëmijën që përdor vetëm një gjuhë. Kjo ndodh sepse bilingët çdo objekt ose ide kanë mundësinë ta përpunojnë nëpërmjet dy ose më shumë fjalëve dhe në këtë mënyrë mund të zhvillojnë shumëllojshmëri më të madhe të kuptimeve se monolingët²⁹. Volterra & Taeschner (1978), pas një studimi të gjatë lidhur me zhvillimin gjuhësor tek fëmijët, zhvilluan një model të zhvillimit gjuhësor biling. Ata zhvilluan modelin e tri fazave të zhvillimit të njëkohshëm biling të cilat janë: a) Faza e parë (1-2 vjeç); në këtë fazë fjalët i përkasin të njëjtës gamë semantike për të dyja gjuhët. Kjo pasqyron faktin se në këtë moshë fëmija përdor një fjalor të përbashkët për të dy gjuhët, të cilat me kalimin e kohës i ndryshon në dy sisteme semantike. Fjalori është vazhdimisht duke u zhvilluar dhe nuk ka fjalë korresponduese nga çdo gjuhë; b) Faza e dytë (2-3 vjeç); në këtë fazë fëmija kupton se në mjedisin e tij fliten dy gjuhë të ndryshme. Ata fillojnë të përdorin paralelisht fjalë nga të dyja sistemet gjuhësore, ndërsa për çdo koncept semantik të zotëruar, zhvillon dhe dy simbole përkatëse. Kupton grupimin dhe kategorizimin e fjalëve dhe përdor fjalë me

28 Τριάρχη-Herrmann, B. 2000. Η Διγλωσσία στην Παιδική Ηλικία: Μια Ψυχολογιστική Προσέγγιση Αθήνα: Gutenberg.

29 Ricciardelli, L. A. 1992. *Creativity and bilingualism*. The Journal of Creative Behavior, 26(4), 242-254.

strukturë të thjeshtë fonologjike duke shmangur ato komplekse. Transferohet me lehtësi nga një gjuhë në tjetrën dhe fillon ndërgjegjësimin e zhvillimit të dy gjuhëve së bashku me zhvillimin e vetëdijes metalinguistike. Fushat morfologjike dhe sintaksore nuk kanë asnjë diferencim ; dhe c) Faza e tretë (3-< vjeç); në këtë fazë ka dy sisteme të ndara semantike dhe dy fusha morfologjike e sintaksore për çdo gjuhë. Përfundon diferencimi i rregullave sintaksore dhe morfologjike të dy sistemeve gjuhësore, bën përgjithësimet e rregullave dhe transferimit nga një gjuhë në tjetrën, përvetëson nivelin morfologjik dhe sintaksor të çdo gjuhe dhe kupton se me çdo bashkëbisedues i duhet të flasë një gjuhë të veçantë³⁰.

Fëmijët e ekspozuar ndaj shumë gjuhëve vijnë në kontakt me kultura, njerëz dhe pikëpamje të tjera. Ata e kanë më të lehtë ndërtimin e identitetit personal dhe nacional, sepse përparësia bilingve u mundëson qasje bikulturale³¹, duke mësuar gjuhën dhe kulturën e vendit pritës, ndërsa ruajnë gjuhën, kulturën dhe zakonet e vendit të origjinës. Në këtë mënyrë, vendoset një themel i mirë në shoqërinë pritëse dhe ruhet lidhja me kulturën e prindërve³².

Bilinguizmi në moshën madhore

Disa studime insistojnë në përfundimin se askush nuk të quhet biling i vërtetë nëse nuk i ka fituar dy gjuhët që në moshën fëmijërore ose të paktën në një moshë shumë të vogël. Por në fakt, jo! Bilinguizmi mund të fitohet në çdo moment, gjatë gjithë jetës së një individi - në fëmijëri, në adoleshencë, ose në moshë madhore, duke marrë parasysh se e kanë fituar gjuhën e dytë apo dhe të tretë në kohë të ndryshme të jetës së tyre dhe jo domosdoshmërisht në fëmijërinë e hershme³³.

Ka shumë arsye që sjellin gjuhët në kontakt duke krijuar mjedise të reja gjuhësore, të cilat si rrjedhojë, nxisin bilinguizmin³⁴. Këta faktorë, të cilët krijojnë nevoja të ndryshme gjuhësore duke lidhur drejtpërdrejt përdorimin e dy apo më shumë gjuhëve njëkohësisht dhe duke zhvilluar kompetencat gjuhësore në masën e kërkuar nga këto nevoja, mund të jenë migrime të llojeve të ndryshme - ekonomike, arsimore, politike

30 Volterra, V., Taeschner, T. 1978. The acquisition and development of language by bilingual children. *Journal of Child Language*, 5, pp. 311-326. Reprinted (2007) in L. Wei (ed) *The bilingual reader*, 301 - 320. New York: Routledge.

31 Τριάρχη-Herrmann, B. 2000. Η Διγλωσσία στην Παιδική Ηλικία: Μια Ψυχολογιστική Προσέγγιση Αθήνα: Gutenberg.

32 Portes, A., Rivas, A. 2012. *The adapton of migrant children*. The future of children, vol 21, no 1.

33 Grosjean, F. 2010. *Bilingual: Life and Reality (Myths about bilingualism)*. Harvard University Press.

34 Βασιλειάδου, Π. 2018. Οι δίγλωσσοι μαθητές στο σύγχρονο Επαγγελματικό Λύκειο. Τμήμα Παιδείας – Δια Βίου Μάθησης Δήμου Κορδελιού - Ευόσμου.

http://1epal-evosm.eu/images/2017-2018/site_docs/Diglossia_arthro.pdf

apo fetare; arsimimi dhe kultura; tregtia; martesat e përziera; nevoja për të ardhur në kontakt me autoritetet publike të vendit pritës apo për të marrë pjesë në ngjarjet politike dhe shoqërore etj.³⁵

Bilingu i rritur, në krahasim me bilingun fëmijë mund të klasifikohet vetëm në disa kategori bilinguizmi. Ky klasifikim lidhet drejtpërdrejt me:

- a) kriteret e përvetësimit të gjuhës së dytë - bilinguizmi i vazhdueshëm (kur përvetësimi i një gjuhe të dytë bëhet në një moshë në të cilën gjuha e parë është stabilizuar, pas vitit të tretë të moshës); bilinguizmi i vonë (kur gjuha e dytë është mësuar gjatë adoleshencës ose dhe më vonë); bilinguizmi kulturor (kur përvetësimi i gjuhës së dytë arrihet përmes mësimdhënies formale duke ndjekur mësimet në një shkollë apo në një kurs).
- b) kriteret gjuhësore - bilinguizëm i koordinuar (kur personi mëson përmendësh simbolet dhe domethënien e tyre përkatëse konceptuale veçmas në të dyja gjuhët; bilinguizëm të varur (kur personi mëson një gjuhë të dytë me ndihmën e gjuhës së tij të parë, pra, kur struktura e gjuhës së dytë varet nga struktura e gjuhës së parë).
- c) kriteret individuale dhe sociale - bilinguizëm individual dhe shoqëror (ku dy variante të të njëjtës gjuhë (i lartë dhe i ulët) bashkëjetojnë dhe secili kryen funksione të ndryshme shoqërore); bilinguizëm i elitës (kur individët mësojnë gjuhë të tjera, sepse në mjedisin ku ata jetojnë mësimi i gjuhëve të huaja është një element arsimit dhe kulture, ose sepse kështu mund të vijë në kontakt me folësit amtarë të kësaj gjuhe për të studiuar kulturën, letërsinë dhe historinë e saj, ose, sepse vetë njerëzit e konsiderojnë mësimin e gjuhëve të huaja një eksperiencë interesante; bilinguizëm i shumicës (kur individët janë të detyruar të mësojnë një gjuhë të dytë sepse duhet të përballen me kërkesat e jetës së përditshme, pasi gjuha e dytë është e domosdoshme në mjedisin ku jetojnë³⁶. Përkundër diversitetit të madh që ekziston midis këtyre njerëzve, të gjithë kanë në jetën e tyre më shumë se një gjuhë.

Mësimi i një gjuhe të huaj në moshë të vogël është krejt ndryshe nga të mësuarit e gjuhës së dytë në moshë madhore. Kur një i rritur zgjedh për të mësuar një gjuhë të huaj dhe vendos në favor të saj, merr parasysh elementin e afinitetit gjuhësor, pra, ai zgjedh të mësojë një gjuhë që i përafrohet gjuhës që ai njih shumë mirë; p.sh. nëse njih italisht, e ka më të lehtë të mësojë frëngjisht etj. Megjithatë, për një nxënës/student i cili studion në një mjedis gjuhësor të huaj, afiniteti i gjuhëve është një çështje dytësore. Atij nuk i ofrohet mundësia e zgjedhjes; është i detyruar të mësojë atë gjuhë - pavarësisht nga afiniteti i sistemeve gjuhësore. Në këtë rast bilinguizmi është i imponuar, jo i zgjedhur.

35 Grosjean, F. & Li, P. 2013. *The Psycholinguistics of Bilingualism*. Malden, MA & Oxford: Wiley-Blackwell.

36 Τριάρχη-Herrmann, B. 2000. Η Διγλωσσία στην Παιδική Ηλικία: Μια Ψυχολογική Προσέγγιση Αθήνα: Gutenberg.

Pra, faktori kryesor që drejton në përvetësimin dhe zhvillimin e një gjuhe është nevoja për të - nevoja për të ndërvepruar me të tjerët, për të studiuar ose punuar, për të marrë pjesë në aktivitete shoqërore etj. Megjithatë për përfundimin e procesit të bilinguizmit nga të rriturit, duhet të jenë prezentë edhe disa faktorë shtesë, si: qëndrimi pozitiv/miratimi ndaj gjuhës dhe identiteteve kulturore të vendit në fjalë - si rrjedhojë dhe ndaj dygjuhësisë; ndihma e familjes, miqve, kolegëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Bilingët ndryshojnë nga njëri-tjetri në një numër të variablave. Përveç faktorëve kryesorë si moshë, gjinia, statusi socio-ekonomik dhe arsimor, takojmë dhe faktorë të tjerë plotësues, të tillë, si: konfigurimi i repertorit gjuhësor paralelisht me kompetencën globale të këtyre gjuhëve, historiku i përvetësimit të gjuhëve (kur dhe si janë fituar e përdorur këto gjuhë), qëndrueshmëria gjuhësore (a janë ende këto gjuhë në proces përvetësimi/ristrukturimi), kompetenca gjuhësore e secilës gjuhë - bazuar në katër aftësitë gjuhësore përkatëse (të lexuarit/ të shkruarit/ të folurit/ të dëgjuarit), përdorimi i gjuhëve (cilat gjuhë përdoren, kur, me kë dhe për çfarë arsye), situatat, bashkëbiseduesit dhe funksionet e reja të gjuhës (a ndryshon mjedisi dhe funksioni i përdorimit të gjuhëve) etj.³⁷

Që një individ i moshës madhore të identifikohet si biling, kriter themelor mbetet niveli i aftësisë gjuhësore dhe përdorimi i gjuhës. Bilingët, për shkak se nevojat dhe përdorimet e gjuhëve janë mjaft të ndryshme, rrallë zhvillojnë një shkallë të barabartë dhe të plotë në secilën gjuhë. Niveli i rrjedhshmërisë së arritur në një gjuhë, më saktësisht, në një nga kompetencat gjuhësore, do të varet nga nevoja për atë gjuhë dhe do të jetë specifike për një sektor të veçantë. Edhe në rastet kur rrjedhshmëria paraqitet në nivele të larta, shpesh bilingët mbajnë theksin e gjuhës së tyre të parë. Nëse kompetencat gjuhësore e të lexuarit dhe të shkruarit nuk do të jenë të nevojshme në një gjuhë, ato nuk do të zhvillohen. Nëse flitet një gjuhë me një numër të kufizuar përdoruesish ose një numër të reduktuar fushash, atëherë rrjedhshmëria e saj do të jetë më e ulët dhe përdorimi i saj më i kufizuar. Përveç kësaj, këta individë nuk kanë të njëjtën rrjedhshmëri në të gjitha gjuhët dhe shpesh, në gjuhën që kanë përvetësuar së fundmi, mbartin theksin e gjuhës së parë³⁸. Për këtë arsye dhe sipas këtij parimi shpjegohet pse bilingët zakonisht nuk janë dhe përkthyes shumë të mirë. Disa nuk njohin ekuivalentët e përkthimit në gjuhë të tjera - fjalë, fraza, shprehje të caktuara etj., çka mund të përkthehet në perceptime dhe probleme riprodhimesh gjuhësore.

Në lidhje me nivelin gjuhësor të një individi biling, huazimi apo dhe transferimi i elementëve zakonisht realizohet nga gjuha që përdoruesi njeh më mirë drejt gjuhës së dytë (gjuhës që ai përpiket të mësojë). Në rastet kur në jetën e një bilingu dominon një fushë me një mjedis të caktuar gjuhësor - p.sh. profesional, fetar, politik, sportiv etj.,

37 Grosjean, F. 1997. *The bilingual individual*. Interpreting, 2(1/2), 163-187.

38 Grosjean, F. & Byers-Heinlein, K. 2018. *Bilingual adults and children: A short introduction*. në Grosjean, F. & Byers-Heinlein, K. 2018. pp. 4-24.

atëherë kjo fushë mbulohet plotësisht nga leksiku i një gjuhe. Me përjashtim të rasteve kur një biling ka përvetësuar gjuhën e dytë paralelisht me mësimin e ekuivalentëve të përkthimit, në rastet e tjera ka mungesë të theksuar leksiku, edhe pse individit biling mund të ketë rrjedhshmëri të plotë në të dyja gjuhët³⁹. Megjithatë duke marrë parasysh profilin gjuhësor të një bilingu në përdorimin e gjuhëve, hasim shkëmbin të kodeve gjuhësore (angl. kode switching), huazime, ndërhyrje etj.

E megjithatë, qëndrimet mbi dygjuhësinë apo shumëgjuhësinë janë kontradiktore; ekzistojnë si efekte pozitive, ashtu edhe negative. Sigurisht, ndërkohë që kërkojmë efektet pozitive dhe/ ose negative të bilinguizmit, duhet marrë parasysh mjedisi i përgjithshëm socio-linguistik në të cilin u përvetësua gjuha e dytë dhe/ose e tretë.

Disa nga avantazhet⁴⁰ dhe disavantazhet⁴¹ e individit janë: avantazhet: komunikimi: njohja e dy ose më shumë gjuhëve mundëson zgjerimin e rrjeteve të komunikimit të një personi. Përveç kësaj, njohja e gjuhës së trashëgimisë (angl. heritage language), lejon komunikimin me anëtarët e familjes, ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve dhe transferimin e trashëgimisë kulturore nga një brez në tjetrin; aspekti socio-ekonomik: njohja e të paktën dy gjuhëve kontribuon në përmirësimin e nivelit të arsimit, i cili është një faktor vendimtar në rritjen e mundësive të punësimit të individit dhe të të ardhurave të tij; aspekti social-emocional: përfitimet komunikuese dhe socio-ekonomike rezultojnë në forcimin e vetëbesimit të individit biling; aspekti kulturor: fëmijët jo vetëm që mësojnë zakonet dhe varietetet shoqërore në stilin bisedor në të paktën dy gjuhë, por përvojnë e tyre bilinge janë një sfidë mbi mënyrën se si ata e shohin botën, por edhe identitetin e tyre social. Ky këndvështrim u jep atyre një perspektivë të ndryshme dhe më të gjerë mbi ngjarjet dhe njerëzit, duke i bërë ata më tolerantë dhe të ndjeshëm ndaj çështjeve të diversitetit kulturor, racial dhe gjuhësor; aspekti njohës: individët bilingë në krahasim me ata monolingë, paraqesin procese njohëse/fleksibël në fusha si: kuptimi i koncepteve matematikore dhe zgjidhja e problemeve; logjika dhe gjykimi; zhvillimi i kujtesës, përqendrimi i vëmendjes dhe marrja e vendimeve të qëndrueshme; vetëkontrolli; disavantazhet: “teoria e balancës”: sipas këtij perceptimi, përvetësimi i një gjuhe të dytë ka pasoja të dëmshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e gjuhës së parë, pasi disku i gjuhës së dytë anon gjithnjë e më shumë në duke dëmtuar diskun e gjuhës së parë. Pra, marrëdhënia që zhvillohet midis dy gjuhëve është në thelb një marrëdhënie e peshës dhe kundërpeshës, ashtu siç ndodh në një peshore; “teoria e tullumbaceve”: sipas këtij perceptimi, aftësia gjuhësore tek një person monoling duket se zë hapësirën e një tullumbace të fryrë; tek personi biling ekzistojnë dy tullumbace, por ato ndajnë të

39 Grosjean, F. 1997. The bilingual individual. Interpreting, 2(1/2), 163-187.

40 Baker, C. 2011. *Foundations of Bilingual Education and Bilingualism (5th Edition)*. Clevedon: Multilingual Matters, in Stamouli, S. 2014. Σύνοψη εισαγωγή στη διγλωσσία. Επιμορφωτικός Οδηγός. Βασικές Αρχές για τη Διδασκαλία της Ελληνικής ως Δεύτερης/ Ξένης Γλώσσας (Επίπεδα Α1- Β2). Επιμέλεια έκδοσης: Μαρία Ιακώβου.

41 Baker C. (2001) Εισαγωγή στη Διγλωσσία και στη Δίγλωσση Εκπαίδευση (επιμ.- εισαγ. Μ. Δαμανάκης, μτφ. Α. Αλεξανδροπούλου) Αθήνα: Gutenberg.

njëjtën hapësirë në brendësi të trurit dhe, për këtë arsye, sa më shumë hapësirë zë aftësia në një gjuhë, aq më pak hapësirë mbetet në dispozicion për gjuhën e dytë.

Përfundime

Ndryshimet e vazhdueshme e të shpejta të vërejtura gjatë viteve të fundit, kanë sjellë ndryshime domethënëse si në strukturat sociale dhe demografike, ashtu edhe në ato kulturore e gjuhësore në mbarë botën. Si rrjedhojë, shoqëria ka fituar një karakter shumëkombësh dhe diversitet kulturor e gjuhësor. Nevoja për komunikim midis individëve të kombësive të ndryshme me gjuhë, zakone dhe tradita të ndryshme, është një fenomen i përditshëm dhe përvetësimi e përdorimi i dy a më shumë gjuhëve vret re në shumicën e individëve të çdo shtrese shoqërore.

Mësimi i një gjuhe të dytë apo edhe më shumë është një fenomen kompleks pasi drejtohet nga një larmi faktorësh. Këta faktorë, gjuhësorë dhe jogjuhësorë, lidhen me parametrat individualë, emocionalë dhe konjitivë, të cilët nuk veprojnë në mënyrë të njëanshme, por bashkëveprojnë. Përcaktimi i një tipologjie të strukturuar të faktorëve që ndikojnë në ritmin dhe ecurinë e mësimit të një gjuhe të dytë nuk është një detyrë e lehtë, siç dëshmohet nga qasjet dhe sugjerimet e ndryshme të studiuesve. Megjithatë, faktorët individualë më të rëndësishëm që ndikojnë në mësimin e një gjuhe të dytë janë: gjuha amtare, mënyra e të mësuarit të gjuhës së huaj, predispozita, motivimet, qëndrimet, personaliteti, mënyra dhe strategjitë e të mësuarit, mosha dhe gjinia.

BIBLIOGRAFIA:

- BAKER, c & JONES, s.p. (1998), Encyclopedia of Bilingismand Biling Education Multilingual matters. ISBN: 1853593621.
- BAKER, c. (2001), Foundations of Biling Education and Bilingism (3rd Ed.). Clevendon: Multilingual Matters LTD in Επιμορφωτικός Οδηγός. Βασικές Αρχές για τη Διδασκαλία της Ελληνικής ως Δεύτερης/ Ξένης Γλώσσας (Επίπεδα Α1-Β2). Επιμέλεια έκδοσης: Μαρία Ιακώβου.
- CALVET, J. L. (2002), La sociolinguistique. Paris, Presses universitaires de France.
- CUMMINS, J. (2003-2005), (μετ. Σ. Αργύρη, εισ.-επιμ. Ε. Σκούρτου), Ταυτότητες υπό διαπραγμάτευση. Εκπαίδευση με σκοπό την Ενδυνάμωση σε μια Κοινωνία της Ετερότητας. Αθήνα: Gutenberg, Β' έκδοση βελτιωμένη.
- DIEBOLD, A. R. (1961), Incipient Bilingism. Language 37, no.1. 97-112. doi:10.2307/411253.
- GROSJEAN, f. & BYERS-HEMLEIN, k. (2018), Biling adults and children: A short introduction. në
- GROSJEAN, f. & BYERS-HEMLEIN, k. (2018), pp. 4-24.
- GROSJEAN, f. & LI, p. (2013), The Psycholinguistics of Bilingism. Malden, MA & Oxford: Wiley-Blackwell.
- GROSJEAN, f. (1989), Neurolinguists, Beware! The Biling Is Not Two Monolinguals in One

Person. *Brain and Language*, 36, 3-15.

GROSJEAN, F. (1997), The bilingual individual. *Interpreting*, 2 (1/2), 163-187.

PORTES, A. RIVAS, A. (2011), The adaptation of migrant children. *The future of children*, vol 21, no 1.

RICCIARDELLI, L. A. (1992), Creativity and bilingualism. *The Journal of Creative Behavior*, 26(4), 242-254.

SHKURTAJ, GJ. (2009), *Sociolinguistik e shqipes*, Morava, Tiranë.

VOLTEERRA, V., TAESCHNER, T. (1978), The acquisition and development of language by bilingual children. *Journal of Child Language*, 5, pp. 311-326. Reprinted (2007) in L. Wei (ed) *The bilingual reader*, 301 - 320. New York: Routledge.

Βασιλειάδου, Π. 2018. Οι δίγλωσσοι μαθητές στο σύγχρονο Επαγγελματικό Λύκειο. Τμήμα Παιδείας - Δια Βίου Μάθησης Δήμου Κορδελιού-Ευόσμου. http://1epal-evosm.eu/images/2017-2018/site_docs/Diglossia_arthro.pdf

Δαμανάκης, Μ. (1998), *Η εκπαίδευση των παλιννοστούντων και αλλοδαπών μαθητών στην Ελλάδα. Διαπολιτισμική προσέγγιση*. Αθήνα: Gutenberg.

Σελλά-Μάζη, Ε. (2001), *Διγλωσσία και κοινωνία. Η κοινωνιογλωσσολογική πλευρά της διγλωσσίας. Η ελληνική πραγματικότητα*. Αθήνα: Προσκήνιο.

Σκούρτου, Ε. (2002), Δίγλωσσοι μαθητές στο ελληνικό σχολείο. *Επιστήμες Αγωγής, Θεματικό τεύχος* 2002, 12.

Τριάρχη-Herrmann, B. (2000), *Η Διγλωσσία στην Παιδική Ηλικία: Μια Ψυχολογιστική Προσέγγιση* Αθήνα: Gutenberg.

MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA NË SHKOLLAT SHTETËRORE TË SHQIPËRISË NË VITIN E PARË TË ÇLIRIMIT (1945-1946)

Dr. Artan Fida

E-mail: artanfida@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Artikulli paraqet një panoramë pothuajse të plotë, mbi bazën e të dhënave arkivore, të shkollave shtetërore të vendit, sipas cikleve, gjuhëve, mësuesve që dhanë mësim, teksteve shkollore që u përdorën në mësimdhënie në vitin 1945-1946 - viti i parë shkollor pas luftës.

Fjalët çelës: histori arsimit, histori e mësimi të gjuhëve të huaja, mësues e tekste të gjuhëve të huaja

ABSTRACT

This article presents a nearly complete overview, based on archival documents, of the foreign languages teaching in Albanian state schools during the year 1945-1946, the first academic one after the WW2, according to: the school levels, the languages taught, the textbooks used and the teachers involved.

Keywords: foreign language teaching history, foreign language teachers, foreign language textbooks, history of education in Albania

Parathënie

Qëllimi i këtij shkrimi është të paraqesë në mënyrë të detajuar gjendjen e mësimi të gjuhëve të huaja në shkollat shtetërore të Shqipërisë në vitin 1945-1946 – viti i parë shkollor i rregullt pas Çlirimit – e, posaçërisht, shkollat ku u mësua gjuha e huaj, gjuhët që u mësuan, mësuesit që dhanë mësim, programet dhe tekstet që u përdorën për mësimin e tyre. Kombinimi i burimeve parësore (dokumente arkivore, programe zyrtare, tekste mësimore) me studime e shkrime mbi historinë e arsimit, si dhe analiza dhe ballafaqimi i të dhënave mes tyre mundësuan zgjidhjen e rasteve kur dokumentacioni ka zbrazëti, paqartësi apo mospërputhje. Duke mbajtur parasysh objektin e shkrimit, që është paraqitja e mësimdhënies së gjuhëve të huaja në një vit të caktuar, gjykuam se metoda kërkimore më e përshtatshme është ajo historike, ngaqë mundëson shqyrtimin dhe analizën e një numri të madh të dhënash dhe paraqitjen e përfundimeve sipas kriterit tematik. Në shkrim bëhen herë pas here krahasime të natyrës së përgjithshme me vitet shkollore para/pasrendëse.

Hyrje

Viti shkollor 1945-1946 qe i pari vit i rregullt pas përfundimit të luftës, dhe i dyti që pas ndryshimeve të mëdha politiko-shoqërore në vend. Në përgjithësi, mësimi u zhvillua në kushte shumë të vështira: ndërtesat shkollore qenë në gjendje të mjerueshme, orëditë shkollore e mjetet didaktike të domosdoshme për mësim mungonin masivisht, një pjesë e konsiderueshme e mësuesve nuk kishin përgatitjen e duhur profesionale e pedagogjike, ngaqë ishin ose me arsim fillor ose me arsim të mesëm të papërfunduar.

Edhe në atë vit në shkollë u përdorën programet dhe tekstet që kishin qenë në përdorim para e gjatë luftës; atyre iu bënë vetëm disa ndërhyrje të domosdoshme në përmbajtje, që konsistuan kryesisht në heqjen e pasazheve me frymë fashiste dhe klasore. Programe krejtësisht të reja u hartuan dhe u vunë në zbatim vetëm në vitin shkollor pasardhës 1946-1947, në vijim të miratimit të reformës arsimore (gusht 1946).

Arsimi i përgjithshëm në vitin shkollor 1945-1946 ishte 11 vjet dhe shtrihej në këto cikle: shkolla fillore (4-vjeçare), shkolla e mesme e ulët ose unike (mbi shkollën Fillore, 3-vjeçare) dhe shkolla e mesme e lartë (mbi shkollën e mesme të ulët ose unike, 4-vjeçare)⁴². Si paraqitet gjendja e mësimi të gjuhëve të huaja në secilin prej këtyre cikleve?

1. Gjuha e huaj në shkollën fillore

Plani mësimor i vitit shkollor 1945-1946 ishte i njëjtë me atë të vitit paraardhës 1944-1945, por me një klasë më pak⁴³. Në shkollën fillore nuk mësohej gjuha e huaj si lëndë mësimore⁴⁴.

2. Gjuha e huaj në shkollën e mesme e ulët (unike)

Pas përfundimit të ciklit fillor, nxënësit kalonin në shkollën e mesme, e cila, sipas traditës ishte ‘e ulët’ dhe ‘e lartë’. Shkolla e mesme e ulët quhej ‘unike’ dhe ishte me

42 Paçrami, F. *Në rrugën për ndërtimin e shkollës sonë të re*. Arësimi Popullor, n.1947, n.8-9, f.16

43 Plani mësimor përmbante këto lëndë: Gjuhë shqipe, Mësim jete, Arithmetikë, Histori, Gjeografi, Mësime natyre, Mësime sendesh, Mësime shtetnore, Vizatim-punëdore, Kangë, Gjinnastikë (Për vajzat shtoheshin edhe lëndët: Qeverimi i shtëpisë e Qepje). Shih: Shtojca e Programës për shkolla fillore 5 klasësh. Ministrija e Arsimit, Tiranë, 1944, f.6-7

44 Në shkollë vendi, në atë vit funksionuan 1.028 shkolla fillore, nga të cilat 139 shkolla ishin vetëm me 1 klasë (dmth klasën e parë), 286 me 2 kl., 223 me 3 kl., 192 me 4 kl., e 188 me 5 klasë. Shih: Plani i Ministrisë së Arsimit për një vit deri në prill 1947. AQSH, F(ondi) 511, V(iti) 1946, D(osja) 1, fl.2

3 klasë (dmth 3-vjeçare)⁴⁵. Dy vite më pas, në vitin shkollor 1947-1948⁴⁶, bashkimi i shkollës unike me atë fillore çuan në krijimin e shkollave 7-vjeçare⁴⁷.

Në atë vit shkollor, përveç shkollave unike të plota me 3 klasë, që funksionuan pranë shkollave të mesme, u hapën 20 unike të reja, kryesisht në qendër prefekturë e nënprefekturë. Ndër këto të fundit, 10 shkolla kishin vetëm klasën e parë, 10 të tjera edhe klasën e dytë⁴⁸. Nxënësit e këtij cikli, që ishin 4.580 gjithsej në atë vit shkollor⁴⁹, mësuan 1 gjuhë të huaj⁵⁰, me 4 orë në javë në secilën klasë. Dokumentacioni arkivor na ndihmon të hedhim dritë mbi mësimin e gjuhës së huaj në disa prej këtyre shkollave:

1) Në shkollën unike ‘M.Çollaku’ të Pogradecit, e sapoçelur, 58 nxënësit e klasës së parë e të vetme mësuan frëngjisht, me mësuesin Virgjl Ballamaçi⁵¹.

2) Në shkollën unike të Bilishtit, e sapoçelur, 35 nxënësit e klasës së parë mësuan frëngjisht, me mësuesin Hilmi Aliu⁵².

3) Në uniken e Peshkopisë u mësua frëngjisht, me mësues Edip Tërshanën⁵³.

4) Në uniken e Ersekës u mësua italisht⁵⁴.

5) Shkolla unike me 1 e 2 klasë funksionuan edhe në qytetet: Kavajë, Fier, Përmet, Himarë, Krujë e Kukës⁵⁵. Në nivelin e shkollës unike u ngrit edhe shkolla ushtarake e Tiranës (më vonë Shkolla ushtarake ‘Skënderbej’). Nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna mbi gjuhët, mësuesit e tekstet mësimore të këtyre shkollave. Të dhëna jo të plota ekzistojnë edhe për shkollat unike që funksionuan pranë shkollave të mesme, si:

1) Në uniken pranë institutit tregtar të Vlorës u mësua frëngjisht, me tekstin France - Première année de Français, me mësuesin Dhimitër Pilika⁵⁶.

2) Në uniken pranë shkollës normale të Elbasanit u mësuan frëngjisht (4 klasat e para e

45 “Në programin e ri të shkollave, arësimi i mesmë do të ndahet në dy periudha: periudha e parë 3-vjeçare do të quhet shkollë unike. Periudha e dytë 4-vjeçare do të jetë e ndarë në këto degë: Liceu Klasik dhe Shkencuer, Shkolla Teknike, Shkolla Normale, Shkolla Tregëtare. Nxënësi ose nxënësja që do të ketë mbaruar shkollën unike ka të drejtë të hyjë në cilëndo nga degët e periudhës së dytë”. Shih: Qarkore e Ministrisë së Arsimit nr.1772, dt.5.10.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.22

46 Paçrami, F. *Në rrugën për ndërtimin e shkollës sonë të re*. Arësimi Popullor, n.1947, n.8-9, f.16

47 Në vitin shkollor 1947-1948, fillimisht në qendrat e mëdha urbane e, në vijim, edhe në qytetet e fshatrat e tjerë, shkollat unike u bashkuan me shkollat fillore dhe krijuan shkollat 7-vjeçare. Shih: Qarkore e Min.Ars. n.1772, dt.5.10.1945

48 Plani i Ministrisë së Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.2

49 Arësimi Popullor, 1946, n.2-3

50 Programi i shkollës unike. Ministrija e Arsimit, Tiranë, 1945

51 Shkresë e shkollës unike të Pogradecit n.77, dt.12.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.71

52 Shkresë e shkollës unike të Bilishtit n.44/1, dt.1.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.64

53 Shkresë e shkollës unike të Peshkopisë n.48, dt.20.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.83

54 Njëri nga 2 mësuesit e shkollës, Ded Shala e Stavri Katundi, që mësues i italishtes. *Shih*: Shkresë e shkollës unike të Bilishtit, n.38, dt.15.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.65

55 Emrat e profesorëve të propozuem nga Min.Arsimit për shkollat unike, simbas vendit që janë caktuar, dërguar Kryeministrisë për miratim. AQSH, F.511, V.1945, D.31

56 Shkresë e inst.tregtar të Vlorës n.436, dt.29.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.132

3 klasat e dyta) dhe italisht (3 klasat e treta)⁵⁷.

- 3) Në shkollën unike pranë liceut të Shkodrës u mësuan frëngjisht (kl.I^A, II, III, IV^A, IV^B, V), me mësuesit: Qemal Draçini, Ndoc Kamsi, Abdyl Kajanaku e Rexhep Neziri⁵⁸, me tekstet France-première année... dhe France-deuxieme année...⁵⁹, dhe italisht (kl. I^B, II, III, IV^A, IV^B, V, VI), me mësuesit: Fadil Podgorica, Kolë Kamsi e Filip Ndocaj⁶⁰.
- 4) Në shkollën unike pranë ish-institutit femëror të Shkodrës u mësuan italisht, me mësuesen Ballkize Tela, dhe frëngjisht (kl.III), me mësuesin Kolë Alimhilli⁶¹.

Shkolla unike me 3 klasë funksionuan edhe pranë shkollave të mesme: 3 në Tiranë⁶² (pranë liceut, instituteve femëror e teknik), nga 1 unike pranë liceve në Durrës⁶³, në Korçë⁶⁴, në Gjirokastrë⁶⁵ e 1 në Berat (pranë shkollës normale).

Duhet theksuar se gjendja e përgjithshme e shkollave unike, kryesisht e atyre të sapoçelura, linte shumë për të dëshiruar: mjedise shkollore të papërshtatshme, mësues të pakualifikuar, mungesë mjetesh didaktike të domosdoshme etj. Klasat e unikeve pranë shkollave të mesme qenë të tejmbushura me nxënës. Të gjitha këto vështirësi ndikuan në zhvillimin normal të mësimi⁶⁶.

3. Gjuha e huaj në shkollën e mesme të lartë

Në atë vit shkollor funksionuan 12 shkolla të mesme, me 2.563 nxënës⁶⁷ e 280 mësues⁶⁸. U punua me dy programe⁶⁹: nxënësit që përfunduan kl.III e IV të tipit të vjetër, kaluan respektivisht në kl.I e II dhe ndoqën programin e ri; nxënësit që përfunduan kl.V, VI e VII të tipit të vjetër, kaluan respektivisht në kl.VI, VII e VIII të tipit të vjetër dhe

57 Shkresë e shk.normale të Elbasanit n.112/8, dt.30.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.24

58 Shkresë e liceut të Shkodrës nr.2, dt.10.09.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.33

59 Shkresë e liceut të Shkodrës nr.274, dt.8.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

60 Shkresë e liceut të Shkodrës nr.2, dt.10.09.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.33

61 Shkresë e inst.femnuer 'D.Kastrioti' Shkodër, nr.2, dt.27.09.1945. AQSH, F.511, 1945, D.33

62 Kuadri i Arësimit të Mesëm. Kuadri i tri shkollave unike të Tiranës. Arësimi Popullor, 1946, n.4, f.35

63 Pasqyra e nxanësve të regjistruem dhe frekuentues në shkollën unike dhe në lyce. Drejtoria e Lyceut Durrës, v.shkollor 1945-1946. AQSH, F.511, V.1946, D.15. *Shih* edhe: Shkresë e liceut të Durrësit nr.125, dt.20.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, f.7

64 Shkresë e liceut të Korçës 'R.Qirinxhi' n.536/X, dt.7.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.41-46

65 Shkresë e liceut të Gjirokastrës nr.15/5, dt.1.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, f.34

66 Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.1

67 Arësimi Popullor, 1946, n.2-3

68 Në këtë numër përfshihen edhe mësuesit e shkollave unike që funksiononin pranë shkollave të mesme. *Shih*: Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.3

69 Qarkore të Min.Arsimit nr.1772, dt.5.10.1945, dhe nr.534/67, dt.11.10.1945. AQSH, F.511, 1945, D.22

vijuan me programin e vjetër⁷⁰. Shkollat e mesme edhe në atë vit shkollor vijuan të ishin të kategorizuara në 4 lloje: a) lice, b) teknike, c) normale, ç) tregtare⁷¹.

a) Liceu. Në atë vit funksionuan 5 të tillë: i Shkodrës, i Tiranës, i Korçës, i Gjirokastrës dhe i Durrësit⁷², me gjithsej 1.560 nxënës⁷³. Nxënësit e degës klasike⁷⁴, ndër 18 lëndë, mësuan 3 gjuhë të huaja: 1 moderne, me përkatësisht 3 orë në javë përgjatë 4 viteve, dhe 2 gjuhë klasike: latinisht, me përkatësisht 6, 6, 4, 5 orë, dhe greqisht e vjetër, me përkatësisht 4, 5, 4, 5 orë në javë⁷⁵. Nxënësit e degës shkencore, ndër 17 lëndë, mësuan 2 gjuhë të huaja, që të dyja moderne: një të parë me përkatësisht 3 orë në javë përgjatë 4 viteve, e një të dytë me përkatësisht 6, 5, 4, 3 orë⁷⁶. Dallimi në numrin e orëve javore ndërmjet gjuhës së parë e të dytë vinte për shkak se gjuha e parë ishte vijimësi që nga cikli i ulët (ose unikja), ndërsa gjuha e dytë ishte e re, niste nga fillimi.

1) Në liceun e Shkodrës, në degët shkencore e klasike, u mësuan: a) frëngjisht⁷⁷ (kl.V, VI, VII, VIII), me mësues: Prenk Kaçinari, Rexhep Neziri⁷⁸, me tekstet France-première année ... e France-deuxième année...⁷⁹; b) italisht (kl.V, VI, VII, VIII), me mësues: Luigj Franja e Filip Ndoca⁸⁰ (si dhe Kolë Prela e Agetina Ashiku për një periudhë të caktuar⁸¹); c) serbo-kroatisht, me mësuesin Boris Urbançiç⁸². Në degën klasike u mësuan edhe: ç) latinisht, me mësues Pashko Gecin e Luigj Franjën, dhe d) greqisht, me mësuesin Pashko Geci⁸³. Në listën e lëndëve të provimit të maturës, krahas shqipes, matematikës, fizikës, pedagogjisë, bëjnë pjesë edhe: serbo-kroatisht, frëngjisht, italisht, latinisht e greqisht⁸⁴.

70 “Klasa VI gjatë këtij vjeti shkolluer ka zhvillue programin e klasës VI të gjimnazit të vjetit 1935”. *Shih*: Shkresë e liceut të Durrësit, nr.132, dt.13.08.1946. AQSH, F.511, 1945, D.22

71 “...Cikli i dytë 4-vjeçar i arsimit të mesëm do të jetë i ndarë në këto degë: Liceu Klasik dhe Shkencuer, Shkolla Teknike, Shkolla Normale, Shkolla Tregëtare.” *Shih*: Qarkore e Min.Arsimit nr.1772, dt.5.10.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.22

72 Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.2

73 Po aty, fl.3

74 Ky ishte viti i fundit që liceu ndahej në degë klasike e shkencore

75 Programi i liceut klasik e shkencor dhe i shkollës normale. Ministria e Arësimit, Tiranë, 1945

76 Po aty

77 Programe të shkollave të mesme të vendit për lëndët e ndryshme që zhvillohen në ato shkolla gjatë vitit shkollor 1945-1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

78 Shkresë e liceut të Shkodrës nr.2, dt.10.09.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.33

79 Shkresë e liceut të Shkodrës, nr.274, dt.8.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

80 Shkresë e liceut të Shkodrës nr.2, dt.10.09.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.33

81 Shkresë e Min.Arsimit nr.596, dt.4.02.1946 drejtuar liceut të Shkodrës. AQSH, V.1946, D.74

82 Shkresë e liceut të Shkodrës, nr.274, dt.8.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

83 Shkresë e liceut të Shkodrës nr.2, dt.10.09.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.33

84 Komisionet e gjuhëve të huaja përbëheshin nga: Pashko Geci e Gjovana Ndoja Noka (sllavisht), Mehmet Daiu e Agetina Ashiku (frëngjisht), Luigj Franja e Filip Ndoca (italisht), Pashko Geci e Luigj Franja (latinisht e greqisht). *Shih*: Procesverbal mbi provimet e pjekunis të liceut të Shkodrës në sesjonin e dytë të vj.shk.1945-1946. AQSH, F.511, V.1946, D.25

- 2) Në liceun e Durrësit, të kthyer në shkollë të mesme në dhjetor 1945⁸⁵, mbi bazën e shkollës qytetëse 4-vjeçare me drejtim tregtar⁸⁶, u hapën 2 kl.I (klasike e shkencore), 1 kl.II shkencore dhe 1 kl.IV⁸⁷. Fakti që kl.I punoi me program të ri, dhe kl.II e IV me të vjetrin⁸⁸, të bënë të mendosh se aty vijoi mësimi i italishtes, siç bëhej në vitet e mëparshme si shkollë tregtare⁸⁹, por mund të jetë futur edhe frëngjishtja si gjuhë e dytë.
 - 3) Në liceun e Gjirokastrës pati përkatësisht 44, 48, 37, 12 e 18 nxënës, sipas klasave IV-VIII⁹⁰. Nuk gjejmë të dhëna lidhur me gjuhët që u mësuan në atë vit. Duke u nisur nga fakti se, në vitin shkollor 1944-1945 aty u mësuan gjuhët a) italisht, b) frëngjisht e c) latinisht⁹¹, gjykojmë që mësimi i këtyre gjuhëve duhet të ketë vijuar edhe në vitin pasardhës 1945-1946.
 - 4) Në liceun e Tiranës u mësuan gjuhët: a) italisht, me mësuesin Alfredo Ingletti, b) frëngjisht, me mësues: Nonda Bulka, Sotir Koci e Vedat Kokona, c) serbo-kroatisht, me mësuesin Josif Depolo⁹²; në degën klasike u mësuan edhe ç) latinisht, me mësuesit Henrik Lacaj e Pashko Gjeçi, dhe d) greqisht e vjetër, me të njëjtët mësues⁹³.
 - 5) Në liceun e Korçës, me 285 nxënës, u mësuan: a) italisht, me mësues Anesti Havjari e Dhimitër Pilika⁹⁴, b) frëngjisht, me mësues Dhimitër Turtulli e Pandi Geço⁹⁵, c) serbo-kroatisht, me mësuesin Josif Cagleviç⁹⁶; në degën klasike u mësuan edhe: ç) latinisht, me mësuesin Anesti Havjari dhe d) greqishte e vjetër⁹⁷.
- Në vitin shkollor 1945-1946 funksionuan edhe 2 shkolla të mesme të përgjithshme vetëm për vajza: Instituti femëror i Tiranës dhe Instituti femëror i Shkodrës⁹⁸.

85 Hoxha, Astrit, Biografi e shkollave të rrethit të Durrësit. Tiranë, Globus R, 2001, f.49

86 Sipas kujtimeve të ish-nxënësit të kësaj shkolle, nxënësit që mbaruan kl.III të shkollës qytetëse në vitin shkollor 1944-1945, e nisën kl.IV në gjimnazin e shtetit. *Shih*: Hoxha, Astrit, vep.cit., f.26, 74

87 Drejtoria e Lyceut Durrës, viti shkollor 1945-1946. Pasqyra e nxënësve të regjistruar dhe frekuentues në shkollën unike dhe në Lyce. AQSH, F.511, V.1946, D.15. *Shih* dhe: Shkresë e liceut të Durrësit nr.125, dt.20.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, f.7

88 Min.Arsimit urdhëronte që kl.VI, VII e VIII të degës klasike e shkencore të punonin me programin e vjetër. *Shih*: Shkresë e Min.Arsimit nr.534/83, dt.6.12.1945, për liceun e Durrësit. F.511, 1945, D.22

89 Në v.shkollor 1944-1945 në shkollën tregtare të Durrësit u mësua gjuha italiane, me mësues Eqrem Stërmasin. *Shih*: Kuadri i personelit të shkollës tregtare Durrës. AQSH, F.511, V.1945, D.38, fl.4, 6

90 Shkresë e liceut të Gjirokastrës nr.15/5, dt.1.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, f.34

91 Në v.shkollor 1944-1945 u mësua: a) italisht (Vasil Progrri), b) frëngjisht (Foto Bala) e c) latinisht (Kolë Shiroka). *Shih*: Kuadri i personelit të liceut të Gjirokastrës. AQSH, F.511, V.1945, D.38, fl.12

92 Arësimi Popullor, 1946, n.2-3

93 Kuadri i personelit administrativ, mësues e shërbyes i liceut të Tiranës. AQSH, F.511, V.1945, D.38

94 U transferua në shkurt 1946 në Vlorë.

95 Arësimi Popullor, 1946, n.2-3

96 Josif Cagleviç dha mësim në periudhën 22.02.1946 - 4.07.1948. *Shih*: Listë emërore e teknikëve dhe specialistëve të huaj. Gjimnazi 'R.Qirinxhi' Korçë. AQSH, F.511, V.1952, D.47, fl.22

97 Shkresë e liceut të Korçës 'R.Qirinxhi' n.536/X, dt.7.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.41-46

98 Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.2

- 6) Në Institutin femëror të Tiranës, me 9 klasë në degët klasike e shkencore, me përkatësisht kl.IV 54 nxënës, kl.V 36 nxënës, kl.VI 29 nxënës, kl.VII 21 nxënës, kl.VIII 16 nxënës,⁹⁹ u mësuan: a) italisht, me mësueset Drita Gani, Franca Mandalà e Gleqeri Koça; b) frëngjisht, me mësuesit Elmas Çani, Vexhi Demiraj e Llazar Eftimiadhi; c) serbo-kroatisht, me mësuesen Ruzica Simiç; ç) latinisht, me mësuesin Nikollë Dakaj; d) greqisht e vjetër, me mësuesit Sotir Papahristo e Zijahudin Kodra¹⁰⁰.
- 7) Në Institutin femëror të Shkodrës u mësuan: a) italisht, me mësuesit Luigi Franja e Qemal Draçini, dhe b) frëngjisht, me mësuesit Kolë Alimhilli e Abdyl Kajanaku¹⁰¹.
- b) Shkolla teknike (ose instituti teknik). Funksionuan 2 të tilla, ajo e Tiranës dhe ajo e Korçës, me gjithsej 228 nxënës¹⁰². Në këto shkolla u mësua 1 gjuhë e huaj¹⁰³.
- 1) Në Institutin teknik ‘S.Staveleci’ të Tiranës, në dy degët e tij, ‘Ndërtim’ (kl.I, II, IV, VII) dhe ‘Mekanike’ (kl.I, II, VI)¹⁰⁴, lëndët e kulturës së përgjithshme u mbuluan nga mësues efektivë të liceut dhe të institutit femëror të Tiranës. U mësuan gjuhët: a) italisht, b) serbo-kroatisht, me mësues Ruzica Simiç e Josif Depolo¹⁰⁵.
- 2) Në Institutin teknik të Korçës, me 3 klasë (kl.I, II e IV të tipit të vjetër, me përkatësisht 27, 35 e 27 nxënës), u mësuan: a) italisht (kl.I e II), b) serbo-kroatisht¹⁰⁶.
- c) Shkolla normale (ose pedagogjike). Pati 4 të tilla në të gjithë vendin, që funksionuan ose si shkolla më vete (shkollat normale në Elbasan e në Berat¹⁰⁷), ose si degë normale pranë liceve (dega normale pranë liceut të Shkodrës [ish-Instituti femëror] dhe dega normale pranë Institutit femëror të Tiranës). Normalistët mësuan 1 gjuhë moderne, me përkatësisht 5, 3, 3, 3 orë në javë në 4 vitet e shkollës¹⁰⁸.
- 1) Në shkollën normale të Elbasanit me 9 klasë (2 kl.I, 2 kl.II, 2 kl.VI, 2 kl.VII e 1 kl.VIII), u mësuan: a) frëngjisht (në kl.VI, VII e VIII të sistemit të vjetër; në kl.VIII të sistemit të ri, vetëm në tremujorin e parë, pasi u zëvendësua me italishten, dhe në kl.IX të sistemit të ri); b) italisht (në kl.VI, VII e VIII, deri në fund të muajit shkurt 1946, kur u zëvendësua me serbo-kroatishten, në kl.IX të sistemit të ri, dhe në kl.VIII

99 Shkresë e Inst.femnor të Tiranës nr.78/9, dt.6.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.128

100 AQSH, F.511, V.1945, D.22

101 Shkresë e inst.femnuer ‘D.Kastrioti’ të Shkodrës, nr.2, dt.27.09.1945. AQSH, F.511, 1945, D.33

102 Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.2, 3

103 Shkresë e inst.teknik të Korçës, n.21, dt.12.06.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, ff.53-57

104 Shkresë e inst.teknik ‘S.Staveleci’ të Tiranës, n.111/3, dt.29.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23

105 AQSH, F.511, V.1945, D.38, fl.28

106 Shkresë e inst.teknik të Korçës, n.21, dt.12.06.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, f.56

107 Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.2

108 Programi i liceut klasik e shkencor dhe i shkollës normale. Ministria e Arësimit, Tiranë, 1945

pas heqjes së frëngjishtes); c) serbo-kroatisht (në kl.VI, VII e VIII të sistemit të vjetër, pas heqjes së italishtes në përfundim të tremujorit të parë)¹⁰⁹.

2) Në shkollën normale të Beratit u mësuan: a) frëngjisht, b) italisht¹¹⁰.

3) Në degën normale të liceut të Shkodrës (ish-Instituti femëror) u mësuan: a) frëngjisht, me mësuesin Kolë Alimhilli, me tekstet France – première année ... dhe France – deuxième année ...¹¹¹; b) serbo-kroatisht, me mësuesin Boris Urbançiç¹¹².

4) Në degën normale të Institutit femëror të Tiranës, me 5 klasë (një për çdo vit, me përkatësisht: kl.IV 49 nxënës, kl.V 52 nx, kl.VI 36 nx, kl.VII 29 nx, kl.VIII 33 nx)¹¹³, u mësuan: a) italisht, b) frëngjisht¹¹⁴.

ç) Shkolla tregtare. Si e tillë funksionoi vetëm një, Shkolla tregtare e Vlorës, me 103 nxënës¹¹⁵. Plani mësimor i saj përmbante 2 gjuhë të huaja, me përkatësisht 3 orë në javë secila përgjatë 4 viteve¹¹⁶. U mësuan: a) frëngjisht, me mësuesit Kel Gashi e Xhelal Shënepremte¹¹⁷, me tekstin France-Première année...¹¹⁸, dhe b) serbo-kroatisht, e cila zëvendësoi italishten¹¹⁹.

Në përgjithësi, gjendja e përgjithshme e shkollave të mesme të larta paraqitej më e mirë se ajo e shkollave fillore dhe unike lidhur me mjediset shkollore, mjetet mësimore dhe nivelin profesional të mësuesve.

Përfundime

Nga gjithë sa u parashtrua më lart, duke analizuar si të dhënat faktike të mësipërme, mund të nxirren këto përfundime lidhur me mësimin e gjuhëve të huaja në vitin shkollor 1945-1946, si viti i parë i plotë shkollor pas Çlirimit të vendit dhe si viti i fundit shkollor para fillimit të reformës arsimore të vitit 1946:

109 Shkresë e shk.normale të Elbasanit n.112/8, dt.30.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.26

110 Shkresë e shk.normale të Beratit, nr.21/7, dt.7.08.1946. AQSH F.511 V.1945, D.22

111 Shkresë e liceut të Shkodrës, nr.274, dt.8.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

112 Po aty

113 Shkresë e inst.femnor të Tiranës nr.78/9, dt.6.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.128

114 Landa e frengjishtes e shtjellueme në kl.VI për vjetin shkolluer 1945-1946. Instituti Femnuer ‘Nana e Skënderbeut’ Tiranë, dega klasike dhe normale. AQSH, F.511, V.1945, D.22

115 Plani i Min.Arsimit për një vit deri në prill të 1947. AQSH, F.511, V.1946, D.1, fl.3

116 Programi i inst.tregtar të Vlorës. Ministrija e Arsimit, 1945

117 Lista e profesorëve t’emnuem ose riemnuem në shkollat e mesme me pëlqimin e Kryeministrit nr.180, dt.14.11.1945. AQSH, F.511, V.1945, D.31, fl.82

118 Shkresë e inst.tregtar të Vlorës, nr.486, dt.24.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

119 Osmani, Sh. *Fjalor i pedagogjisë*. Tiranë, ‘8 Nëntori’, 1983, f.684

- 1) Në shkollën fillore nuk u mësua ndonjë gjuhë të huaj. Krahastuar me vitin shkollor pararendës, gjendja mbeti e pandryshuar. E pandryshuar do të vijojë kjo gjendje edhe në vitin pasardhës, që shënon vitin e parë të reformës arsimore, efektet e të cilës do të shtrihen në disa vite shkollore. Në fakt, gjuha e huaj u përfshi në kurrikulën e shkollës fillore vetëm aty nga fundi i viteve '90 të shek. XX;
- 2) Në shkollën e mesme të ulët (ose unike) mësohej 1 gjuhë e huaj (ndër 12 lëndë që kishte plani mësimor)¹²⁰, me 4 orë në javë, përgjatë të 3 viteve të këtij cikli shkollos. Si gjuhë e huaj në këtë cikël u mësuan frëngjishtja dhe italishtja. Për mungesë të dhënash të plota për të gjitha shkollat, nuk mund të përcaktohet me saktësi vendi ose përqindja e mësimit të këtyre dy gjuhëve nëpër shkolla. Mendojmë se shtrirja e tyre u kushtëzua nga faktorë si: vijimësia e mësimit prej viteve të mëparshme, numri i mësuesve të kualifikuar e, në ndonjë rast, tradita e shkollës dhe e zonës, veçanërisht në rastin e unikeve pranë shkollave të mesme të larta. Me vënien në zbatim të reformës arsimore në vitin shkollor 1946-1947, gjuha e huaj u hoq nga shkolla 7-vjeçare, për t'u rifutur sërish rreth 10 vjet më pas.
- 3) Në shkollën e mesme të lartë, në varësi të llojit (lice, teknike, normale, tregtare) dhe të degës (klasike, shkencore) u mësuan nga 1 deri në 3 gjuhë të huaja.

a) Në lice:

- a.1) nxënësit e degës klasike mësuan 3 gjuhë përgjatë 4 viteve të shkollës: a) 1 gjuhë moderne, në vijimësi nga shkolla e mesme e ulët (ose unike), me përkatësisht 3 orë në javë përgjatë 4 viteve; b) latinisht, me përkatësisht 6, 6, 4, 5 orë në javë; c) greqisht e vjetër, me përkatësisht 4, 5, 4, 5 orë javore¹²¹. Mësimi i gjuhëve klasike kryhej vetëm në këtë degë;
- a.2) Nxënësit e degës shkencore mësuan 2 gjuhë moderne, përgjatë 4 viteve të shkollës¹²²; gjuha e parë, mësimi i së cilës kishte nisur qysh në shkollën e mesme të ulët (ose unike), u mësua me përkatësisht 3 orë javore përgjatë 4 viteve, ndërsa gjuha e dytë,

120 Plani mësimor i shkollës unike: 1) Gjuhë shqipe, 2) Edukatë morale dhe Histori e Lëvizjes Na-Çl, 3) *Gjuhë e huej*, 4) Histori, 5) Gjeografi, 6) Matematikë, 7) Fizikë e Kimi, 8) Shkenca natyre dhe Higjienë, 9) Vizatim, 10) Punë praktike, 11) Muzikë e Kangë, 12) Edukatë fizike. Shih: Program'i shkollës unike. Ministria e Arësimit, Tiranë, 1945

121 Plani mësimor i degës klasike: 1) Gjuhë e letërsi shqipe, 2) *Gjuhë e letërsi latine*, 3) *Gjuhë e letërsi greke*, 4) *Gjuhë e huej I*, 5) Histori, 6) Gjeografi, 7) Matematikë, 8) Fizikë, 9) Kimi, 10) Shkenca natyrore e higjienë, 11) Filozofi, 12) Histori e artit, 13) Muzikë, 14) Drejtësi dhe ekonomi politike, 15) Vizatim, 16) Ekonomi shtëpijake për vajza, 17) Punë dore për vajza, 18) Edukatë fizike. Shih: Programi i liceut klasik e shkencor dhe i shkollës normale. Ministria e Arësimit, Tiranë, 1945

122 Plani mësimor i degës shkencore: 1) Gjuhë e letërsi shqipe, 2) *Gjuhë e huej I*, 3) *Gjuhë e huej II*, 4) Histori, 5) Gjeografi, 6) Matematikë, 7) Fizikë, 8) Kimi, 9) Shkenca natyrore e higjienë, 10) Filozofi, 11) Histori e artit, 12) Muzikë, 13) Drejtësi dhe ekonomi politike, 14) Vizatim, 15) Ekonomi shtëpijake për vajza, 16) Punë dore për vajza, 17) Edukatë fizike. Shih: Programi i liceut klasik e shkencor dhe i shkollës normale. Ministria e Arësimit, Tiranë, 1945

MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA NË SHKOLLAT SHTETËRORE TË SHQIPËRISË

që niste nga fillimi, u mësua me përkatësisht 6, 5, 4, 3 orë;

- b) Në shkollën tregtare u mësuan 2 gjuhë moderne, që të dyja me 3 orë javore përgjatë 4 viteve të shkollës¹²³. Ashtu si edhe në rastin e liceve, edhe në tregtare mësimi i gjuhës së parë ishte vijimësi qysh nga cikli pararendës, ndërsa gjuha e dytë niste për herë të parë në këtë cikël;
- c) Në shkollat normale u mësua 1 gjuhë e huaj moderne, me përkatësisht 5, 3, 3, 3 orë javore në të 4 vitet e shkollës¹²⁴;
- ç) Në shkollat teknike u mësua 1 gjuhë e huaj moderne¹²⁵. Edhe në teknike edhe në tregtare, mësimi i saj ishte vijimësi e mësimin të nisur qysh në shkollën e mesme të ulët;
- d) Në të gjitha shkollat e mesme gjuha e huaj bënte pjesë ndër lëndët që jepeshin provim në maturë;

4) Gjuhët e huaja që u mësuan në shkollën e mesme të lartë qenë:

- a) italisht, në të gjitha llojet e shkollave. Kjo gjuhë vijonte të kishte statusin e gjuhës së huaj të parë në shkollën e mesme të lartë, mbi bazën e legjislacionit të paraluftës, ende në fuqi¹²⁶;
- b) frëngjisht, në të gjitha shkollat, me përjashtim të instituteve teknike. Kjo gjuhë, si rregull, ishte gjuha e dytë në degët shkencore ku mësoheshin 2 gjuhë moderne;

123 Plani mësimor i shkollës tregtare: 1) Gjuhë e letërsi shqipe, 2) *Italisht*, 3) *Frëngjisht*, 4) Matematikë, 5) Lëndë tregtare, 6) Histori, 7) Institucione të së drejtës, 8) Merceologji, 9) Gjeografi, 10) Fizikë, 11) Kimi, 12) Shkencë, 13) Stenografi, 14) Daktilografi, 15) Bukurshkrim, 16) Edukatë fizike. *Shih*: Programi i Institutit tregtar të Vlorës. Ministria e Arsimit, 1945

124 Plani mësimor i shkollës normale: 1) Gjuhë e letërsi shqipe, 2) *Gjuhë e huej*, 3) Histori, 4) Gjeografi, 5) Matematikë, 6) Fizikë, 7) Kimi, 8) Filozofi (psikologji), 9) Sociologji, 10) Didaktikë e Edukatë, 11) Histori e pedagogjisë, 12) Praktikë pedagogjike, 13) Metodikë speciale, 14) Drejtësi dhe ekonomi politike, 15) Shkenca natyrore e higjienë, 16) Bujqësi, 17) Vizatim, 18) Muzikë e kangë, 19) Muzikë instrumentale, 20) Edukatë fizike, 21) Punë dore, 22) Ekonomi shtëpijake për vajza. *Shih*: Programi i liceut klasik e shkencor dhe i shkollës normale. Ministria e Arsimit, Tiranë, 1945

125 Plani mësimor i Institutit teknik të Korçës: Histori, Gjeografi, Shkenca natyrore, *Serbo-kroatisht*, *Italisht*, Matematikë, Gjuhë shqipe, Kimi, Edukatë fizike, Fizikë, Teknologji, Organizim kantieri, Vizatim në perspektivë, Vizatim ndërtimi, Ushtrime praktike në oficinë, Mekanikë, Vizatim mekanik. *Shih*: Shkresë e Inst.teknik të Korçës, n.21, dt.12.06.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, ff.53-57

126 Në 'Rregullore mbi mësimin e gjuhëve të huaja në shkollat e mesme', me 4 nene, thuhet shprehimisht: "Art.1-Në të gjitha shkollat e mesme normale, tregtare dhe teknike të mbretnisë do të mësohen këto gjuhë të huaja: italisht, frëngjisht, gjermanisht dhe anglisht. Art.2-Prej gjuhëve të përmendura në Art.1, mësimi i italishtes asht i detyrueshëm për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme dhe tregtare; tue fillue me klasën e tretë do të mësojnë detyrimisht përveç italishtes edhe një gjuhë tjetër të zgjedhun me ato të përmendura në nenin e sipërm. Art.3- Kjo rregullore hyn në fuqi në vjetin shkollor 1933-1934..."

c) serbo-kroatisht:

c.1) u mësua në lice, në institutin teknik, në normale dhe në tregtare;

c.2) kjo gjuhë paraqitet krejt e re në listën e gjuhëve për t'u mësuar në shkollë të mesme të larta. Futja e saj në planin mësimor të shkollës së mesme të lartë erdhi si pasojë e marrëdhënieve shumë të ngushta shqiptaro-jugosllave në të gjitha planet¹²⁷, si dhe në perspektivën e dërgimit të nxënësve shqiptarë për studime më të larta e kualifikime të mëtejshme në Jugosllavi;

c.3) mësimi i serbo-kroatishtes nuk nisi që në fillim të vitit shkollor e në të gjitha shkollat; ajo u fut me vonësë, në mënyrë graduale, në varësi të sigurimit të mësuesve të nevojshëm¹²⁸;

c.4) për mësimin e saj erdhën mësues nga Jugosllavia; vetëm në raste të veçanta u angazhuan në mësim mësues vendës, që kishin njohuri të kësaj gjuhe;

c.5) kjo gjuhë zuri kryesisht hapësirën që mbulonte deri në atë kohë italishtja, e cila, si gjuhë e 'fashizmit', nis të hiqet nga plani mësimor i shkollës së mesme;

ç) latinisht, u mësua vetëm në degën klasike të liceut e të institutit femëror;

d) greqisht e vjetër, u mësua vetëm në degën klasike të liceut e të institutit femëror; dh)

gjuhë të tjera, si anglisht e gjermanisht, të cilat ishin mësuar në ndonjë shkollë në periudhën para luftës, në vitin shkollor 1945-1946 u hoqën nga të gjitha shkollat;

5) Tekstet që u përdorën për mësimin e gjuhëve të huaja qenë:

a) për frëngjishten:

a.1) në shkollën e mesme të ulët (ose unike) u përdor teksti francez France-1^{ère} année de français [1926];

a.2) në shkollën e mesme të lartë u përdorën tekstet franceze France-1^{ère} année de français dhe France-2^e année de français [1926]. Deri në çlirimin e vendit, këto tekste qenë siguruar nga Franca dhe tregtoheshin nëpër libraritë e vendit. Në vitin 1945, i njëjti tekst u shtyp në Shqipëri nga një botues vendës, me lejen e autoriteteve

127 Thomas, I. John, *Education for communism. School and State in the People's Republic of Albania*. Hoover Institute Press, Stanford University, California, 1969, p.23

128 "...mësimi i serbo-kroatishtes nisi vonë...". *Shih*: Shkresë e inst.teknik 'S.Staveleci' të Tiranës n.111/3, dt.29.07.1946 'Paraqitet raporti final i mbylljes së vjetit shkolluer 1945/46 si dhe pasqyrëza përmbledhëse e përfundimeve vjetore'. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.109

franceze¹²⁹;

a.3) në jo pak shkolla pati mungesë tekstesh¹³⁰, gjë që ndikoi në cilësinë e përvetësimit të mësimit;

b) për italishten:

b.1) në dokumentacionin arkivor nuk ndeshen referime lidhur me tekstet e përdorura në mësim. Duke mbajtur parasysh gjendjen e përgjithshme ekonomike e arsimore të vendit, aftësinë e shtetit të sapodalë nga lufta për të siguruar tekste të reja shkollore brenda një periudhe shumë të shkurtër, si dhe listën e teksteve të botuara në këtë periudhë, mendojmë se vijoi përdorimi i po atyre tekste që kishin qenë në qarkullim para dhe gjatë luftës. Duke mbajtur parasysh dy dokumente zyrtare: programin e shkollave të mesme të vitit 1940 (në të cilin janë përfshirë edhe këshilla lidhur me tekstet për t'u përdorur në shkollë) dhe listën e teksteve zyrtare për t'u përdorur në shkolla (e miratuar nga Ministria në vitin 1939)¹³¹, si edhe listën e librave të botuar në periudhën 1939-1945, mund të hamendësojmë se në ciklin e ulët të shkollës së mesme (degët klasike, shkencore e normale) u përdorën dy tekste: gramatika e E.Baglioni-t [1939] dhe gramatika e Marcella Varazi Dodmasejt [1941]. Në këtë cikël përdorej gjithashtu, sipas programit të vitit 1940, edhe antologjia me pjesë letrare e përgatitur nga autori italian Cesare Paperini [1932], tekst i cili ishte në përdorim edhe në shkollat gjegjëse italiane në të njëjtën periudhë në fjalë; programi këshillonte gjithashtu shoqërimin e teksteve të mësipërme me copa poetike e prozaike të nxjerra nga libra të tjerë¹³²;

b.2) në ciklin e lartë të shkollës së mesme, programi i vitit 1940 këshillonte përdorimin e copave të leximit të nxjerra 4 burime: së pari, nga *La divina commedia* e Dante Alighieri-t; së dyti, nga antologjia e autorëve Avalardi dhe Papandrea [1938]; së treti,

129 Në kushtet kur ishin mbaruar kopjet e ardhura nga Franca, shtëpia botuese shqiptare 'Ismail Mal'osmani' i kërkoi Misionit Ushtarak Francez lejen për ta shtypur në vend tekstin e frëngjishtes, miratim që iu dha gojarisht, në interes të mësimit të frëngjishtes. *Shih*: Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, V.1945, D.1-19, Seria Z, kutia 4. Cituar sipas: Arapi, Arshela, Marrëdhëniet Shqipëri-Francë nga vitet 1945 deri në vitet 1990. Disertacioni doktorate i pabotuar. Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë, 2017, f.126

130 Në mungesë të dërgimit të teksteve, mësimi i frëngjishtes u zhvillua "duke mësuar përmendësh shumë pjesë të tekstit që nxënësit e shkruanin, duke bërë disa orë shtesë mbi planin". *Shih*: Shkresë e shk.unike të Bilishtit n.44/1, dt.1.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.64

131 Në listën e teksteve të miratuara nga Komisioni Teknik i ngritur pranë Min.Arsimit, gramatika e italishtes ka numrin rendor 8. *Shih*: Shkolla shqiptare, Tiranë, tetuer-nanduer-dhetuer, 1939, n.28-30, f.63

132 "Lexime të shumta në klasë nga Antologjia e nga disa faqe të Pinokjos të Collodi-t. [...] Lexime nga Antologjia e nga ndonji libër italisht". *Shih*: Programat dhe orarët e mësimave për shkollat e mesme klasike, shkencore e normale. Botim i Ministrisë së Arsimit, Tiranë, 1940, f.35

nga antologjia e autorëve Bernini dhe Bianchi [1935]¹³³; së katërti, nga antologjia i G.Morrone-s [1940], tekste që përdorshin edhe në klasat gjegjëse të shkollave italiane të së njëjtës periudhë. Përdorimi i këtyre antologjive me copa letrare motivohej me faktin se edhe programi i zbatuar në 1940, edhe ai i zbatuar në 1945 përmbanin edhe njohuri mbi letërsinë¹³⁴;

- b.3) nuk kemi konstatuar, ndër raporte e relacione shkollash, të flitet për mungesë tekstesh të kësaj gjuhe;
- c) për serbo-kroatishten: nuk kemi arritur të gjejmë të dhëna për tekstet e përdorura në mësim. Nga relacionet e shkollave rezulton se nxënësit, masivisht, nuk zotëronin tekste. Në klasa punohej vetëm me tekstin që zotëronte mësuesi, nëpërmjet shkrimit në dërrasë dhe kopjimit në fletore;
- ç) për latinishten: të dhënat arkivore dëshmojnë se u përdorën pjesë të zgjedhura nga autorë të ndryshëm, por nuk specifikohen antologjitë apo tekstet prej nga u nxorën ato. Duke u nisur nga lista e librave të botuara në periudhën para dhe gjatë luftës, gjykojmë se si burime materialesh mësimore u përdorën këto tekste gramatikore: gramatika e Schultz-it, në 3 vëllime: *Morfologjia* [1938], *Sintaksa* [1939] dhe *Ushtrimet* [1938] e, në vijim, edhe gramatika e Lipparini-t [1942].
- d) për *greqishten e vjetër*: u përdor teksti i autorit S.Papahristo [1939], i miratuar dhe botuar nga Ministria e Arsimit; nuk përjashtohet mundësia të jetë përdorur edhe teksti i Pusinich-it [1943], me përkthim dhe përshtatje në shqip;
- e) Nga relacionet e raportet e mësuesve dhe drejtorive të shkollave, rezulton se në shumë shkolla nxënësit nuk patën ndër duar tekste, ose këto qenë në numër të pamjaftueshëm. Mësimi, në këto raste, u zhvillua nëpërmjet shkrimit të tekstit në dërrasë të zezë nga mësuesi dhe kopjimit të tij në fletore nga nxënësit. Të dhënat arkivore dëshmojnë se kjo praktikë u përdor të paktën me frëngjishten dhe me serbo-kroatishten;
- f) Nga raportet e ndryshme shkollore konstatohet se numri vjetor i orëve të gjuhës së huaj u zhvillua gati-gati i plotë. Realizimi i programit, në kushtet e mungesës së teksteve e të mjeteve ndihmëse të përshtatshme, ndryshon në varësi të llojit të shkollës dhe të kushteve konkrete të mëimit;
- f.1) në shkollat e mesme të ulëta (ose unike), ku mungesat në mësues të kualifikuar, në tekste e në mjete mësimore ishin edhe më të mëdha, rezulton se programi nuk u

133 Antologjia e Berninit dhe Bianchit këshillohej të përdorej me nxënësit e kl.VIII. *Shih*: Programat dhe orarët e mësimave për shkollat e mesme klasike, shkencore e normale. Botim i Ministris së Arsimit, Tiranë, 1940, f.37

134 "...u dhanë njohuri të shkurtëra mbi origjinën e gjuhës e të letrësisë italijane, mbi jetën dhe veprën e D.Aligherit...". *Shih*: Shkresë e shk.normale Berat, nr.21/7, dt.7.08.1946. AQSH, F.511 V.1945, D.22

realizua i plotë¹³⁵ dhe, natyrshëm, jo në nivelin e duhur;

f.2) në shkollat e mesme të larta, në përgjithësi, programi mësimor u realizua i plotë. Në ndonjë rast, zëvendësimi i një gjuhe me një tjetër (siç ishte rasti i zëvendësimit të italishtes me serbo-kroatishten në disa shkolla¹³⁶), solli pështjellime tek nxënësit, mungesë motivimi dhe, rrjedhimisht, mosrealizim të programit;

6) Shkollat punuan edhe në vitin shkollor 1945-1946 me të njëjtat programe të gjuhëve të huaja që ishin në përdorim para dhe gjatë luftës. Koha e shkurtër që nga mbarimi i luftës, fokusimi i organeve arsimore para së gjithash në përgatitjen e reformës arsimore, që do të ndërmerrej vetëm një vit më pas (1946-1947) bënë që programet në tërësi të mbeteshin të njëjta. Prej tyre, në përshtatje me ndryshimet politiko-shoqërore, u hoqën vetëm fragmentet që glorifikonin fashizmin dhe ideologjitë ‘e vjetra’¹³⁷;

7) Është e vështirë të nxirren përfundime lidhur me nivelin cilësor të të nxënësve të gjuhës së huaj.

a) Në disa relacione mësuesish sillen të dhëna të përgjithshme e jo të plota lidhur me nivelin e aftësimit të nxënësve. Ato konsistojnë, së pari, në dhënien e numrit të mësimeve të zhvilluara nga teksti mësimor¹³⁸ dhe, së dyti, në vlerësime të përgjithshme të përparimit të nxënësve, në tipit “përftimi qe mjaft i mirë në nxanës”¹³⁹, apo “u ba përparim i mjaftë... hartimet dhe ushtrimet e tjera e vërtetojnë këtë gjë”¹⁴⁰ etj. Duke mbajtur parasysh gjithashtu edhe mungesën e teksteve e të mjeteve mësimore të përshtatshme në mjaft shkolla, si dhe nivelin jo të përshtatshëm të kualifikimit të disa mësuesve, mund të arrihet në përfundimin se niveli i përvetësimit të gjuhës së huaj, në përgjithësi, ishte jo ai i duhuri;

b) Një tipar që karakterizoi mësimin e gjuhës serbo-kroate, por jo të tjerat, me ndikim të drejtpërdrejtë në përparimin e nxënësve, qe mungesa e një gjuhe të përbashkët

135 “u zhvilluan 30 mësime nga teksti *France - première année de Français*” [Shkresë e shk.unike të Pogradecit n.77, dt.12.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.71]; “Gjithsej u zhvilluan 40 mësime e para të tekstit *France - première année de Français*”. [Shkresë e shk.unike të Bilishtit n.44/1, dt.1.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.64]; “janë bërë 47 mësime nga teksti *France - première année....*” [Shkresë e shk.normale të Beratit, nr.21/7, dt.7.08.1946. AQSH F.511 V.1945, D.22]

136 “Në italisht pati një farë përparimi, por jo aq sa duhet. Nxënësit nuk qenë shumë të motivuar ngaqë vitin e ardhshëm shkollor ajo do të hiqet dhe vendin e saj do ta zërë serbo-kroatishtja”. *Shih*: Shkresë e Inst.teknik të Korçës, n.21, dt.12.06.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, f.56

137 “Profesorët të marrin masat e duhura, sepse nëse do të gjendet në duart e ndonjë nxënësi libër i pakorrigjuar, do të mbajnë përgjegjësi”. *Shih*: Shkresë e nëndrejtorit Dh.Samsuri me të cilën përcillet qarkorja e Min.Arsimit për korrigjimin e teksteve. Arkivi i liceut të Korçës, D2C/22/1, dt.3.05.1945

138 *Shih* shënimin nr.94 këtu më lart

139 Shkresë e shkollës unike të Peshkopisë n.48, dt.20.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.83

140 Shkolla pati dy mësues, Ded Shala e Stavri Katundi, njëri nga të cilët qe mësues i italishtes. *Shih*: Shkresë e shkollës unike të Bilishtit, n.38, dt.15.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.65

në komunikim mes mësuesve jugosllavë dhe nxënësve. Mosnjohja e shqipes, ose e një gjuhe tjetër prej mësuesve të huaj, për ta përdorur si mjet komunikimi në klasë, pengoi ecurinë normale të orës së serbo-kroatishtes¹⁴¹. Në ndonjë rast, si gjuhë mësimi u përdor italishtja, por edhe këtu, mosnjohja sa duhet e saj përsëri pengoi sërish komunikimin mësues-nxënës, duke cënuar përvetësimin e gjuhës nga nxënësit¹⁴²;

9) Lidhur me metodologjinë e mësimin të gjuhës së huaj mund të thuhet:

- a) Në dokumentacionin zyrtar nuk ka referime të qarta tek ndonjë metodologji mësimi e caktuar. Tërthorazi, duke gjykuar nga mënyra e konceptimit të relacioneve të mësuesve¹⁴³, ku programi paraqitet në mënyrë sintetike dhe besnikërisht sipas linearitetit të tekstit e të temave mësimore të tij¹⁴⁴, mund të dalim në përfundimin se mësuesit përdornin masivisht një qasje tradicionale në mësimdhënie, pavarësisht se ndonjë tekst mësimor mund t'i përkasë metodologjisë direkte (siç është, p.sh. rasti i tekstit të frëngjishtes);
- b) Veprimtaritë didaktike tipike, që mësuesit përdorin në orën e mësimin, në lidhje të ngushtë me temat e mësimave të tekstit, janë: shqiptim tingujsh e fjalësh¹⁴⁵, ushtrime

141 “Rezultatet në mësim nuk qenë të kënaqshme ngaqë mungoi komunikimi gjuhësor ndërmjet nxënësve e mësuesve që nuk dinin ndonjë gjuhë tjetër që të dinin edhe nxënësit”. *Shih*: Shkresë e Inst.teknik ‘S.Staveleci’ të Tiranës n.111/3, dt.29.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.109

142 Në mësim pati vështirësi komunikimi midis nxënësve dhe mësueses jugosllave ngaqë në mësim u përdor gjuha italiane, “e cila nuk zotërohet si duhet as prej mësueses e as prej nxënësve”. *Shih*: Shkresë e shkollës normale të Elbasanit n.112/8, dt.30.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.26

143 Që të gjitha relacionet e mësuesve që kemi pasur ndër duar janë konceptuar si përmbledhje e materialit gjuhësor të zhvilluar, të identifikuar me terma gramatikorë si ‘emri’, ‘nyja’, ‘mbiemri’, ‘folja’ etj., ‘koha e tashme, e pakryer, e ardhme’ etj., herë në shqipe e herë në gjuhët e huaja përkatëse. Psh: “Gramatikë. Elementat e nevojshëm për të bërë fjali të thjeshta. Nyja. Emri e mbiemri, lakimi i tyre. Disa nga përemrat e foljet. Zgjedhimi i foljeve ndihmëse në gjithë mënyrat e kohët. Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme, të kryeme, të pakryeme dhe kohën e ardhshme”. [Shkresë e shk.unike Pogradec n.77, dt.12.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.71] ose “u punua kryesisht me përvetësimin e foljeve të rregullta në kohën e tashme, të dy foljeve ndihmëse, dhe foljet e rregullta ‘lakuara’ në të gjitha mënyrat dhe kohët” [Landa e frëngjishtes e shtjellueme në kl.VI për vjetin shkolluer 1945-1946. Inst.femnuer ‘Nana e Skënderbeut’ Tiranë. AQSH, F.511, V.1945, D.22]

144 “Frëngjisht. Asht mbarue krejt France (Première Année de Français) Metode direkte tue ba gramatike ne lidhje me landen qe permбан ky liber. Lakimi i foljeve, si te rregullta ashtu edhe te pa rregullta ne kohen e tashme, te pakryeme, te kryeme te plote dhe koh’e ardheshme. Menyrtat perciellore dhe pjesore. Jane shpjegue dhe mesue permenç tri vjersha te La Fontaine: La Cigale et la Formi. Le Coreau et le Renard. La Laitière et le Pot au Lait. Gjate vitit shkolluer jane ba dhe ushtrime bisedimesh ne gjuhen Frëngjishte”. *Shih*: Shkresë e Inst.tregtar të Vlorës n.486, dt.24.08.1946, f.1. AQSH, F.511, V.1945, D.22

145 “Kohë mbas kohe asht ba diktat në klasë...”. *Shih*: Shkresë e Inst.tregtar të Vlorës, nr.486, dt.24.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

dëgjimi¹⁴⁶, shpjegim rregullash gramatikore¹⁴⁷, ushtrime zbatuese në shtëpi, përkthim, diktim¹⁴⁸, bashkëbisedim¹⁴⁹, mësim përmendësh pjesësh të zgjedhura poetike e prozaike¹⁵⁰, përsëritje¹⁵¹;

10) Lidhur me mësuesit e gjuhëve të huaja, dokumentacioni arkivor na mundëson identifikimin e një pjese të madhe të tyre në atë vit shkollor, por jo të gjithë. Ashtu si mësuesit e lëndëve të tjera, edhe ata të gjuhës së huaj pësuan lëvizje të herëpashershme nga një qytet a shkollë në tjetrin, transferime e pushime nga puna, deri edhe në mes të vitit shkollor. Lëvizjet e shpeshta të kuadrit, natyrshëm, ndikuan negativisht mbi procesin mësimor dhe në nivelin e përvetësimit të gjuhës. Pa mëtuar të jemi shterues, këtu më poshtë po paraqesim vetëm ata mësues që, mbi bazën e dokumentacionit arkivor, rezultojnë se dhanë mësim në atë vit në shkollat unike e të mesme, sipas gjuhëve:

a) frëngjisht: Abdyl Kajanaku, Dhimitër Turtulli, Dhimitër Pilika, Edip Tërshana, Elmas Çani, Hilmi Aliu, Kel Gashi, Kolë Alimhilli, Llazar Eftimiadhi, Ndoc Kamsi, Nonda Bulka, Pandi Geço, Prenk Kaçinari, Qemal Draçini, Rexhep Neziri, Sotir Koci, Vedat Kokona, Vexhi Demiraj, Virgjil Ballamaçi, Xhelal Shënpremte¹⁵².

b) italisht: Agetina Ashiku, Alfredo Ingletti, Anesti Havjari, Ballkize Tela, Dhimitër Pilika, Drita Gani, Fadil Podgorica, Filip Ndocaj, Franca Mandalà, Gleqeri Koça, Kolë Kamsi, Kolë Prela, Luigj Franja, Qemal Draçini.

c) serbo-kroatisht: Boris Urbançiç, Josif Cagleviç, Ruzica Simiç, Josif Depolo.

ç) latinisht: Pashko Geci, Pashko Gjeçi, Luigj Franja, Henrik Lacaj, Anesti Hajvjari, Nikollë Dakaj¹⁵³.

d) *greqisht e vjetër*: Pashko Geci, Pashko Gjeçi, Henrik Lacaj, Sotir Papahristo,

146 "...ushtrime praktike dhe rregulla përkatëse me qëllim që të mësohet nxënësi të dëgjojë dhe të shqiptojë pa gabime tingujt e gjuhës frëngjisht". *Shih*: Shkresë e shk.unike të Pogradecit n.77, dt.12.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.71

147 "Në lidhje me mësimet asht shpjegue dhe gramatika. [...] Foljet e rregullta janë shpjegue dhe lakue në...". *Shih*: Shkresë e Inst.tregtar të Vlorës, nr.486, dt.24.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

148 Shkresë e Inst.tregtar të Vlorës, nr.486, dt.24.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

149 "konversacione me ndihmën e fjalëve të studiuara". *Shih*: Shkresë e shkollës unike të Pogradecit n.77, dt.12.07.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.23, fl.71

150 "...u mësua "për mençë" vjerrsha ...". *Shih*: Landa e frëngjishtes e shtjellueme në kl.VI për vjetin shkolluer 1945-1946. Inst.femnuer 'Nana e Skënderbeut' Tiranë... AQSH, F.511, V.1945, D.22

151 "Revision". *Shih*: Shkresë e liceut të Shkodrës, nr.274, dt.8.08.1946. AQSH, F.511, V.1945, D.22

152 Lista e Min.Arsimit përmban si mësues të gjuhës frënge për v.1946: Luigj Ljarja, Marije Cukali, Vexhi Demiraj, Vedat Kokona, Foto Bala, Elmas Çani, Lazar Eftimiadhi, Nonda Bulka, Dhimitër Turtulli, Arsioni Poro, Koci Treska, Hidajet Ceka, Florinda Kiri. *Shih*: Listë e profesorëve simbas lëndës që zhvillojnë. AQSH, F.511, V.1946, D.62

153 Në listën e Min.Arsimit, si mësues të gjuhës latine për v.1946 figurojnë: Kol Shiroka, Pashko Gjeçi, Pashko Geci, Gaspër Shoshi, Mirash Ivanaj, Stefan Prifti, Nikollë Dakaj, Kol Prela, Luigj Franja, Gemma Tirana. Listë e profesorëve simbas lëndës që zhvillojnë. AQSH, F.511, V.1946, D.62

Zijahudin Kodra¹⁵⁴.

dh) Nga të dhënat e nxjerra prej raporteve të shkollave rezultojnë se shumica dërrmuese e këtyre mësuesve, përveç gjuhës së huaj, jepnin mësim edhe lëndë të tjera. Në fakt, një pjesë e tyre qenë të diplomuar në universitete dhe shkolla të larta të ndryshme jashtë vendit dhe, për nevojat e shkollës dhe për plotësim të ngarkesës mësimore, përveç lëndës kryesore, u ngarkuan edhe me mësimin e gjuhëve të huaja¹⁵⁵. Nga ky konstatim mund të nxirren edhe disa përfundime shumë të rëndësishme: i) mësimi i gjuhëve të huaja në shkollën unike e të mesme u krye nga mësues, që ishin të diplomuar në degë të ndryshme të shkencave shoqërore e natyrore, por jo posaçërisht të diplomuar për mësimin e gjuhës së huaj përkatëse; ii) mësuesit e diplomuar në shkenca natyrore, si dhe pjesa më e madhe e atyre të diplomuar në shkenca shoqërore, nuk kishin kualifikimin profesional të nevojshëm (d.m.th. as atë psiko-pedagogjik, as atë gjuhësor) për të qenë mësues të gjuhës së huaj; iii) vetëm pak mësues qenë të diplomuar në gjuhësi (e letërsi) të huaj përkatëse (frënge, italiane, serbo-kroate, latine, greke të vjetër); iv) duke pasur formim universitar të ndryshëm, metodat mësimore të përdorura në klasë prej këtyre mësuesve qenë të ndryshme, jo të njësuara nga këndvështrimi i organizimit të orës mësimore, i konceptimit psiko-pedagogjik të proceseve të mësimdhënies dhe të të nxënës, i metodave dhe teknikave didaktike për t'u përdorur me nxënësit. Të gjitha këto mbeteshin në dorë të aftësive individuale psikologjike, pedagogjike dhe gjuhësore të mësuesit, larg së qeni një veprimtari e programuar, e drejtuar dhe e njësuar në rrafsh vendi, shkolle, cikli shkollor e klasash paralele; v) në mjaft raste, i njëjti mësues jepte mësim dy gjuhë, frëngjisht e italisht, italisht e latinisht, latinisht e greqisht etj.

Së fundi, mund të thuhet se, pavarësisht nga ndryshimi rrënjësor i sistemit politiko-shoqëror, në fushën e arsimit dhe veçanërisht në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, u vijuan të përdorshin edhe në vitin shkollor 1945-1946 të njëjtat forma organizimi e konceptimi të mësimin, të njëjtat metodologji, programe e tekste si edhe para e gjatë luftës. Vetëm në vitin shkollor pasardhës 1946-1947, me nisjen e reformës arsimore, lënda e gjuhës së huaj do të pësojë ndryshime, qoftë si ofertë gjuhësore, qoftë si shtrirje.

BIBLIOGRAFIA:

Aqsh

= Arkivi Qendror Shtetëror Tiranë, Fondi i Ministrisë së Arsimit, vitet 1944-1946

154 Në listën e Min.Arsimit, si mësues të gjuhës greqishtes së vjetër në vitin 1946 figurojnë: Gabriel Meksi, Sotir Parahristo, Stefan Prifti, Nikollë Dakaj, Pashko Geci, Niko Çane. *Shih*: Listë e profesorëve simbas lëndës që zhvillojnë. AQSH, F.511, V.1946, D.62

155 Psh Ndoc Kamsi diplomuar për histori-gjeografi, Prenk Kaçinari për filozofi, Abdyl Kajanaku për pedagogji, Rexhep Neziri për shkenca të natyrës, Luigj Franja për histori e arti, etj.

- AVALARDI, A. & PAPANDREA, L. (1938), *Romània Antologia*. Per il ginnasio superiore e per il primo anno del liceo scientifico. Edizioni Remo Sondron, Palermo, 4^o ediz.
- BAGLIONI, e. (1939), *Gramatika për mësimin e gjuhës italishte në shkollat e mesme të Shqipërisë*. Pjesa I. Ministria e Arsimit, Tiranë, 'K. Luarasi', 127 f.
- BERNINI, f. & BIANCHI, L. (1935), Carducci, Pascoli, D'Annunzio, *Antologia poetica ad uso delle scuole medie a cura e con note di F.Bernini e L.Bianchi*, N.Zanichelli Edit., Bologna
- CAMERLYNCK & CAMERLYNCK (1926), *Première année de français*. France. *Methode directe de français avec notation phonétique* par M.me Camerlynck et G.H.Camerlynck, Paris, H.Didier
- CAMERLYNCK & CAMERLYNCK (1926), *Deuxième année de français*. France. *Methode directe de français avec notation phonétique* par M.me Camerlynck et G.H.Camerlynck, Paris, H.Didier
- ISTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE (1990), *Historia e arsimit shqiptar*, Vëll.I, Tiranë
- HOXHA, A. (2001), *Biografi e shkollave të Rrethit të Durrësit*. Tiranë, Globus R
- KAMBO, e. (2005), *Arsimi në Shqipëri (1945-1960)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Historisë. Tiranë, Shtyp. 'Mësonjëtorja'
- LIPPARINI, g. (1942), *Gramatika latine*. Libër rregullash dhe ushtrimesh. Përkthym nga Pashko Geci & Henrik Lacaj. Ministria e Arsimit, Tiranë, Pj.1 (296 f.), Pj.2 (440 f.)
- MORRONE, g. (1940), *Lineamenti di storia della letteratura italiana*. Vol.I. Dalle origini fino al 400; vol.II. Dal 500 al 700; vol.III. Dal'800 ai giorni nostri, Casa ed. Macrí, Bari
- PAPAHRISTO, s. (1939), *Gramatika e greqishtes së vjetër*. Morfologjia. Tiranë, Shtëpia Botonjëse 'K.Luarasi', Pj.I, 1939 (184 f.); Pj.II, 1940 (224 f.)
- PAPERINI, c. (1932), *Nella nuova aurora. Antologia italiana per le scuole medie inferiori*. Angelo Signorelli Editore, Roma
- PUSINICH, g. L. (1943), *Gramatika e gjuhës greke*. Pjesa I: Theorija. Përkth. Pashko Geci & Henrik Lacaj & Frano Alkaj. Tiranë, Shtëpia Botuese «Luarasi», 164 f.
- RAMA, f. (2005), *Dukuri arsimore gjatë Luftës II Botërore në Shqipëri*, Tiranë, Argeta-LMG,
- REPISHTI, xh. & LULI, f. (1972), *Gjimnazi i Shtetit, Shkodër 1922-1972*. Shkodër
- SCHULTZ, f. (1938), *Gramatika latine*. Pjesa I. Fonologji e morfologji. Përkth. Karl Gurakuqi. Ministria e Arsimit, Tiranë, Shtëpia Botonjëse «K.Luarasi», VIII + 176 f.
- SCHULTZ, f. (1938), *Ushtrimet e gramatikës latine*. Pjesa I. Fonologji e morfologji. Përkth. Karl Gurakuqi. Ministria e Arsimit, Tiranë, Shtëpia Botonjëse «K.Luarasi», VIII + 132 f.
- SCHULTZ, f. (1939), *Gramatika latine*. Pjesa II. Syntaksa. Përkth. e përpunoi Karl Gurakuqi. Tiranë, Shtëpia Botonjëse «K.Luarasi», 139 f.
- VARAZI DODMASEJ, m. (1941), *La lingua italiana nelle scuole albanesi del corso medio inferiore / Grammatica / Testo per le scuole medie / Firenze, Marzocco*, 130 f.

PRIRJE HERMETIKE DHE PËRKIME LETRARE MES ZORBËS DHE UNGARETTI-T

Dr. Alva Dani

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti “Luigj Gurakuqi”
alva.dani@unishk.edu.al

PËRMBLEDHJE

Poezia e Zef Zorbës është pjesë e asaj që quhet në letërsinë shqipe, “Letërsia e sirtareve”, një emër i fuqishëm i së cilës është edhe Zorba. Studion në Itali, ku admiroi dhe përktheu hermetikët italianë, mes tyre Ungaretti-n. Poezia e Zorbës është e mbyllur, e ngjeshur deri në abstragim, tepër intensive, e si pasojë e errët dhe hermetike. Nga këtu priremi të mendojme se ajo që e përbashkon me poezinë e Ungaretti-t është poezia e pastër, poezia e zhveshur deri në palcë, me nëntekst tejskajshmërisht të pasura, një poezi që ndriçon elementet ndjenjësore duke zbehur ato racionale. Mënyra se si Zorba i qaset objektit poetik, mënyra e shtjellimit të motiveve dhe mënyra e të kuptuarit poezinë bën që të përkojë mjaftueshëm me hermetikët italianë e në mënyrë të veçantë me Ungaretti-n. Kemi një dendësi vëzhgimesh meditative që lidhen me jetën, me vdekjen, me tmerret e kaluara në kurriz nga diktatura, me vuajtjen, me ekzistencën, përjetime të cilat i provoi vetë Ungaretti në të njëjtën mënyrë në frontin e luftës, ku ishte ushtar, ku i mbijetoi vdekjes dhe tmerrit, ku gjithçka ishte esencë, thelbësore dhe ekzistenciale. Përtej një qasjeje të mundshme, mes Zorbës dhe hermetikut italian, duhet të theksojmë se Zorba shquhet për origjinalitetin e poezisë së tij. Ruan elemente të vryera të gegërishtes, duke i veshur me petkun e shqipes letrare zyrtare. Ruan një botëkuptim të tijin personal dhe beson deri në amëshim tek arti i pashkatërrueshëm i fjalës.

Fjalët çelës: fjala, ekzistencë, hermetike, letërsi, poezi

ABSTRACT

Zef Zorba's poetry is part of what is called in Albanian literature, “Literature of drawers”, in which Zorba is a powerful name. He studies in Italy, where he admired and translated the Italian Hermetics, among whom was Ungaretti. Zorba's poetry is closed, compressed to abstraction, an extremely intense one, and as a consequence, a dark and hermetic poetry. This leads us to think that what unites it with Ungaretti's poetry is a pure poetry, a bare-to-pop poetry, full of extremely rich subtexts, a poem that illuminates sensible elements by fading the rational ones. The way Zorba approaches the poetic object, the way he explains the motives and the way he understands poetry makes his poetry considerably join the Italian hermetics and especially Ungaretti. There is a range of meditative observations relating to life, death, the horrors experienced by the dictatorship, suffering, existence, the same experiences that Ungaretti had during the war, where he was a soldier, where he survived death and horror, where everything was essence, was essential and existential. Beyond a possible approach between Zorba and the Italian hermetic, it must be highlighted that Zorba is famous for his poetry originality. He preserves priceless elements of the Gheg, by coating them with the official literary Albanian. He preserves his own point of view and he believes until eternity in the inextricable art of speech.

Keywords: existence, hermetic, Literature, poetry, word

“Letërsia e sirtarëve” apo “Letërsia e penguar”, konsiderohet si pjesë e rëndësishme e letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit XX. Ajo vjen dhe zë vendin e saj të mohuar për arsye jashtë letrare për dekada të tëra, zë vendin e saj të mbetur bosh në mozaikun e letërsisë moderne shqipe. “Letërsia e sirtarëve” është ende e panjohur për lexuesin e gjerë, ndonëse mbart vlera të spikatura artistike dhe njerëzore. U botua dhe u ndalua, por edhe u fsheh për t’i shpëtuar asgjësimit. Qëndroi e strukur në errësirën e sirtarëve, larg syve dhe veshëve, që të mos dëgjohej klithma, që lëshonte së brendshmi shpirti, që vuante lirinë e munguar për gjysmë shekulli.

Ndër të gjithë autorët e “letërsisë së sirtarëve” spikat në mënyrë të veçantë Zef Zorba, poeti, regjisor dhe intelektual, frymëmarrja poetike e të cilit ka gjallëruar fjalë e thërmija fjalësh, duke sjellë një shprehje të re, shprehjen e pastër të modernitetit në letërsinë shqipe. “Zef Zorba është një ndër poetët më të shquar të letrave shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të njëzet, pra të asaj periudhe, që, në mënyra të ndryshme, është quajtur si kohë e komunizmit”, do të shkruante Ismail Kadare në parathënien e librit të tij të vetëm “Buzë të ngrira në gaz”, i ribotuar në vitin 2010. Po ashtu, Stefan Çapaliku në pasthënien e botimit të parë të kësaj përmbledhjeje poetike, më 1994, shkruan: “Në heshitjen e thellë të këtij gjysmëshekulli, Zorba, i pajisur me një kulturë të mrekullueshme, vizatoi figurën e intelektualit të vërtetë, larg kompromiseve... në kushtet e një izolimi total ndaj botës... arrin ta ndjekë hap pas hapi kohën e vet, atë kohë që lëvizte e lëviz aq vrullshëm përtej kufijve e që në Shqipëri ishte stopuar”.

Kritika letrare e cilësoi si hermetikun e parë shqiptar së bashku me Martin Camajn: “Krahas me shkrimtarët në diasporë si Martin Camaj dhe me autorë të tjerë klandestinë si Kasëm Trebeshina, Daut Gumeni, Primo Shllaku, Zorba i takon qarkut të vogël shkrimtarësh në Shqipëri që, artistikisht dhe moralisht, e rimerrshin fillin e këputun të vazhdimësisë së letërsisë shqiptare dhe e rimëkambshin lidhjen me rangun e saj të naltë që e kishte fitue me autorë si Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi”. Arti i Zorbës ishte padyshim krejtësisht i ndryshëm dhe shumë larg atij produkti letrar, që prodhoi letërsia e realizmit socialist. Hans-Joachim Lanksch do t’i jepte një vend të veçantë, mes shkrimtarëve më të mirë modernë shqiptarë, duke e cilësuar për më tepër si “modernistin e parë genuin dhe njëherit hermetikun e parë të poezisë së re shqiptare, me sa asht fjalë për atë të shkrueme në Shqipëri”. Studiuesi tjetër Ardian Ndreca shprehet po ashtu me bindje të plotë se poezia shqiptare njeh në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar vetëm dy poetë hermetikë: Martin Camajn dhe Zef Zorbën, ku i pari ishte i larguar dhe i dyti ishte i padukshëm.

Prirjen e tij hermetike e pohon edhe vetë Zorba në pasthënien e librit, duke e shpjeguar si një mënyrë, ndoshta edhe të vetmen, për të pasqyruar gjithçka mbante përbrenda, gjithë ndjenjat e ndrydhura viteve të gjata sfilite, kur i lejohej vetëm të ëndërronte për agimet e ditëve të bardha. “Rrugën e “esencialitetit” ose të “hermetizmit” e kam përqaftuar kryesisht, sepse ashtu e kam ndjerë mundësinë e dhënies emocionale dhe të krijimit, njëherit kam këqyrë të mos bie, qoftë edhe pa vetëdije në binarët e

“hermetikëve” sado të adhureshëm që ato binarë janë”.

Zorba e pranon të ketë ndjekur tendencën e hermetizmit evropian si teori, si mënyrë të shkruari, duke u shfaqur “si qenie në sintoni me hermetizmin si drejtim letrar kontinental” për ta thënë si Primo Shllaku, por Zorba nuk e pranon të jetë ndikuar emocionalisht, qoftë edhe pa vetëdije nga hermetikët italianë me të cilët njihet gjatë studimeve në Itali dhe të cilët i studion dhe i përkthen në gjuhën shqipe.

Fakti që poezia e Zorbës është poezi e kalibrit evropian, që vetë formimi i tij letrar e artistik ishte pothuajse i huaj për letërsinë shqipe të kohës, fakti që gjithë poezia e jetës së tij mbeti pa lexues, e pazë, e kyçur sirtarëve përbëjnë disa argumente, që të ftojnë drejt një studimi më specifik, që tenton të zbresë në detaje të caktuara, të cilat na ndihmojnë që ta shohim këtë mjeshtër të poezisë jo vetëm në një kontekst letrar hermetik, por, pse jo, edhe në një qasje të mundshme me poezinë hermetike të poetit italian Giuseppe Ungaretti.

Duke u nisur nga disa elemente biografike, të cilat natyrisht nuk përbëjnë thelbin e argumentit, i afrohem dy poetëve për të kuptuar më mirë atë çka, përveç talentit, vë në lëvizje mekanizmin e tyre shpirtëror dhe mendor. Duket që fati e solli që të dy poetët të ndiqnin të njëjtin rrugëtim, të përjetonin të njëjtin kalvar vuajtjesh e trishtimi, duke e ndjerë thellë deri në palcën e shpirtit, aty ku ulërима kërkon të shpërthejë e aty ku drita e shpresës duket e ngulur shtatë pash nën dhë. Titulli i fundit i përmbledhjes poetike të Ungaretti-t është “Vita d’un uomo” (Jeta e një njeriu). Poezia dhe biografia për Ungaretti-n janë aq shumë të lidhura ngushtë, sa që ishin vetë eksperiencat e jetës ato, që përcaktuan edhe disa nga zgjedhjet e stilit dhe të përmbajtjes, risi për letërsinë italiane. Eksperienca e parë dhe më thelbësore ishin tmerret, që përjetoi gjatë Luftës së Parë Botërore, momentet çnjerëzore pranë shokëve të masakruar, të copëtuar këmbë e duar, pranë atyre, që jepnin shpirt njeri pas tjetrit, aty ku vdekja ishte bashkudhëtarja më e ngushtë.

Veglia

Un’intera nottata
buttato vicino
a un compagno
massacrato
con la sua bocca
digrignata
volta al plenilunio

Pellegrinaggio

In agguato
in queste budella
di macerie
ore e ore
ho strascicato

Roje natën

Tërë natën e gjatë
i kredhur pranë
një shoku
të masakruar
me gojën
e çapëluar
të sjellë nga hëna e plotë

Shtegtim

Në pritë
nëpër këto zorrë
gërmadhash
për orë të tëra
kam hequr zvarrë

la mia carcassa
usata dal fango

kërmën time
të ngrënë nga lluca

Poezitë e tij të luftës shpalosën me gjuhën e shpirtit, emocionet e forta, që shenjuan gjatë gjithë jetës njeriun dhe poetin. Marrëdhënia e tij me vdekjen është aq familjare, sa poeti e quan motër (immemore sorella, morte). Në këtë atmosferë të pangushëllueshme, njeriu ungarecian zhvishet nga dimensionin e kohës dhe i kujtesës për t'u shndërruar në "ëndërr", në iluzion.

Poeti shkodran Zef Zorba, gjithashtu do të përshkonte pashmangshmërisht pothuajse të njëjtin itinerar, duke përjetësuar të njëjtën dramë ekzistenciale të mbijetesës, duke ndjerë deri në palcë shpërfytyrimin e qenies njerëzore, traumën e dhimbjes dhe të vuajtjes në kampet dhe burgjet e diktaturës, aty "ku jeta-dhuratë përbuzet/ ku hiqet dreqi me vdekë".

Si zogj dallëndysheje

Prej trurit trishtimi
shkumëzon e shprazet
në gjymtyrët e këputura.
heq këmba këmbën zvarrë.

Rrokallja në flakë

E gjithashtu më kujtohet ashtu i brejtur
për së gjalli prej insektesh të neveritshëm e
prej atij soj realiteti çnjerëzor, kur mbet i
paralizuar dhe i vetmuar në kapanonin e çflegëruar,
me një të dridhur zëri në gojë...

Por Zorba, megjithëse "në cepin e greminës" ia doli të ruante fuqinë e shpirtit dhe kthjelltësinë e mendjes, falë poetit që qëndroi struktur, i pazë, në heshtje të thellë, duke kërkuar e përpunuar fjalën, në gjithë lakuriqësinë e saj. Poezia do të ishte drita, në shtegun e tij të errët, do të ishte ulërima e një shpirti që nuk muji me bza, do të ishte pranvera mes llumit e baltës, ku jetonte ditëve e netëve të gjata.

Në vend të hyrjes

I errët ky shteg. Nuk mundem
Rrugën me gjetë pa dritën
tande. (Ç'ka më sëmbon?).

Në të vërtetë, poezia do të ishte jo vetëm frymëmarrja e tij e lirë, por edhe dhimbja e tij më e madhe. Për një shpirt të pasur poetik si të Zorbës, përjetimi i vuajtjes do të ishte shumë më i thellë. Giuseppe Ungaretti në një letër të gushtit 1916 do t'i shkruante mikut të tij Marone: "I dashur Marone, më është neveritur vetja; do të doja të mos isha poet; të mos e kisha këtë ndjeshmëri torturuese; do të doja të isha një hamall i përlurur; do të doja të isha i pagdhendur dhe i thjeshtë... që të mos di shumë e të vdes i qetë;

por unë jam poet, miku im Marone, vëlla Marone; jam një poet, që ndien dhimbje...”
Dhe në letrat, që shkruhen nga fronti i luftës, do të gjejmë edhe poezitë e shkruara në të njëjtën kohë.

La pietà

Sono un uomo ferito

...

E mi sento esiliato in mezzo agli uomini

Dhimbshuria

Jam njeri i plagosur

...

E ndihem si mërgues mes njerëzish.

Sono una creatura

Come questa pietra

è il mio pianto

che non si vede

Jam një qenie

Sikur ky shkëmb

është vaji im

që nuk shikohet

Zorba, gjithashtu nuk i shmangej dot ndjeshmërisë sfilitëse, ai duhej të shkruante, të nxirrte gjithë mjerimin që mbante përbrenda. Poeti shkodran po jetonte një mallkim të dyfishtë, regjimin dhe fshehjen e poezive, ato duhej të mbeteshin në errësirë, nuk mund të botoheshin, e aq më pak të lexoheshin. Po si mund të shkruash një vepër, që nuk ka lexues?

“Zgjedhja e Zorbës, e këtij lloj arti, – do të shkruante Ismail Kadare në parathënien e veprës së tij poetike – ishte e pashmangshme. Arsyeja kryesore përse ai e sprapsi tundimin e natyrshëm të botimit ishte, sepse ndihej krejtësisht i huaj ndaj regjimit që u vendos në Shqipëri”. E në këtë aspekt për të dy poetët, të shkruaje poezi ishte mjaft e vështirë, duhej një sintezë, një formë e shkurtër, me një intensitet të pazakontë; duhej fjala dhe fuqia e saj. Ata zgjodhën hermetizmin, për t’u ndjerë dhe për t’u shprehur më mirë, si të vetmen rrugë të shpëtimit të shpirtit.

Fjala

Vetëtimë.

E zbret

fulikare

fjala

që vret

mu

në shpirt.

Më e bukur se jeta vetë

oh...

Për Zorbën, fjala është vetëtimë, është thirrje, e me gjithë dhembjen, që e vret mu në shpirt, mbetet më e bukura ekzistencë e më e madhja shpresë. I njëjti perceptim vjen edhe nga vargjet e Ungaretti-t, e njëjta ndjeshmëri ndaj fjalës dhe shprehjes, që burojnë nga vuajtja dhe trishtimi. Është vetë jeta, që ushqen fjalën, që i jep konotacionin dhe

fuqinë, që e bën atë të jetojë edhe përtej luftës, edhe përtej dhimbjes.

Commiato

Poesia
è il mondo l'umanità
la propria vita
fioriti dalla parola

Po të lë shëndenë

Poezi
është bota njerëzimi
jeta e vetvetes
të lulëzuara prej fjalës

Zorba tërheq vëmendjen në pasthënien e librit, me shpjegimet e dhëna rreth errësirës së poezisë dhe vështirësisë së kapjes së kuptimit të shtresëzuar, mes analogjive, antitezave të fuqishme, formave të shkurtra poetike e një minimumi fjalësh të përzgjedhura me shumë kujdes. Kështu, mes të tjerash na bën të kuptojmë se është Ungaretti ai tek i cili besoi në veçanti. Kam bërë të miat – na rrëfen Zorba – fjalët e Ungaretti-t. “... ai (Ungaretti) dëshëron të kuptohet... se forma e mundon vetëm, sepse kërkon me këmbëngulje që ajo të përkojë me ndryshimet që pëson shpirti i tij, ai dëshiron që ajo (forma) të paraqiste ndonjë prej krijimeve të arritura prej tij si njeri...”.

Komunikimi poetik i Zorbës nuk është aspak i lehtë, nuk përthypet pa mundim. Dhe poeti kërkon nga lexuesi i tij një përgatitje shpirtërore, kulturore dhe artistike, në mënyrë që të ndjejë e të vuajë së bashku me poetin, ashtu si edhe lexuesi i Ungaretti-t “që heq e vuan të zitë e ullirit bashkë me poetin në llogoret e luftës”. Përfytyrimet e situatave, përjetimet emocionale dhe botëkuptimi personal përcaktojnë individualitetin e secilit poet e, në të njëjtën kohë, krijojnë afërsi dhe ngjallin të njëjtin emocion. E tillë është poezia “Soldati” e Ungaretti-t dhe poezia “Robër” e Zorbës.

Soldati

Si sta come
d'autunno
sugli alberi
le foglie

Ushtarët

Jemi si
në vjeshtë
gjethet
ndër pemë

Robër

E pezull varen
në tehun e një rrezeje
qeniet e këputura

Kjo gjendje ekzistenciale, perceptohet në të njëjtën mënyrë nga të dy poetët, pak rëndësi përbën fakti nëse njëri është ushtar dhe tjetri i burgosur ose “rob” siç përshkruan Zorba. Tek e fundit, të dy ndjehen robër e ushtarë të një realiteti të pamëshirshëm e kërcënues, ku “qeniet e këputura të varura në tehun e hollë” u ngjajnë “gjetheve të zverdhura e gati të thara të vjeshtës”, që mezi mbahen në degë. Lufta dhe regjimet diktatoriale kanë një të vërtetë të madhe të përbashkët; jeta varet në fijen e perit dhe

njeriut nuk i mbetet shumëçka. Megjithatë, kjo gjendje e rënduar fizike dhe emocionale nuk do t'i pengojë aspak poetët të shohin dritën dhe shpresën për një të ardhme, që duhet patjetër të vazhdojë, sepse jeta duhet të rilindë, edhe pse nga një shpirt i lodhur e i bërë gërmadhë. Tek të dy poezitë e ndjejmë praninë e dritës përmes fjalëve të pakta e tejet të ngarkuara, nga ana semantike. Veçojmë fjalën “rreze” te Zorba dhe fjalën “pemë” të Ungaretti (pema mbyll një cikël, për të rilindur përsëri në pranverë e për t'u mbushur me gjethe e lule). Kjo rreze shprese e kjo dritë jete përcillet nga të dy poetët edhe në poezi të tjera, megjithëse te Zorba është më e fuqishme dhe drita e tij e shpëtimit përshkon gjithë veprën poetike.

Rrokollja na flakë

O, jetë!
edhe në zgrip...
shtegtarët e tu
gjithnjë dashurojnë!

Eja me ne

Gjëmon hare prej gjoksesh tona
Mbuluar me plagë.

Shpejtò, pranverë...

Shpejtò, pranverë!
Kjo shpresa qenkish tharm që shpirtin bren
Më keq se urithi dhenë,

Ungaretti, duke qenë i kërcënuar nga plumbat, që i fërshëllejnë në çdo moment nga të gjitha anët dhe nga ndjesia e një vdekjeje të pashmangshme, e kërkon jetën në mënyrë të ethshme, e dëshiron në çdo sekondë e në çdo frymëmarrje, edhe pse i bindur shpeshherë se mund të ishte vetëm një iluzion i fundit.

Veglia

Non sono mai stato
tanto
attaccato alla vita

Pellegrinaggio

Ungaretti
uomo di pena
ti basta un'illusione
per farti coraggio

Roje natën

Kurrë nuk kam qenë
kaq
ngushtë i lidhur me jetën

Shtegtim

Ungaretti
njeri i halleve
të mjafton një iluzion
me të dhanë zemër

Pietà

La luce che ci punge
È un filo sempre più sottile
Forse l'uomo è anche indegno di sperare

Dhimbshuria

E drita që na ther
është një fill gjithnjë e më i hollë.
Mbase njeriu s'është i denjë as të
shpresojë.

Pranëvënia e Ungaretti-t me Zorbën, si dhe vështrimi i disa përkimeve letrare, duke u nisur nga mënyra e të shkruarit e të perceptuarit e të përjetuarit të situatave të ngjashme, synon të evidentojë dimensionin evropian të Zorbës, individualitetin e tij si poet, frymëmarrjen moderne të poezisë së tij dhe pse jo edhe magjinë e pashtershme, që përçon ende sot, rreth 50 vite pas vdekjes, poezia hermetike e poetit italian Giuseppe Ungaretti, poezia e të cilit ishte frymëzimi dhe ambicia e shumë shkrimtarëve evropianë.

BIBLIOGRAFIA:

- CORTELLESA, A. (2000), Ungaretti, Einaudi Editore, Torino.
CAPALIKU, S. (1994), Pashënie, Buzë të ngrira në gaz, Sh.B. Dituria, Tiranë.
KADARE, I. (2010), Parathënie, Buzë të ngrira në gaz, Botimet Princi, Tiranë.
MONTALE, QUASIMODO, UNGARETTI, (2019), Perfectum trinum, (poezi të zgjedhura e të shqipëruara nga Zef Zorba), Çabej, Tiranë.
UNGARETTI, G. (2005), Vita d'un uomo. Tutte le poesie, Mondadori, Milano.
ZORBA, Z. (2010), Buzë të ngrira në gaz, Botimet Princi, Tiranë.

A JANË PËRKTHYESIT PROFESIONISTË SPECIE NË ZHDUKJE PËR SHKAK TË TEKNOLOGJISË?

Anna Maria Vasili

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: amvasili@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Në kohët moderne që po jetojmë, krahas përkthimit njerëzor të bërë nga njeriu, herë-herë përdoret dhe përkthimi automatik, të cilin teknologjia e mundëson me krijimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të ndryshme të përkthimit. Në shoqëritë post-moderne, globaliste, konsumiste, ritmi i shpejtë i jetës dhe i biznesit gjithashtu, ka nevojë për përkthimin e materialeve voluminoze në njësi shumë të shkurtra kohore e kjo është ndoshta edhe arsyeja se përse po kërkohet të përdoret përkthimi automatik për të bërë përkthime të cilat nëse do të bien në dorën e një lexuesi të kualifikuar, sigurisht që jo vetëm do të tingëllojnë si përkthime fjalë për fjalë, por dhe në shumë raste, do të jetë vështirë të dalë kuptimi i tyre i vërtetë, për të mos thënë një pjesë e madhe e fjalive do të jenë një keqkuptim i madh krahasuar me origjinalin. Prandaj, megjithëse prirja e botës po shkon drejt robotizimit, përkthimi duhet të mbetet në listën e atyre profesioneve të cilat inteligjencën artificiale duhet ta konsiderojnë si ndihmëse, por të jenë ekskluzivitet vetëm i inteligjencës njerëzore, të kenë shpirt dhe ndjenja humane në çdo mesazh që transmetojnë apo dhe saktësi teknike kur bëhet fjalë për përkthime shkencore.

Fjalët çelës: e ardhmja, krijimtari, përkthim automatik, përkthyes profesionist, robotizim, teknologji

ABSTRACT

In the modern era we are living in, in addition to human translation man by man, automatic translation is time after time used, which technology enables with the continuous creation and improvement of various translation programs. In post-modern, globalist, consumerist societies, the fast pace of life and also businesses may need to translate voluminous materials in very short units of time, and this is probably the reason why automatic translation is required to make translations which if they fall into the hands of a qualified reader, not only will it sound like mot-à-mot translation, but also in many cases, it would be difficult to come up with its true meaning, not to mention a large part of the sentences would be a great misunderstanding compared to the original. Therefore, although the world trend is moving toward robotisation, translation has to remain on the list of those professions that should consider artificial intelligence as an aid, and only an exclusivity of human intelligence, in order for them to transmit their spirit and feelings in every message they convey and of course, technical accuracies when it comes to scientific translations.

Keywords: automated translation, creativity technology, professional translator, robotisation, the future

Hyrje

Përkthimi, si profesion mbart në vetvete artin dhe pasionin. Veç kësaj, ai është edhe pjesë përbërëse e historisë, artit, kulturës, diplomacisë, drejtësisë dhe ekonomisë ndërkombëtare. Siç thotë edhe Dr. Jorgji Kote, përkthyesit/interpretët nuk janë zanatçinj teknikë apo thjesht gjuhëfolës mekanikë, por komunikues dhe aktorë me horizont, dije dhe kulturë të gjerë në shumë fusha. Ka disa fakte historike që nuk mund të na dalin nga mendja, si për shembull: Konferenca e Paqes në Versajë, më 1919 dhe proceset gjyqësore të Nurenbergut, më 1946, të cilat nuk do të ishin mundësuar pa “ushtrinë” e përkthyesve/interpretëve.

Në çdo fushë dhe në shumicën e profesioneve të lira ose jo, ndikimi i internetit është i jashtëzakonshëm. Ndikimi është aq i madh sa jo vetëm ndihmon njerëzit për të kryer punët e tyre më lehtë e më shpejt, por arrin deri aty sa me anë të zhvillimit të pandalshëm të teknologjisë vitet e fundit edhe të zërë vendin e tyre. Bëhet fjalë këtu si për programe të ndryshme kompjuterike, ashtu dhe për pajisje të tjera robotike të komanduara. Në varësi të profesioneve, mbetet ende në diskutim pyetja, a janë këto programe dhe këta robotë të aftë të bëjnë punën e njerëzve po aq mirë sa vetë njerëzit? Ndoshta në disa profesione po, si për shembull: pastrimi i mjediseve të ndryshme, krasitja e barit, përgjigjja e telefonatave fikse, paketimi i kutive të ndryshme, ambalazhimi, etj., por kur bëhet fjalë për përkthimin, një profesion, i cili cilësohet i vështirë gjërat nuk janë kaq të lehta. Përkthimi i çdo lloj teksti, roman, novelë, fabulë, përrallë, fjalë e urtë apo poezi është e pamundur të bëhet me anën e programeve kompjuterike. Parë në këtë aspekt mund ta quaj, madje, një bekim, që fatmirësisht, ky profesion vazhdon ende të jetë nën mbikëqyrjen e qenieve njerëzore.

Përkthimi mundëson komunikimin efektiv të njerëzve në mbarë botën. Përkthyesi ndërton ura lidhëse mes kulturave, gjuhëve dhe kombeve të ndryshëm. Këtë ndërtim dhe ndërlidhje e bën nëpërmjet një pune të stërmundimshme. Është ndërlidhës për përcjelljen e njohurive, thelbësor për zhvillimin e një ekonomie globale dhe mbrojtës i trashëgimive kulturore. Në procesin e përhapjes së informacioneve të reja, përkthimi mund të ndryshojë historinë. Ndaj, përkthyesit e talentuar janë thelbi i gjithë kësaj pune shumë të madhe. Ata janë agjentët për përcjelljen e mesazheve nga një gjuhë në tjetrën, ndërsa ruajnë idetë dhe vlerat themelore ligjëruese, kuptimore dhe kulturore.

Përkthyesit duhet të jenë të aftë të për zgjedhin shprehje të ndryshme, fjalë të veçanta, të nxënë kuptimet e tyre e t'i ruajnë në mendje për t'i përdorur më vonë sa herë u lind nevoja. Këtu kemi të bëjmë me intuitën gjuhësore.

Intuita që të zhvillohet ka nevojë për praktikë të madhe e njohuri të shumta dhe është shumë e rëndësishme, si dhe një domosdoshmëri për një përkthyes të aftë. Për të qenë një përkthyes i mirë duhet shumë mund, punë dhe kërkohet një investim i konsiderueshëm në gjuhën burimore dhe në atë të cilën duam të përkthejmë. Mbi të gjitha, përveç njohjes së përsosur të gjuhës amtare dhe asaj nga e cila përkthen, nevojiten edhe njohuri të

thella e të gjera kulturore, historike, shkencore e kështu me radhë. Është një nga detyrat më sfiduese për të kaluar në mënyrë të sigurt dhe me besnikëri midis dy universeve të ligjërit.¹⁵⁶

Ka shumë njerëz që mendojnë se nëse dinë një gjuhë të huaj, atëherë automatikisht mund të vetëshpallen përkthyes, madje edhe të aftë profesionalisht, por jo! Kjo nuk është aspak e vërtetë dhe ky pohim as që i afrohet ndopak kësaj mjeshtërie.

Siç ka thënë dhe semiologu i famshëm italian, Umberto Eco: “Në përkthim nuk je duke bërë vetëm një përkthim nga një gjuhë në një tjetër, por je duke kaluar dhe nga një kulturë në një tjetër.”¹⁵⁷

Le ta fillojmë me një pyetje të zakonshme, po shumë të domosdoshme për të mësuar dhe kuptuar se përse është kaq shumë i nevojshëm një përkthyes profesionist. Cilat janë cilësitë e një përkthyesi, të cilat mund t’i përmbushë vetëm një i tillë?¹⁵⁸

- Aftësitë përkthimore – Sipas shumë teorive të përkthimit, duke filluar nga teoritë e Nida¹⁵⁹ e Newmark¹⁶⁰, është shumë i rëndësishëm zhvillimi sa më i mirë gjuhësor i përkthyesit. Duhet të shtojmë se, përpos njohurive shumë të mira në gjuhën e tyre dhe në gjuhën në të cilën përkthejnë, përkthyesit duhet mbi të gjitha të zotërojnë aftësi përkthimore.
- Pasioni – Një përkthyes duhet të jetë sa më i përkushtuar pas punës së tij. Ai duhet ta trajtojë çdo libër, tekst, material me ndjeshmëri dhe kujdes të jashtëzakonshëm, duke shpalosur gjithë ndjenjat e pasionin e tij në punën që është duke bërë.
- Kurioziteti – Një përkthyes profesionist nuk quhet i tillë nëse nuk ka kureshtjen dhe ngasjen për të mësuar fjalë e shprehje të reja çdo çast. Proces i të nxënies të një përkthyes duhet të jetë i pafundmë. Ai që pretendon se di gjithçka, në të vërtetë, ende nuk di asgjë.
- Fjalori i pasur – Përkthyesi duhet të ketë një fjalor jashtëzakonisht të pasur në gjuhën amtare dhe në gjuhën që është duke përkthyer, me qëllim që të lehtësojë sa më shumë procesin dhe përkthimin të ketë një cilësi sa më të lartë, gjithmonë duke i qëndruar sa më besnik tekstit origjinal.
- Qartësia – Qëllimi i padiskutueshëm i një përkthyesi të mirë është të shprehë idenë e tekstit origjinal sa më qartë e sa më rrjedhshëm në gjuhën në të cilën është duke

156 Razmjou L. Yemen, Hodeidah University, ‘To be a good translator’ presented at the Second International Conference on ‘Critical Discourse Analysis: the Message of the Medium’ (October 2003)

157 Eco U. ‘Experiences in translation’, University of Toronto Press Incorporated 2001, Toronto, Buffalo, London

158 Pacific International Translations, ‘The translator skillset’ (2020)

159 Eugene A. Nida ishte gjuhëtari i cili zhvilloi teorinë e ekuivalencës dinamike në përkthimin e Biblës dhe një nga themeluesit e disiplinës moderne të teorive të përkthimit.

160 Peter Newmark ishte një nga figurat kryesore në themelimin e Teorive të Përkthimit në botën anglisht-folëse në shekullin e 20-të.

përkthyer.

- Cilësia – Përkthyesi nuk duhet të lëshojë pe përse i përket cilësisë së përkthimit e në asnjë rrethanë nuk duhet të bëjë kurrfarë kompromisi me të.
- Krenari e përlulur – Një përkthyes i mirë sigurisht që ndihet shumë krenar kur sjell përkthimin e tij, ama duhet të jetë dhe me këmbë në tokë për të pranuar çdo korrigjim të mundshëm nga redaktori apo korrektori teknik. Në fund të fundit, e rëndësishme është që cilësia dhe saktësia e përkthimit të jenë maksimale dhe çdo mendim apo sugjerim duhet të jetë gjithmonë i mirëpritur.

Duke parë me vëmendje të gjitha pikat e mësipërme e shtjellimet për gjithësecilën prej tyre mund të kuptohet fare mirë që një makineri e një program kompjuterik nuk mund të bëjnë një punë kaq të detajuar e me kaq shumë shpirt, pasion, mund e dashuri, siç mund ta bëjë një qenie njerëzore.

Pjesa më e madhe e përkthimeve, sidomos atyre letrare, ka të bëjë më shumë me një “rikrijim” nga ana e përkthyesit se sa përkthimi fjalë për fjalë i tekstit original. Një arsye më shumë kjo për të kuptuar se përse janë të domosdoshëm përkthyesit dhe do të vazhdojnë të jenë të tillë edhe në të ardhmen. Përkthyesit njerëzorë nuk mund të quhen kurrësi “të dalë kohe”, edhe pse teknologjia vitet e fundit nuk po njeh të ndalur. Një përkthim nuk mund të quhet i plotë ose i përfunduar pa dorën e njeriut dhe inteligjenca artificiale nuk mund të krahasohet me inteligjencën njerëzore në këtë rast.

Një nga programet më të njohura e më të përdorura në mbarë botën që ndihmon në përkthimin e materialeve të ndryshme në mënyrë automatike është Google Translate. Ky është një program praktik e nuk mund të mohojmë që ka disa përparësi, mes tyre shpejtësia dhe kostoja jo e lartë e përkthimit, por përsëri nuk mund të zëvendësojë përkthyesin njerëzor, qoftë edhe vetëm për një arsye të thjeshtë: Google Translate dhe çdo program tjetër kompjuterik i ndërtuar për këtë qëllim, përveç ndjenjës njerëzore që është e pamundur ta përcjellin, gjithashtu nuk mund të përshtasin fjalë të caktuara sipas kontekstit të fjalisë, gjë kjo shumë e rëndësishme, pasi shumica e fjalëve kanë dy ose më shumë kuptime.

Kjo është dhe një ndër arsyet kryesore se përse përkthimi cilësohet i vështirë, për shkak të polisemisë apo ndryshe kuptimeve të shumta që mund të marrë një fjalë e vetme. E pikërisht për këtë shkak, të përkthesh nga gjuha angleze në gjuhë të tjera është shumë më e ndërlikuar nga ç’mund të mendohet. Në mënyrë që të përshtatësh fjalën në kontekstin e duhur, duhet të përdorësh një fjalë tjetër, ndryshe nga ajo që mund të ketë si kuptim të parë.

Sipas studimeve dhe testeve të kryera nga vetë Google Translate, saktësia e përkthimit varet nga vetë gjuhët nga të cilat kryhet përkthimi. Është shumë më e lehtë për Google Translate të përkthejë nga gjuha frënge në gjuhën angleze, për shkak se të dyja gjuhët kanë shumë të përbashkëta. Po nëse kemi të bëjmë me gjuhë të cilat

kërkojnë një kapërcim më të madh nga njëra te tjetra; për shembull nga gjuha kineze në anglisht? Kjo është shumë e vështirë për t'u realizuar me anë të përkthimit automatik për shkak të ndryshimeve të mëdha që kanë këto dy gjuhë. Gjuhë të ndryshme kanë gjithashtu gramatikë të ndryshme, rend fjalësh të ndryshëm dhe shpeshherë edhe fjalë të cilat nuk e kanë të barasvlefshmen e tyre në gjuhën tjetër.

Programi kompjuterik e përkthen materialin fjalë për fjalë, ku në shumicën e rasteve, do të përftohet një produkt jo i qartë dhe, madje, shpesh herë qesharak, prandaj nuk mund t'i besosh Google Translate apo ndonjë programi tjetër. Është e kuptueshme, pra, se mundësia e gabimeve të shumta gjatë përkthimit automatik është e pashmangshme dhe do të jetë gjithmonë e pranishme. Makineritë janë të paafta që të kenë atë cilësi që i bën njerëzit unikë dhe në të njëjtën kohë superiorë ndaj tyre. Kjo është arsyeja se përse mendja njerëzore do të jetë gjithmonë çelësi i duhur që hap dyert e përcjelljes së ideve, mesazheve.

Një nga teoricienët më të mirë të teorisë së përkthimit është André Lefevere (1945-1996)¹⁶¹. Lefevere i klasifikon përkthyesit në konservatorë dhe shpirtërorë. Përkthyesi konservator punon në nivelin e fjalës dhe të fjalisë, ndërsa përkthyesi shpirtëror punon në nivelin e kulturës si e tërë dhe e vendos tekstin në funksion të kësaj kulture.

Përkthimi automatik nuk arrin të jetë pjesë as e përkthyesit konservator e jo më të pretendohet të jetë pjesë e atij shpirtëror.

Gjuha është delikate dhe e ndërlikuar. Populli ynë thotë se “Gjuha kocka nuk ka, por kocka thyen!”. Në varësi të aftësisë dhe saktësisë ose jo të një përkthyesi, në botë janë shkaktuar e shpallur luftëra.

Ne nuk mund të presim që makineritë të kuptojnë çdo aspekt të mënyrës se si qeniet njerëzore komunikojnë me njëra-tjetrën. Kultivimi i mësimi të makinerisë deri në atë pikë që të mund të kuptojë me të vërtetë gjuhën natyrore dhe të gjitha nuancat e saj është një pengesë e madhe që shkencëtarët e kompjuterave kanë provuar prej kohësh ta kapërcejnë, por nuk kanë mundur.¹⁶² Ndaj, shërbimet e përkthimit profesional janë gjithmonë zgjedhja më e mirë, duke përdorur njerëzit e vërtetë e jo inteligjencën artificiale për të kapërcyer hendeqet e pengesave gjuhësore.

Sidoqoftë duhet të jemi të përgatitur për më të keqen e duhet të japim më të mirën tonë. Lind pyetja: Çfarë mund të bëjmë që të mbrojmë përkthyesit njerëzorë nga programet kompjuterike dhe përkthimet automatike?¹⁶³ Si përkthyes profesionistë, patjetër duhet të angazhohemi për t'u përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, pa ndalim. Rritja e vazhdueshme profesionale si një angazhim gjatë gjithë jetës së përkthyesit, rrit edhe mundësitë që përkthyesi të bëhet i domosdoshëm për këdo që punon me të. Ndaj, është plotësisht në dorë të përkthyesit të ofrojë një nivel të lartë të cilësisë dhe shërbimit, në mënyrë që ata që punojnë me të, të mos mendojnë kurrë ta zëvendësojnë me një

161 Lefevere A. *Translation, remitting, and the manipulation of literary fame*, Routledge (1992)

162 Argo Translation. *'How accurate is Google Translate in 2019?'* (2019)

163 Mironov R. *'Rise of the machines: Are translators endangered species?'* (2012)

përkthyes tjetër dhe, aq më pak, me një program përkthimi automatik.

Materialeve të përkthyer në mënyrë automatike u mungon rrjedhshmëria dhe natyraliteti dhe, në shumicën e rasteve, janë të pakuptueshme për shkak të fjalive e frazave të dobëta që përmbajnë. Është e pamundur të lexohet mes rreshtave, të nxirren në pah dhe të theksohen elementë të rëndësishëm e të transmetohen detajet dhe nuancat e materialit origjinal. Platformat automatike të përkthimit nuk bëjnë dot dallimin as midis fjalëve me kuptime të ndryshme, as midis strukturave gramatikore me kuptim të dyfishtë, sepse makineria dhe programi kompjuterik nuk mund të kuptojnë kontekstin tematik ose kulturor të materialit burimor. Një fakt i pamohueshëm është që këto teknologji vështirë se përputhen me hulumtimin e terminologjisë së kryer nga një përkthyes njerëzor. Krijimtaria e përkthyesit është një vlerë e shtuar për përkthimin. Përkthyesit mund të tregojnë një krijimtari të shkëlqyer dhe janë vazhdimisht në kërkim të shprehjeve që përputhen plotësisht në mënyrë të përsosur me kuptimin që do të përçohet, deri në atë pikë sa të duket që teksti është shkruar drejtpërdrejt në gjuhën e synuar. Sa i përket përkthimeve teknike të specializuara, është e mundur të garantohet cilësi optimale dhe t'u jepet kuptim termave teknikë vetëm duke bashkëpunuar përkthyesi me njerëz të specializuar në fushën përkatëse. Metoda e punës së një përkthyesi profesionist bazohet tek ndërthurja e ekspertizës gjuhësore dhe njohurive të gjera të specialistëve të secilës fushë.

Ky “problem” nuk është diçka që prek vetëm botën e përkthimit. Sipas një studimi të Universitetit të Oxford-it¹⁶⁴, studiuesit parashikojnë se 47% e punëve amerikane kanë gjasa të përballen me automatizim gjatë 20 viteve të ardhshme. Sidoqoftë, i njëjti studim tregon se 53% e punëve ka gjasa të mos preken fare nga ky automatizim.

Ndaj është shumë e rëndësishme të theksohet që robotët kanë më pak gjasa të marrin përsipër role të varura nga bashkëveprimi njerëzor, si në rastin e përkthyesit, mësuesit, doktorit, etj.

Përkthimi është po aq i vjetër sa shkrimi e këndimi dhe ka ekzistuar gjithmonë si mjet komunikimi midis njerëzve të kulturave e gjuhëve të ndryshme. Është shumë e rëndësishme të kuptohet që përkthimi është një profesion që duhet ta marrin përsipër ta kryejnë vetëm përkthyesit profesionistë. A do të merrnit përsipër të shkonit në gjykatë në rolin e një avokati, gjyqtari, pa pasur njohuritë e duhura ligjore dhe kualifikimet e caktuara? A do të operonit një pacient nëse nuk keni njohuritë e duhura mjekësore dhe nuk keni as përvojën dhe as diplomën në këtë fushë? A do të hynit në kuzhinë për të gatuar një drekë apo një darkë për të ftuar të rëndësishëm, kur gjithë çfarë keni gatuar në jetën tuaj kanë qenë vezë e makarona? A do ta ndërtonit një shtëpi nëse nuk do t'ia kishit idenë se si ndërtohet një e tillë? Përse të mos respektohet profesioni i përkthyesit në të njëjtën mënyrë? Përkthyesi është një mjeshtër i fjalës, njeri krijues. Ashtu siç një argjendar zgjedh me shumë kujdes gurët më të mirë dhe mjetet më të përshtatshme për t'i punuar

164 Frey C. B. and Osborne M. A. ‘*The future of employment: how susceptible are jobs to computerisation?*’ (September 2013)

ato, përkthyesi profesionist e formëson përkthimin e tij si një xhevahir. Një përkthim i mirë kërkon një analizë të plotë dhe hulumtim sa më të gjerë. Përkthimi është produkt i një pune artizanale dhe inteligjence njerëzore. Programet kompjuterike e makineritë e përkthimit janë shumë të kufizuara, ato nuk pranojnë shumë aspekte të tekstit burimor dhe shumë faktorë të tjerë të përkthimit që truri i njeriut mund t'i përpunojë duke marrë parasysh procesin kompleks të përkthimit: stili, fusha e specializimit, terminologjia, ndryshimet kulturore, konteksti, etj.

Për të kuptuar edhe më qartë ndryshimet thelbësore mes dy përkthimeve, më poshtë janë sjellë disa shembuj fjalish të përkthyer nga përkthyesit njerëzorë dhe po të njëjtat fjali të përkthyer nga përkthyesit automatik:

Teksti original¹⁶⁵	Google Translate 2020	Përkthimi i përkthyesit¹⁶⁶
And now nothing remains for me but to assure you in the most animated language of the violence of my affections.	Dhe tani nuk mbetet asgjë tjetër veçse të ju siguroj në gjuhën më të animuar të dhunës së dashurive të mia.	Dhe tani s'më ngelet gjë tjetër për të thënë veçse të të shpreh me fjalët më të fuqishme flakën e dashurisë time.
Two offences of a very different nature, and by no means of equal magnitude, you last night laid to my charge.	Dy vepra të një natyre krejt të ndryshme, dhe në asnjë mënyrë të përmasave të barabarta, ju natën e kaluar ju vunë nën akuzën time.	Dy akuza më keni bërë dje në darkë, të ndryshme në tip dhe në rëndësi.
Why, if he came only to be silent, grave, and indifferent,' said she, 'did he come at all?	Pse, nëse ai erdhi vetëm për të heshtur, i rëndë dhe indiferent "tha ajo," a erdhi fare?	"Në kishte ndër mend të rrinte serioz e indiferent si gur varri, pse erdhi?" – e pyeste ajo veten.
She could not yet recover from the surprise of what had happened.	Ajo ende nuk mund të shërohej nga befasia e asaj që kishte ndodhur.	Akoma nuk e kishte marrë veten nga surpriza e natës së kaluar.
Her hopes were answered; Jane had not been gone long before it rained hard.	Shpresat e saj u përgjigjën; Jane nuk kishte kaluar shumë kohë para se të binte shi i fortë.	Dhe pati të drejtë, sepse Xhejni nuk kishte pak që ishte nisur, kur ia nisi shiu vendçe.

165 Austen J. 'Pride and Prejudice', Dover Publications, York edition first published in 1995, is an unabridged, slightly, corrected republication of the text of the first edition of 1813 (London: T.Egerton)

166 Steiner-Karafili E. "Krenari dhe paragjykim", (përkth.), Botimet Toena (2007), Tiranë

Mund të provoni të gjithë shembujt e mundshëm që dëshironi e do të kuptoni që me anë të përkthimit automatik nuk mund të arrihet kurrë saktësia gjuhësore, radhitja e saktë e fjalëve në fjali, nuanca e duhur e fjalive origjinale në përkthim dhe asgjë tjetër që të mund t'i jepte emrin përkthim kësaj pune.

Përkthyesit profesionistë nuk duhet të bëhen viktimë e një bote që, fatkeqësisht, udhëhiqet nga paraja dhe konsumizmi¹⁶⁷. Përkthimi profesionist po automatizohet. Teknologjia është thjesht një mjet ndihmës dhe si e tillë duhet të trajtohet. Truri njerëzor është shumë më kompleks sa të mund të arrijë të riprodhohet në një makineri. Roli i përkthyesit fillon aty ku mbaron roli i teknologjisë. Përkthimi është një detyrë rikrijuese dhe vetëm njerëzit mund të jenë rikrijues. Përkthimi është pjesë edhe e botës letrare, por bota po e humb poezinë e saj. Le ta shpëtojmë!

Po e mbyll me një citim sërish nga studiuesi Umberto Eco: “Zanati i përkthyesit është një profesion i së ardhmes¹⁶⁸”.

Bota ka pasur, ka dhe do të ketë gjithmonë nevojë për përkthyes profesionistë, por mbi të gjitha për mendje njerëzore, të afta që të kuptojnë, të bluajnë thelbin e më pas ta përcjellin atë në një gjuhë tjetër sa më besnikërisht. Një përkthyes është si një tel përçues energjie elektrike, prej bakri apo alumini nuk ka fort rëndësi. Ajo që vlen më tepër është që energjia të përçohet sa më shumë, sa më mirë e sa më shpejt, dhe mbi të gjitha, që në këtë përçim të ketë sa më pak humbje që të jetë e mundur. Vetëm në këtë mënyrë kuptimi dhe ideja origjinale është përçuar ashtu siç duhet, e pacënuar, e plotë dhe e efektshme.

Përfundime

Përkthimi është sa shkencë, po aq edhe art; është shkencë për nga saktësia gjuhësore, është art për nga formulimi i fjalive sipas kontekstit. Prandaj, me gjithë zhvillimin e madh teknologjik, kompjuterik apo dhe prirjen për të krijuar lloje të reja programesh përkthimi, kur bëhet fjalë për përkthim cilësor që të tingëllojë rrjedhshëm e natyrshëm në gjuhën që do të përkthehet, përkthyesi përmes rikrijimit të tij ka një vlerë të paçmueshme e një rol të pazëvendësueshëm.

Përkthimi është profesion i mirëfilltë, të cilin nuk mundet ta bëjë çdo njeri që njeh një gjuhë të huaj. Ai kërkon talent, pasion, kulturë të gjerë, të cilat vështirë se arrin t'i zëvendësojë teknologjia, sado në nivele të larta qoftë ajo.

167 Ségard V. “Professional translators: an endangered species – or the robotization of the world” (2009)

168 Tupja E. “Këshilla një përkthyesi të ri”, Shtëpia Botuese “Onufri” (2014), Tiranë

BIBLIOGRAFIA:

ARGO TRANSLATION (2019), How accurate is Google Translate in 2019

AUSTEN, J. *Pride and Prejudice*, Dover Publications, York edition first published in 1995, is an unabridged, slightly, corrected republication of the text of the first edition of 1813 (London: T. Egerton)

ecO, U. (2001), *Experiences in traslation*, University of Toronto Press Incorporated, Toronto, Buffalo, London.

freY, c. B. & OSBORne, m. A. (2013), *The future of employment: how susceptible are jobs to computerisation*.

Lefevere, A. (1992), *TRANSLATION, REMITING, And The RANIPULATION OF LITeRARY FAME*. ROUTledge.

mIRONOV, R. (2012), Rise OF The machines: ARE TRANSLATORS endAngered species.

RAZMJOU, L. (2003), *To be a good translator*. presented at the Second International Conference on «Critical Discourse Analysis: the Message of the Medium», Hodeidah University, Jemen.

sèGARD, v. (2009), *Professional translators: an endangered species – or the robotization of the world*.

Steiner-KARAFILI, e. (2007), *Krenari dhe paragjykim, (përkth.)*, Botimet Toena, Tiranë.

TUPJA, e. (2014), *Këshilla një përkthyesi të ri*, Shtëpia Botuese “Onufri”, Tiranë.

IMPLEMENTIMI I MATERIALEVE AUTENTIKE NË KURSET E GJUHËS SË HUAJ TEKNIKO-SHKENCORE DHE TEKNIKAT QË NDIHMJOJNË NË PËRVETËSIMIN E ELEMENTËVE TË SAJ GJUHËSORE

Dr. SONILA PIRI

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: sonilapiri@gmail.com

Dr. ENKELA DALIPI

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: edalipi.it@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Në sajë të hulumtimeve që kemi kryer është vënë re që vitet e fundit është rritur interesi për mësimdhënien e gjuhës së huaj tekniko-shkencore. Në këtë kuadër edhe shkollat e larta në Shqipëri kanë përshtatur kurrikulat duke ofruar lëndë të gjuhës së huaj tekniko-shkencore, por botimet që ofron tregu për këtë fushë nuk janë të mjaftueshme dhe shpesh nuk i përgjigjen kërkesave të mësimdhënësve e mbi të gjitha nevojave të studentëve. Duke vlerësuar nevojat imediate dhe të ardhme të studentëve, mësimdhënësit mund të përdorin në kurset e tyre materiale autentike tekniko-shkencore. Teknikat që do të përdoren gjatë didaktizimit të teksteve duhet të jenë të shumëllojshme e të renditura në vartësi të fazave që ndjekin njësitë didaktike. Në këtë punim janë ilustruar tipologji të ndryshme ushtrimesh që mund të përdoren në tekstet tekniko-shkencore për të ndihmuar të kuptuarit dhe që aftësojnë në leximin e tyre; nxisin reflektimin dhe krijimin e hipotezave për njohjen dhe përvetësimin e fenomeneve të posaçme leksikore e morfosintaksore që karakterizojnë gjuhën tekniko-shkencore.

Fjalët çelës: didaktizim i tekstit, gjuhë tekniko-shkencore, materiale autentike, teknika ushtrimesh

ABSTRACT

Based on the research conducted, we have found out that there is an increased interest recently for teaching foreign languages for specific purposes, namely for science and technology. In this context, universities in Albania have adjusted their curricula to offer foreign languages for science and technology purposes, but the publications/books that the market offers on this domain are not sufficient and often do not respond to the requirements/demand of teachers, and above all to those of the learners. After analyzing the immediate needs of the students and their future, teachers can use in their teaching practice authentic materials from the science and technology domain. The techniques

to be used in teaching those texts must be diverse and rendered based on the stages or steps that comprise of each unit. This paper illustrates various types of exercises that can be used with texts for science and technology in a foreign language, in order to help understanding and to provide reading skills; to prompt reflection and to come up with a hypothesis for identifying and acquiring particular lexical and morpho-syntactic phenomena that characterize the language of science and technology texts.

Keywords: authentic materials, didactic text, exercises and techniques, language for specific purposes

Hyrje

Vitet e fundit mësimdhënia e gjuhës së huaj tekniko-shkencore ka marrë hov veçanërisht në auditorët e universiteteve në të gjithë botën, por edhe në vendin tonë. Një nga arsyt kryesore të rritjes së kërkesës së mësimdhënies së gjuhës së huaj tekniko-shkencore, është faktori i globalizimit, i cili mundëson lëvizjen dhe punësimin në sektorë të ndryshëm të shkencës falë njohurive specifike gjuhësore të zotëruara në një fushë të caktuar. Për këtë arsye, shumë universitete kanë ndryshuar kurrikulat duke i përshtatur ato me nevojat aktuale dhe të ardhme të studentëve të tyre, duke ofruar jo vetëm mësimin e gjuhës së huaj por edhe atë tekniko-shkencore në varësi të degëve dhe kurrikulave përkatës. Në këtë kuadër edhe shkollat e larta në Shqipëri i janë përgjigjur nevojave të reja formuese duke plotësuar programet gjuhësore me elementë të gjuhës tekniko-shkencore.

Nga ana tjetër lind pyetja nëse tregu i botimeve të këtyre materialeve didaktike i plotëson kërkesat e mësimdhënësve dhe mbi të gjitha nevojat specifike të studentëve që duhet të frekuentojnë lëndën. Nga hulumtimet që kemi kryer pranë shtëpive botuese, si edhe në rrjet me qëllim qëmtimin e materialeve që mund të përdoren për mësimdhënien e gjuhës italiane tekniko-shkencore, na rezulton që materialet në treg janë të pakta dhe mund të mos përshtaten me nevojat specifike të një moduli të gjuhës së huaj tekniko-shkencore në universitetet tona. Siç është e njohur dhe e cituar nga ekspertë të fushës së didaktikës të gjuhës së huaj, materialet që përgatiten dhe ofrohen synojnë një treg të gjerë duke përfshirë një shumëllojshmëri përdoruesish të cilët mund të kenë një background kulturor dhe gjuhësor të ndryshëm. Ndërsa në kontekste të veçanta, nevojat e mësimnxënies së gjuhës së huaj tekniko-shkencore mund të jenë të ndryshme e tejet specifike e, në këtë rast, mësimdhënësit mund të konstatojnë që materialet e gatshme mund të jenë pak ose aspak të duhura për klasat e tyre.

Në librin e tij “Mikrogjuhët shkencore-profesionale”¹⁶⁹ studiuesi Balboni thekson

169 Balboni P.E. (2000) *Le Microlingue scientifico-professionali* “Natura e insegnamento, UTET Libreria, Torino

që ekzistojnë nevoja që mbeten në kuadër të klasës dhe nevoja që do të duhet të implementohen kur klasa nuk do të ekzistojë më, pra, vlerësimi i nevojave duhet të përfshijë jo vetëm ato të ngutshme, por edhe realitetin e çdo studenti dhe perceptimin e tij ndaj realitetit dhe nevojave të ardhshme¹⁷⁰. Shumë studiues të fushës janë marrë dhe kanë analizuar këto nevoja të studentëve, por pa specifikuar edhe nevojat e mësimdhënësve. Këtë fakt e thekson edhe studiuesi Balboni¹⁷¹. Sipas tij figura e mësimdhënësit nuk nënkupton njohjen e posaçme të fushës, gjuhën tekniko-shkencore të së cilën ai jep. Kjo nënkupton që një pedagog apo mësimdhënës i gjuhës italiane, angleze, franceze mjekësore, ekonomike, juridike etj, nuk është e rëndësishme të ketë njohuri të posaçme në mjekësi, ekonomi, juridik etj, por duhet të punojë mbi bazën e një kurrikule e cila përcakton edhe njohuritë shkencore-profesionale që studentët duhet të zotërojnë, pasi janë këta të fundit që duhet të bashkëpunojnë me mësimdhënësin (i cili është ekspert i gjuhës së huaj dhe jo i fushës shkencore) në interpretimin dhe analizën e teksteve tekniko-shkencore¹⁷². Nga hulumtimet tona është konstatuar që jo gjithmonë në realitet këto nevoja të të dyja palëve merren në konsideratë, si p.sh në disa kurrikula mësimdhënieje të gjuhës së huaj tekniko-shkencore paraprin formimin shkencor dhe profesional ndaj atij gjuhësor, gjithashtu materialet që serviren nga instancat kompetente nuk janë gjithmonë të përshtatshme me nivelin gjuhësor dhe formimin shkencor dhe profesional të studentëve. Në fakt, edhe kur mësimdhënësi i gjuhës së huaj ka në dispozicion mjete të ndryshme si: libra gjuhe, libra udhëheqës, libra ushtrimesh, programe te ndryshme etj., shpesh duhet gjejë e të përshtatë materiale për klasën e tij. Por a ka njohuri dhe formimin e duhur për të analizuar një tekst të gjuhës së huaj tekniko-shkencore, apo të krijojë materiale didaktike plotësuese?

Në këtë punim mësimdhënësit e gjuhës së huaj tekniko-shkencore mund të gjejnë orientime për mënyrën e përzgjedhjes dhe përshtatjes së materialeve autentike në procesin mësimor, me qëllim që studentët apo përfutuesit e këtyre teksteve të aftësohen për një nxënie afatgjatë dhe motivuese.

Vlerësimi i nevojave të studentëve

Balboni nënvizon që një nga veçoritë që duhet të përftojë mësimdhënësi i gjuhës së huaj tekniko-shkencore është “pavarësia” që duhet të krijojë duke ndjekur ndryshimet e shpeshta të botës shkencore-profesionale, në rrafshin epistemologjik dhe kulturor, ndryshimet e stileve të gjuhës duke u ndihmuar nga rrjetet telematike që janë shndërruar tashmë në burime të zakonshme të përcjelljes së mesazheve të gjuhës tekniko-

170 Shih f. 70

171 Shih f. 71

172 Po aty

shkencore¹⁷³:

Mësimdhënësi që dëshiron të përgatisë materiale për mësimin e gjuhës së huaj tekniko-shkencore, pikësëpari duhet të analizojë nevojat gjuhësore të studentëve të cilët do të përdorin këto materiale, me qëllim organizimin e procesit didaktik që nënkupton seleksionimin e materialeve gjuhësore dhe strategjinë e përzgjedhur për përshtatjen e këtyre të fundit në mësimin e gjuhës së huaj tekniko-shkencore.

Sipas Pierini-t¹⁷⁴ analiza e nevojave të studentëve i referohet nevojës për të implementuar një proces didaktik që merr në konsideratë studentët të cilësuar si subjekte dhe jo si persona anonimë, me nevojat e tyre komunikuese, kushtëzimet e tyre social-kulturore, background-in e tyre të eksperiencave në nxënie dhe të njohurive që zotërojnë. Sipas kësaj qasjeje pedagogjike¹⁷⁵ mësimdhënia duhet të zhvillohet duke iu përshtatur sa më shumë realitetit psikologjik e social-kulturore të studentit. Studiuesja thekson gjithashtu që çdo student mund të ketë nevoja specifike, që ndryshojnë nga individët e tjerë e për t'i përmbushur ato mund të krijohen grupe studentësh me nevoja të ngjashme të ashtuquajtura “grupe marrësish”¹⁷⁶

Sikurse studiuesi Balboni¹⁷⁷ nënvizon, analiza e nevojave gjuhësore duhet të marrë në konsideratë: “nevojat pragmatike të ardhshme”, që kanë lidhje me formimin profesional dhe “nevojën e të mësuarit si mësohet”, e cila i referohet arritjes së pavarësisë gjatë mësimnxënies, si edhe “nevojat aktuale të studentit”, që lidhen me motivimin i cili duhet të jetë gjithnjë i lartë gjatë procesit të nxënies.

Jemi të mendimit që nevojat e pavarësisë në nxënie dhe llojet e teknikave didaktike që do të përdoren, ndryshojnë në varësi të tipologjisë së kursit të gjuhës së huaj tekniko-shkencore¹⁷⁸. Në fakt, studiuesit Coonan¹⁷⁹, Serragiotto¹⁸⁰ dhe Ballarin¹⁸¹ theksojnë që nevojat dhe interesat ndryshojnë, nëse pjesëmarrësit në klasën e gjuhës së huaj tekniko-shkencore janë të niveleve të ndryshme hierarkike, si p.sh. në rastin e një kursi të zhvilluar në ndërmarrje ku nevojat dhe marrëdhëniet psiko-sociale janë të ndryshme

173 Shih f. 110 -111

174 Pierini P. (1981) *L'analisi dei bisogni linguistici: teoria e pratica* në *L'insegnamento linguistico per scopi speciali* Ciliberti A. (a cura di), Zanichelli, Bologna, f. 58

175 Po aty

176 Shih f. 60

177 Balboni P.E.(2002) *Le sfide di Babele. Insegnare le lingue nelle società complesse*, Utet Libreria, Torino, f.91

178 Piri S. & Gjinali A.(2013) *L'insegnamento dell'italiano microlinguistico all'università: la necessità di nuovi percorsi mirati con integrazione di materiali autentici e supporti multimediali* në “Linguistic and Communicative Performance Journal” LCPJ Publishing, Tirane, ISSN 2073-5138 (print), Vol 6/2

179 CoonanC.M. (2002) *La lingua straniera veicolare* UTET Libreria, Torino

180 Serragiotto G. (2003)*C.L.I.L.Apprendere insieme una lingua e contenuti non linguistici*, Guerra-Soleil, Perugia,

181 Ballarin E. (2009)*Didattica delle Microlingue*, [Internet] (24 faqe), Moduli FILIM, Dipartimento di Scienze del Linguaggio dell'Università degli Studi Ca' Foscari, Venezia, prill 2009, f. 9

http://venus.unive.it/filim/materiali/accesso_gratuito/Filim_microlingue_teorìa_1.pdf

nga klasa të frekuentuara nga studentë universitarë. Si rrjedhojë sipas Ballarin-it¹⁸² për shkak të ndryshimit që paraqesin këto kategori, edhe aspekte të tjera të procesit didaktik si përzgjedhja e përmbajtjeve gjuhësore, të aftësive në nxënie etj., pësojnë ndryshime.

Përzgjedhja e teksteve tekniko-shkencore

Përzgjedhja e materialeve që duhet të përdoren në kursin e gjuhës së huaj tekniko-shkencore ka qenë gjithmonë objekt diskutimesh. Disa studiues sugjerojnë që nuk është e nevojshme të përdoren materiale gjuhësore të karakterit specifik, pasi sipas tyre tekstet karakterizohen kryesisht nga niveli i leksikut dhe kjo bën dallimin nga një tekst i zakonshëm tek një tekst me përmbajtje të posaçme. Jemi të mendimit që një tekst me përmbajtje tekniko-shkencor, sigurisht që ka një leksik specifik që karakterizon lëmin ku është lëvruar, por nga ana tjetër një tekst i tillë zotëron edhe specifika të tjera karakteristike të këtyre gjuhëve. Po ashtu, jemi të mendimit që nëse me studentë të fushave të caktuara do të përdoreshin në mësimin e gjuhës së huaj tekste të interesit të tyre profesional, do të ishte më motivuese për ata, por përzgjedhja dhe didaktizimi i tyre duhet të jetë shumë i kujdesshëm pasi edhe thjeshtimi i tepërt do të përbënte mosinteresim. Në këtë rast një feedback do të ishte shumë i rëndësishëm për të vlerësuar përshtatshmërinë e tekstit përmes mendimit të vetë përdoruesve.

Pjesa më e madhe e studiuesve bien dakord që këto tekste duhet të jenë autentike, pra, të përgatitura e të përdorura nga persona të vendit ku flitet gjuha e huaj.

Sipas Gotti-t¹⁸³ këto tekste nuk është e thënë që të jenë pikërisht ato që studentët do të gjejnë në eksperiencën e mëvonshme të punës, por të shërbejnë për të mundësuar përvetësimin e kompetencave dhe të njohurive thelbësore që u nevojiten për vendin e ardhshëm të punës.

Përveç orientimeve të ndryshme që studiuesi i mësipërm jep në lidhje me përdorimin e teksteve autentike në klasën e gjuhës së huaj tekniko-shkencore, nënvizon edhe rëndësinë thelbësore të tyre me qëllim reflektimin e llojit metagjuhësor¹⁸⁴, që sipas tij edhe në rastet kur këto tekstet e përzgjedhura nuk përcjellin në klasë origjinalitetin ose kur nuk mundësojnë një ndërveprim komunikues, analiza që mund t'u bëhet atyre është shumë e rëndësishme pasi nxjerr në pah karakteristikat e gjuhës së specialitetit të përdorur në atë tekst. Nga ana tjetër përdorimi i materialeve autentike mund t'ua vështirësojë nxënien studentëve që nuk i kanë të përvetësuar disa kompetenca specifike të nevojshme për të punuar me tekste të gjuhës së specialitetit. Këtë fakt e nënvizon edhe

182 Po aty

183 Gotti M. (1992) *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*, La Nuova Italia, Firenze, f. 41

184 Po aty f. 43-44

studiuesi Williams¹⁸⁵ sipas të cilit vështirësitë e hasura në leximin e teksteve autentike pengojnë lexuesit të përqendrohen tek përmbajtja, pasi fokusohen gjatë në veprimtari që kanë lidhje me analizimin e formës sipërfaqësore të tekstit.

Gotti¹⁸⁶ edhe pse është dakord me vështirësitë gjuhësore dhe konceptuale të teksteve autentike, të cilat sipas tij nganjëherë janë të tepërta për nivelet e kompetencave që zotërojnë studentët, nuk e mbështet tërësisht idenë e thjeshtimit të materialeve autentike, pasi sipas tij me thjeshtimin e tyre, mund të ndryshohen tërësisht rregullat karakteristike që ekspertët e fushës përdorin në formimin e këtyre teksteve. Një mënyrë e saktë qasjeje me tekstet autentike është vëzhgimi dhe kuptimi jo vetëm sipërfaqësor, por edhe pragmatik¹⁸⁷ duke ripërsëritur në tekste të ndryshme ato struktura që janë të nevojshme për t'u përvetësuar. Në fakt përqasja e studentëve me tekste të mirëfillta autentike të pasura me struktura gjuhësore të posaçme është më frytdhënëse për përvetësimin e gjuhës e këtë nuk do ta mundësonte përdorimi i teksteve shumë të thjeshtuara apo të ndërtuara enkas për një kurs të caktuar të gjuhës së huaj tekniko-shkencore.

Gotti dhe studiues të tjerë sugjerojnë gjithashtu që imazhet që shoqërojnë tekstet autentike të mos ndryshohen dhe të paraqiten në variantin origjinal, sepse ilustrimet janë mjete që ndihmojnë në përvetësimin e përmbajtjes së tekstit.

Një aspekt tjetër për të cilin studiet bien dakord është motivimi që sjell përdorimi i teksteve autentike pasi janë të vetëdijshëm që ato janë materiale që studentët do t'i konsultojnë gjatë studimeve apo më tej në ushtrimin e profesionit të tyre. Si rrjedhojë didaktizimi i këtyre materialeve do të ishte procesi më i përshtatshëm që paraprin organizimin didaktik të tekstit.

Tipologjia e ushtrimeve në tekstet tekniko-shkencore

Ushtrimet apo teknikat që përdoren në tekstet tekniko-shkencore, duhet të jenë të shumëllojshme, pasi edhe strategjitë në nxënie të studentëve janë të ndryshme. Gjithashtu këto ushtrime duhet të përfshijnë të gjitha aftësitë thelbësore dhe dytësore të përvetësimit të gjuhës së huaj.

Ushtrimet që aftësojnë leximin janë shumë të rëndësishme në mësimin e gjuhës së huaj tekniko-shkencore, për natyrën profesionale të këtyre kurseve gjuhësore, si dhe për shpeshësinë e përdorimit të këtyre teksteve të gjuhës sektoriale. Jemi të mendimit që aftësimi i leximit është i rëndësishëm për studentët që mësojnë një gjuhë të huaj tekniko-shkencore, jo vetëm për përvetësimin e leksikut, por edhe për të zbuluar e përmirësuar strategjitë vetjake të përqasjes me tekste të posaçme profesionale.

185 Williams R. (1983) *Communicative Reading* në Jonson and Porter (eds:) f. 171-188

186 Gotti M. (1992) *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*, La Nuova Italia, Firenze, f. 45

187 Po aty

Lexuesit apo studentit që lexon një tekst tekniko-shkencor nuk i mjafton të njohë çështjen e përgjithshme apo përmbajtjen e tij, atij i duhet të dekodifikojë tekstin, të krijojë hipoteza rreth funksioneve dhe kuptimeve që ai mbart, si edhe të identifikojë fjalët e reja dhe të nxjerrë kuptimin të tyre. Në këtë kuadër është detyrë e mësimdhënësit të mësojë klasën me një qasje vepruese kundrejt tekstit duke ftuar studentët të krijojnë hipoteza përpara dhe pas leximit të tekstit e më pas duke bërë edhe krahasime midis studentëve të ndarë në çifte apo grupe të vogla¹⁸⁸. Për të realizuar këtë studenti mund të ndihmohet me ushtrime përkatëse: sjellim këtu si shembull një ushtrim nga libri “Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore”¹⁸⁹

Ushtrimi 1.

*Prima di leggere i testi “Le articolazioni”, e “Dentro le ossa” rifletti sul significato delle seguenti espressioni per capire meglio la lettura dei brani.*¹⁹⁰

Espressione del testo	Significato
Giunzione	Unione, connessione
Articolazione	Mezzi di unione fra due ossa
Mobilità	Caratteristica di ciò che si muove facilmente
Interosseo	Situato fra due ossa
Sfregano	Strofinano, frizionano

Ushtrimi i mësipërm bën pjesë në tipologjinë e ushtrimeve që paraprijnë leximin e tekstit dhe ndihmon studentët në përvetësimin e kuptimit të disa fjalëve të reja të gjuhës mjekësore duke lehtësuar kështu edhe kuptimin e përgjithshëm të tekstit.

Disa lloje të tjera teknikash që ndihmojnë në zbulimin e tekstit tekniko-shkencor janë për shembull vëzhgimi dhe analizimi i titullit apo i figurave që paraprijnë tekstin për të mundësuar aktivizimin tek studentët të “expectancy grammar” dhe përgatitjen e tyre për përmbajtjen e tekstit dhe një përjasje më të lehtë me të. Sjellim si shembull ushtrimin e mëposhtëm të marrë nga i njëjti libër.

Ushtrimi 2

188 Gotti M. (1992) *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*, La Nuova Italia, Firenze, f.95


189 Gjinali A. & Piri S. (2016) *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore*” Niveli B1-C1, Tekst Universitar, Maluka, Tiranë

190 Shih ushtrimin 15 f. 12



*Prima di leggere il testo guarda la foto insieme ad un compagno e immagina di cosa parla. Discutiamone.*¹⁹¹

Edhe teknikat që ndjekin leximin e tekstit janë të larmishme. Kryesisht ato fokusohen në kuptimin e përmbajtjes së tekstit dhe ndjekin një shkallë graduale të të kuptuarit, duke filluar me ushtrime me alternativa që synojnë përvetësimin më tërësor të tekstit pa hyrë në analiza të detajuara e që ndiqen nga teknika që synojnë përvetësimin e elementëve më specifikë. Një nga teknikat që mund të përdoren për përvetësimin e tekstit është edhe “transkodifikimi”¹⁹². Më tej sjellim një shembull:



Ushtrimi 3

*Trova e trascrivi il punto esatto del testo in cui si parla dell'immagine.*¹⁹³

1. _____
2. _____
3. _____

191 Shih ushtrimin 31 f. 45

192 Është një lloj teknike ushtrimi që shërben për të orientuar apo verifikuar kuptimin e një teksti gjuhësor dhe ka marrë këtë emërtim, pasi përmes tij kërkohet që një mesazh të transformohet në një kod tjetër nga ai fillestar. P.sh. Jepet një tekst i shkruar dhe kërkohet të vizatohet, pra kalohet nga një tekst gjuhësor në një pamor.

193 Gjinali A. & Piri S. (2016) *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore*” Niveli B1-C1, Tekst Universitar, Maluka, Tiranë, ushtrimi 6. f. 54

Një teknikë tjetër që mund të përdoret pas leximit për të kuptuar në mënyrë më të detajuar tekstin është procedura “cloze” ose “plotësimi i tekstit” me elementë të gjuhës tekniko-shkencore që studentët duhet të memorizojnë në procesin e mësimnxënies, p.sh:

Ushtrimi 4

Completa il seguente testo con le parole tipiche del linguaggio della medicina.¹⁹⁴

Si divide in sistema nervoso _____ e periferico. Il sistema nervoso centrale è formato dall' _____ e dal _____ spinale. L'encefalo comprende il _____, il cervelletto e il bulbo. Il midollo spinale è contenuto nella _____ vertebrale e collega l'encefalo al sistema nervoso periferico. Il sistema periferico riceve gli stimoli dagli organi di senso che sono: gli _____, la pelle, il _____, le _____, la _____.

Pasi është përvetësuar kuptimi i përgjithshëm i tekstit zhvillohen ushtrimet e fazës së analizës të cilat mund të kenë për objektivë përvetësimin e elementëve gramatikorë e kryesisht leksikorë të cilët janë karakteristikë e gjuhës tekniko-shkencore. Reflektimi rreth aspekteve gramatikorë të një teksti të gjuhës së huaj tekniko-shkencore është shumë i rëndësishëm me qëllim që studentët të njohin fenomene të natyrës morfo-sintaksore që e karakterizojnë atë, si emërzimi, të shprehurit në mënyrë të përmbledhur, përdorimi i formës pësore etj. Teknikat e përdorura në tekstet e gjuhës së huaj tekniko-shkencore kanë për qëllim përforcimin e njohurive të përvetësuar gjatë reflektimit gjuhësor dhe ripërdorimin e këtyre strukturave gramatikore në veprimtaritë profesionale të studentëve.

Ushtrimi 5

A coppie compilate la griglia in seguito, cercando di trovare i verbi che derivano dai sostantivi presenti.¹⁹⁵

Sostantivi	Verbi
Insorgenza	
Moderazione	


194 Shih ushtrimin 5 f. 54

195 Gjinali A. & Piri S. (2016) *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore*” Niveli B1-C1, Tekst Universitar, Maluka, Tiranë, ushtrimi 6, f.64

Disturbo	
Esponenziale	
Manifestazione	
Sbalzo	
Deglutizione	

Ushtrimi më sipër është ndërtuar enkas që studentët të reflektojnë rreth përdorimit të disa emrave që kanë përdorim të gjerë në fushën mjekësore.

Sikurse është përmendur edhe më lart, elementët leksikorë janë të rëndësishëm në gjuhën e huaj tekniko-shkencore dhe studentët duhet të ushtrohen me reflektimin rreth tipologjisë së leksikut që haset në një gjuhë tekniko-shkencore, me qëllim kuptimin dhe asimilimin e kriterëve pragmatike që përbëjnë atë fushë sektoriale që studentët janë duke nxënë¹⁹⁶. Teknikat që mund të përdoren për përvetësimin dhe memorizimin e leksikut të gjuhës tekniko-shkencore janë të shumëllojshme. Ato mund të ndikojnë në aktivizimin e bagazhit leksikor ekzistues i cili do të motivojë dhe ndihmojë më tej për nxënien e termave të panjohura në gjuhën e huaj. Më poshtë një shembull tjetër i marrë



nga libri “Gjuha Italiane për studentë në fushat mjekësore”¹⁹⁷

Ushtrimi 6

Ora discutiamo su alcuni traumi dell'osso. Conoscete queste parole. Cosa significano? Parliamone

Për studentët është e nevojshme të njihen edhe me mënyrat e formimit të leksikut specialistik pasi kjo tipologji analize do t'i ndihmonte ata në zbatimin e saj gjatë

196 Gotti M. (1992) *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*, La Nuova Italia, Firenze, f. 237

197 Gjinali A. & Piri S. (2016) *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore*” Niveli B1-C1, Tekst Universitar, Maluka, Tiranë, ushtrimi 1 f. 22

veprimtarive të pavarura të mësimit në fushën ku praktikohen e si rrjedhojë kuptimin dhe memorizimin më të shpejtë të leksikut përkatës.

Në këtë tekst autoret, kanë ndërtuar ushtrime të shumëllojshme për të bërë të mundur që studentët e fushave mjekësore të reflektojnë rreth formimit të termave mjekësore e të njohin vlerën e saktë të parashtesave dhe prapashtesave në atë fushë siç e ilustron edhe ushtrimi më poshtë:

Ushtrimi 7

In italiano è possibile formare degli aggettivi se si aggiungono dei suffissi ai sostantivi. Utilizzando l'elenco seguente dei suffissi, trova nel testo "Lo scheletro" gli aggettivi derivati dai sostantivi riportati nella tabella sottostante.¹⁹⁸

Suffissi: -are; -ile; -ico; -eo; -ale; ecc.

SOSTANTIVO	AGGETTIVO
------------	-----------

Asso	
------	--

Osso	
------	--

Torace	
--------	--

Scapola	
---------	--

Pelvi	
-------	--

Appendice	
-----------	--

Ushtrimi 8

QBD 3
Nxënësit e
parë që
ndjekin

muscolare	cellulare
membrana	
polmonare	cerebrale
dermico	muscolo
sistoleuterino	

Come abbiamo visto nell'attività 20 anche i prefissi intra- = "dentro" o "nell'interno", e extra- = "fuori", derivano dal latino e servono a formare nuove parole. Ora cerca nel testo "Dentro le ossa" eventuali termini con questi prefissi e spiega il significato. Poi esegui l'attività seguente a gruppi di due: forma nuove

198 Gjinali A. & Piri S. (2016) *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore* Niveli B1-C1, Tekst Universitar, Maluka, Tiranë, ushtrimi 11 f.10

parole con i due prefessi e i termini assegnati. Alla fine confrontate la vostra lista con quella degli altri gruppi.

Ushtrimi i mësipërm shërben për njohjen me parashtesat më tipike të gjuhës mjekësore dhe përvetësimin e tyre.

Gjithashtu, gjuha tekniko-shkencore karakterizohet nga përqsja zakonisht e dy fjalëve të cilat marrin një kuptim semantik të caktuar në atë gjuhë të njohura si “njësi leksikore” dhe studentët duhet të ushtrohen për njohjen e këtyre formave sintagmore si edhe përdorimin e tyre në fushën e tyre profesionale. Në tekstin e gjuhës mjekësore të sipërpërmendur autoret kanë ndërtuar shumë nga këto ushtrime pasi “njësitë leksikore”¹⁹⁹ janë shumë të shpeshta në gjuhën mjekësore. Më poshtë përcjellim një shembull:

Ushtrimi 9

*Lessico specialistico: Alcune parole assumono un significato particolare quando si trovano insieme ad altre. Questi insiemi di parole, la cui successione non può essere cambiata o mutata, si chiamano unità lessicali superiori. Ad esempio: “cintura pelvica”. Dal testo sono state riportate delle espressioni; trova quelle che sono unità lessicali superiori.*²⁰⁰

- | | | |
|-------------------|--------------------|---------------------|
| • corpo umano | • gabbia toracica | • funzione plastica |
| • scatola cranica | • scheletro assile | • parti molli |

Përfundime

Vitet e fundit edhe në Shqipëri është rritur kërkesa për mësimdhënien e gjuhës së huaj tekniko-shkencore. Nga ana tjetër tregu i botimeve nuk arrin të përmbushë nevojat e mësimdhënësve. Studiuesit sugjerojnë që mësimdhënësit të kryejnë vlerësimin e nevojave imediate të kurseve të tyre, por edhe ato të ardhme që do të implementohen nga studentët në profesionet e tyre, me qëllim organizimin e procesit didaktik, seleksionim e materialeve gjuhësore sa më të përshtatshme, didaktizimin e tyre nëse është e nevojshme si edhe përcaktimin e strategjisë së përzgjedhur për përshtatjen e tyre gjatë procesit të mësimdhënies.

Përzgjedhja e teksteve tekniko-shkencore është një proces jo i thjeshtë që kërkon përkushtim dhe njohuri. Të gjithë specialistët e fushës theksojnë rëndësinë e përdorimit të materialeve autentike të shoqëruara me ilustrime që mundësojnë kuptimin dhe

199 Shih Dardano M. (1991) *Manualetto di Linguistica Italiana*, Zanichelli Bologna, f. 239

200 Gjinali A. & Piri S. (2016) *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore*” Niveli B1-C1, Tekst Universitar, Maluka, Tiranë, ushtrimi 8 fq.9

përvetësimin e njohurive të reja, por edhe ndihmojnë për motivimin e përdoruesve të këtyre teksteve. Për të realizuar sa u tha më sipër është e rëndësishme që ushtrimet apo teknikat që do të përdoren gjatë didaktizimit të teksteve të jenë të shumëllojshme e të renditura në varësi të fazave që ndjekin njësitë didaktike. Në këtë punim janë ilustruar e shpjeguar disa ushtrime të ndërtuara enkas për tekste tekniko-shkencorë dhe që mund të merren si shembull nga mësimdhënës në krijimin e materialeve të posaçme për kursin e tyre. Ushtrimet janë të shumëllojshme, ato ndihmojnë të kuptuarit dhe aftësojnë në leximin e teksteve tekniko-shkencore, nxisin reflektimin dhe krijimin e hipotezave për njohjen e fenomeneve specifike morfo-sintaksore që karakterizojnë gjuhët tekniko-shkencore, por edhe përvetësimin e elementëve kryesisht leksikorë si karakteristikë e veçantë e këtyre gjuhëve.

BIBLIOGRAFIA:

- BALBONI, p.e. (1998), *Tecniche didattiche per l'educazione linguistica*, Utet Libreria, Torino.
- BALBONI, p.e. (2000), *Le microlingue scientifico-professionali*, Utet Libreria, Torino.
- BALBONI, p.e. (2002), *Le sfide di Babele. Insegnare le lingue nelle società complesse*, Utet Libreria, Torino.
- BALLARIN, e. (2009), *Didattica delle Microlingue*, Moduli FILIM, Dipartimento di Scienze del Linguaggio, Università degli Studi Ca' Foscari, Venezia
http://venus.unive.it/filim/materiali/accesso_gratuito/Filim_microlingue_teorìa_1.pdf
- BALLARIN, e. & BEGOTTI p. (2006-2007), *Didattica delle microlingue*, broshurë për ciklin e VIII të Masterit Itals, Dipartimento di Scienze del Linguaggio, Università degli Studi Ca' Foscari Venezia
- BEGOTTI p. (2003), *La didattica delle microlingue*, në Dolci R. & Celentin P. *La formazione di base del docente di italiano per stranieri* (botimi i dytë), Bonacci, Romë, f. 227-240
- BONETTO e. & ENNIS J.M. & UNTERKOFER d. (2018), *Teaching languages for specific and academic purposes in higher education: English, Deutsch, Italiano*, Proceeding, Bozen, Bolzano University.
- CINI L. (2001), *Programmazione e curricolo* në Diadori P. (a cura di) *Insegnare italiano a stranieri*, Le Monnier, Firenze, f. 87-97
- COONAN c.m. (2002), *La lingua straniera veicolare* UTET Libreria, Torino.
- DALOISIO m. (2011), *Introduzione alla didattica delle lingue moderne. Una prospettiva interdisciplinare*, Aracne, Roma.
- DANESI m. & DIADORI P. & SEMPLICI s. (2018), *Tecniche didattiche per la seconda lingua. Strategie e strumenti anche in contesti CLIL*, Carocci, Romë.
- GHINALI A. & PIRI s. (2016), *Gjuha italiane për studentë në fushat mjekësore, Niveli B1-C1*, Tekst Universitar, Botime Maluka, Tiranë.
- GOTTI m. (1992), *Testi specialistici in corsi di lingue straniere*, La Nuova Italia, Firenze.
- LORENZI F. (2008), *Apprendere le lingue straniere. Interferenza e microlingue scientifico-professionali*, Guerra Edizioni, Perugia.
- PEPPOLLONI d. (2018), *Glottodidattica e metalinguaggio. La consapevolezza metalinguistica come strumento per l'acquisizione delle lingue straniere*, Guerra edizioni, Perugia.
- PIERINI p. (1981), *L'analisi dei bisogni linguistici: teoria e pratica* në Ciliberti A. (a cura di) *L'insegnamento linguistico "per scopi speciali"*, Zanichelli, Bologna, f. 58-84.

-
- PIRI S. GJINALI A. (2013), "L'insegnamento dell'italiano microlinguistico all'università: la necessità di nuovi percorsi mirati con integrazione di materiali autentici e supporti multimediali", Vol 6/2 "Lingustic and Communicative Performance Journal" LCPJ Publishing, Tiranë, ISSN 2073-5138, f.12-27.
- SERRAGIOTTO G. (2003), *C.L.I.L. Apprendere insieme una lingua e contenuti non linguistici*, Guerra-Soleil, Perugia.
- WILLIAMS R. (1983), *Communicative Reading* në Jonson and Porter (eds:) f. 171-188.

RËNDËSIA E DOSJES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE NË GJUHË TË HUAJ

Dr. Emilda Roseni

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës
Email: m_roseni@yahoo.com

Dr. Miranda Enesi

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës
Email: mirashahini@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Debati mbi zgjedhjen e mjeteve të duhura të vlerësimit dhe testimit synon të ndryshojë e përmirësojë si teknikat vlerësuese të mësuesit, ashtu edhe vetë politikat e vlerësimit të një shteti. Në Shqipëri nuk i është dhënë rëndësia e duhur vlerësimit të nxënësit edhe pse në botë ka debate të shumta lidhur me këtë problematikë. Për të risjellë këtë çështje jetike në fokus të sistemit të mësimdhënies është kryer ky studim mbi rëndësinë që paraqet dosja profesionale për vlerësimin e nxënësit në gjuhë të huaj. Vlerësimi i aftësive komunikuese në mënyrë të standardizuar është shumë më tepër kompleks krahasuar me vlerësimin e korrektesës gramatikore apo leksikore. Pavarësisht kësaj, shumë studiues dhe ekspertë të mësimdhënies janë duke kërkuar, gjetur e hartuar mënyra të reja vlerësimi. Këto mënyra të reja synojnë përfshirjen e teknikave të vlerësimit të aftësive komunikuese. Përpos të gjithave, objektivi final i këtij ndryshimi mbetet të komunikuarit në mënyrë efikase, qoftë ky komunikim në të shkruar dhe të lexuar apo dhe në të folur e dëgjuar. Rrjedhimisht, të gjitha aftësitë gjuhësore kanë nevojë të vlerësohen me kujdes dhe përpikëri në mënyrë të tillë që nxënësit të arrijnë t'i përmirësojnë këto aftësi në të ardhmen. Kjo dosje profesionale merr përsipër të prezantojë çështje dhe përvoja që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe testimin e njohurive të gjuhës së huaj nga nxënësit, të zbulojë problematikat e hasura nga mësuesit gjatë procesit të vlerësimit të njohurive të nxënësve të tyre, të pasqyrojë problematikat e hasura nga vetë nxënësit gjatë matjes dhe vlerësimit të aftësive të tyre nga mësuesit dhe nga njëri-tjetri si dhe të ofrojë rekomandime mbi mënyrat e teknikat më të mira dhe të drejta të testimit e vlerësimit të njohurive gjuhësore në gjuhën e huaj në shkollat shqiptare. Fjalët çelës: gjuhë e huaj, mësues, nxënës, testim, vlerësim

ABSTRACT


The debate over the choice of appropriate assessment and testing tools aims to change and improve both the teacher's assessment techniques and the state's own assessment policies. In Albania, the importance of student assessment has not been given due importance, although there are many debates in the world regarding this issue. In order to bring this vital issue back to the focus of the teaching system, this study was conducted on the importance of the professional dossier for student assessment in foreign languages. Evaluating standardized communication

skills is much more complex compared to evaluating grammatical or lexical correctness. Despite this, many researchers and teaching experts are looking for, finding and designing new ways of assessment. These new ways aim to incorporate communication skills assessment techniques. After all, the ultimate goal of this change remains to communicate effectively, whether this communication is in writing and reading or in speaking and listening. Consequently, all language skills need to be carefully and accurately assessed in such a way that students are able to improve these skills in the future. This professional file undertakes to present issues and experiences related to the assessment and testing of foreign language knowledge by students, to discover the problems encountered by teachers during the process of assessing the knowledge of their students, to reflect the problems encountered by the students themselves when measuring and evaluating their skills by teachers and each other and to provide recommendations on the best and right ways and techniques of testing and evaluating language skills in the foreign language in Albanian schools.

Keywords: assessment, foreign language, students, teachers, testing

Hyrje

Vlerësimi sipas Krajas (2002), është procesi i matjes së performancës dhe i përparimit apo progresit të bërë, i nxjerrjes në pah të vlerave të punës sonë, të dijeve apo aftësive njerëzore dhe intelektuale nga i cili secili prej nesh ndihet më mirë apo më keq, jo vetëm në funksion të kërkimit të këtij vlerësimi për efekte shkollimi apo pune, por edhe në funksion të rritjes së vlerësimit për veten, qëndrimit mes një grupi shoqëror të caktuar dhe pozicionimit brenda këtij grupi. Si i tillë ai është mjaft kompleks dhe, mbi të gjitha, i rëndësishëm, duke merituar vëmendjen më të veçantë të të gjithëve ne.




Vlerësimi konsiderohet si procesi më delikat i mësimdhënies, pasi në shumë raste ai konsiderohet edhe si subjektiv. Sfida e shkollës shqiptare është që ta nxjerrë vlerësimin nga konturet subjektivistike dhe ta klasifikojë atë si një element të studimit dhe të vendosjes në një standard të caktuar, në të cilin përvoja e huaj nuk mungon (Pasku, 2012).

Shpeshherë vihet re se fjalët testim dhe vlerësim përdoren në mënyrë sinonimike,



gjë e cila nuk është aspak e drejtë. Brown (2007) pohon se “Një test është një instrument i matjes së njohurive apo aftësive të një individi në një fushë të caktuar.” Testet janë instrumente specifike të cilat hartohen me mjaft kujdes dhe që nevojitet të kenë një rubrikë të detajuar pikësimi, si edhe janë procedura administrative të cilat zënë një periudhë kohe të caktuar në një plan mësimor. Sipas Brown, një mësues i mirë nuk



rresht kurrë së vlerësuar nxënësit e tij, qofshin këto vlerësime të rastësishme apo të qëllimshme.

Sipas Musait (2002) “rreziku i parë dhe më serioz është kur nxënësit shohin se vlerësimi që u bëhet përparimit të tyre është më i ulët se ai i shokëve që kanë nivel të njëjtë me ta, ose është më i ulët se një standard i caktuar i konsideruar si i arritshëm prej tyre. Për këtë ata mund të dëshpërohen dhe dekurajohen”. Duke qenë se arbitrariteti është një karakteristikë e praktikave të gabuara të vlerësimit, atëherë njohja dhe eliminimi i këtij faktori mbetet një çështje thelbësore.

Materialet dhe Metodat

Qëllimi i punimit: dosja profesionale do t’i shërbejë në radhë të parë praktikës së mësimeve, për t’u njohur më mirë me rolin dhe metodikën e vlerësimit dhe testimit në shkollat e ciklit 9-vjeçar, duke gjetur mënyra për të shmangur problematikat që dalin gjatë vlerësimit të nxënësve. Si rrjedhojë, ky punim gjen përdorim si nga mësuesit e gjuhës së huaj, ashtu edhe nga studentët që studiojnë për t’u diplomuar si mësues të ardhshëm në gjuhë të huaj.

Analizë pyetësorësh drejtuar nxënësve

Për të parë dobësitë në procesin e vlerësimit në shkollën Ali Demi në qytetin e Tiranës, u realizua një pyetësor i shkurtër me nxënësit e kësaj shkolle. Qëllimi i këtij pyetësori ishte të vlerësohej informacioni që kanë nxënësit për politikat e vlerësimit të tyre. Rreth 100 nxënësve, nga klasa e 3-të në të 9-tën, iu shpërnda një pyetësor. Pyetësori u plotësua në klasë dhe u dorëzua po aty.

Pyetjes së parë: *A keni informacion për stimujt që marrin nxënësit e talentuar?*, nxënësit iu përgjigjën si më poshtë: rreth 50% e tyre kishin informacion, 30% kishin disi informacion lidhur me këtë pyetje dhe rreth 20% nuk kishin fare informacion.

Pyetja e dytë kërkonte nga nxënësit të shpreheshin se *me çfarë do të donin të vlerësoheshin?* Nga grafiku më poshtë vihet re se shumica e nxënësve rreth 60% janë përgjigjur se do të donin të vlerësoheshin me vlera morale dhe rreth 40% me vlera materiale.

Pyetjes së tretë nëse *nxënësit janë të informuar rreth zbatimit të politikave të vlerësimit* u përgjigjën se nuk dinë asgjë lidhur me këtë rreth 60%. Kjo nxit nevojën e rritjes së informimit, që do të trajtohet më vonë në këtë punim.

Rezultatet e marra nga pyetja e katërt lidhur me transparencën e vlerësimit të nxënësve tregojnë se 30% e tyre pohojnë se kanë konflikt me mësuesin lidhur me mënyrën e vlerësimit, 50% e tyre kanë disi konflikt dhe 20% nuk kanë fare konflikt.

Në pyetjen nr. 5 vihet re se në 60% të rasteve arsyeja e konflikteve të tyre me mësuesit është vlerësimi i padrejtë i bërë nga mësuesit, të cilët janë tepër kërkuar dhe nuk i vlerësojnë në mënyrë të drejtë dijet e nxënësve të tyre. Ndërsa një përqindje shqetësuese e nxënësve të anketuar rreth 30% e tyre shprehen se arsyeja e konflikteve të tyre me mësuesit janë fjalët me karakter ofendues që përdorin mësuesit ndaj tyre. Ky është një fenomen tepër shqetësues sepse tregon që mësuesit e shkollave tona nuk janë të trajnuar mjaftueshëm që të dinë se si të sillen në përputhje me karakterin e fëmijëve. 10% e nxënësve të anketuar shprehen se arsyeja e konflikteve të tyre me mësuesit është favorizimi i padrejtë që mësuesit u bëjnë nxënësve të tjerë, sipas njohjeve dhe miqësive që kanë mësuesit me prindërit ose me të afërmit e këtyre nxënësve.

Një nga anët e forta në shkollën Ali Demi sa i përket politikave të vlerësimit të nxënësve është se nxënësve u jepet hapësira që në fund të orës të vlerësojnë njëri-tjetrin.

Gjithashtu testet janë pikë e fortë, sepse janë të hartuara sipas standardit dhe objektivave të lëndëve të caktuara dhe nxënësit dalin mirë dhe janë të kënaqur nga vlerësimi pasi kjo pasqyrohet edhe nga fletët e testime të tyre. Një nga arritjet e tjera është portofoli i nxënësve. Nxënësit mbajnë dosje personale në lëndën e gjuhës së huaj. Atyre iu jepen detyra sipas temave dhe në fund të semestrit vlerësohet portofoli. Projektet i vendosin në punë nxënësit dhe i stimulojnë ata për të paraqitur punime dinjitoze. Ata janë të kënaqur nga vlerësimet dhe duke krahasuar dosjet me njëri – tjetrin arrijnë të vetëvlerësohen.

Shkolla 9-vjeçare “Ali Demi” ka një bashkëpunim të mirë me komunitetin dhe vlerësohet të jetë shkollë e hapur që ka komunikim të vazhdueshëm si me prindërit, ashtu edhe me grupe të tjera. Katër vitet e fundit nuk ka asnjë rast të braktisjes së shkollës nga nxënësit. Ndërkohë që vlerësohet se teknikat e mësimdhënies janë bashkëkohore dhe kjo tregohet edhe nga rritja e kërkesave për t’u regjistruar në këtë shkollë. Liria e të menduarit, të krijuarit, të shprehurit është mënyra më e mirë për të arritur synimet edhe në aspektin shkencor. Në këtë anë, shkolla “Ali Demi” përdor strukturën e re kurrikulare të miratuar nga MASR. Programet dhe realizimi i tyre është konform gjithë udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. Për të siguruar një vlerësim sa më objektiv mësuesi/ja në shkollën Ali Demi ndjek këtë skemë:

Kriteri	Pikët
Cilësia, zhvillimi dhe organizimi i idesë së esesë	1-5 pikë
Stili, fjalori përdorur, individualiteti	1-3 pikë
Struktura e fjalisë	1-3 pikë
Struktura e pikësimit	1-2 pikë
Drejrtshkrimi	1-2 pikë

Qëllimi i vlerësimit

1. Vlerësimi para së gjithash ka për qëllim të nxënës të nxënësve, t’i nxisë ata të mësojnë më shumë. - Vlerësimi shërben që ta nxisë nxënësin të mësojë dhe t’i japë udhëzime se si të mësojë në mënyrë që të përmirësojë arritjet në mësim dhe jashtë tij. Vlerësimi nuk shërben vetëm që të vërtetojë se sa ka arritur nxënësi të mësojë.
2. Vlerësimi siguron informacione të plota për arritjet e nxënësit. - Vlerësimi siguron edhe informacione për atë që nxënësit e dinë dhe se çka mund të bëjnë me atë që dinë; - Me vlerësim vlerësohen dituritë dhe aftësitë e nxënësve, si dhe vlerat, qëndrimet dhe shprehjet e tyre, që ndikojnë edhe në suksesin në shkollë dhe në arritjet jashtë shkollës; - Me vlerësim merren informacione edhe për anët e forta dhe ato të dobëta

të nxënësve, që pastaj përdoren për të siguruar përparimin e nxënësve në mësim.

3. Vlerësimi është pjesë përbërëse e procesit mësimor. - Ekziston lidhje e qartë ndërmjet qëllimeve dhe përmbajtjeve të të nxënësve dhe vlerësimit. - Mësimdhënia, të nxënësve dhe vlerësimi janë procese të ndërthurura dhe sigurojnë koherencë në mësim. - Nga qëllimet dhe përmbajtjet mësimore varet çka do të vlerësohet. Nga rezultati i vlerësimit varet si do të zhvillohet mësimi dhe drejt cilave qëllime synon të ecë ai;
- Nxënësi ka rol aktiv në procesin e vlerësimit.
4. Vlerësimi bazohet në përdorimin e shumë metodave të ndryshme. - Përdorimi i shumë metodave të ndryshme mundëson që të zvogëlohen dobësitë dhe kufizimet e secilës metode të veçantë; - Kur përdoren shumë metoda të ndryshme, vlerësimi merr parasysh stilet e ndryshme të të nxënësve të nxënësve.
5. Vlerësimi është proces i vazhdueshëm. - Gjatë vlerësimit kontrollohet përparimi i arritjeve të nxënësve në bazë të asaj sesi orientohen nxënësit drejt qëllimeve të parashtruara në mësim.
6. Vlerësimi është i drejtë. - Vlerësimi i drejtë i referohet paanshmërisë gjatë zbatimit të vlerësimit, gjatë vlerësimit të arritjeve dhe gjatë interpretimit dhe përdorimit të rezultateve.
- Vlerësimi nuk favorizon nxënësin në bazë të prejardhjes, gjinisë dhe as në bazë të përvojave të tyre të mëparshme me arsimtarë dhe/ose me metodën e vlerësimit.
7. Vlerësimi është transparent. - Nxënësit e dinë se cilat janë qëllimet e të nxënësve, cilat janë standardet që priten prej tyre t'i arrijnë dhe si do të vlerësohet arritja e nxënësve (ajo që duhet të mësojnë, si dhe kur do të vlerësohen).
- Nxënësit dhe prindërit kanë qasje në vlerësim (në metodat që do të përdoren dhe në rezultatet e përdorimit të tyre).
8. Vlerësimi është i vlefshëm dhe i sigurt.
- Me vlerësimin merren informacione që janë të rëndësishme për qëllimet dhe përmbajtjet e vlerësimit.
- Në interpretimin e rezultateve të vlerësimit nuk bëjnë pjesë gjykimet për sjelljen, aftësitë dhe shkathtësitë e nxënësve, që nuk janë objekt i vlerësimit konkret.

Vlerësimi i nxënësve - Analiza SWOT

<i>Vlerat</i> Vlerësimi ka avantazhe: 1. Ndhmon nxënësin të përparojë në formimin e tij 2. Për t'i vlerësuar njohuritë dhe për t'i bërë ato të mjaftueshme për vazhdimin e shkollimit të nxënësit 3. Për të siguruar një përdorim të drejtë të vlerësimit të nxënësve dhe një sistem shkollor cilësor	<i>Dobësitë</i> Vlerësimi ka disa disavantazhe 1. Gabimet e vlerësimit janë gabime të gjykimit, që bën sistematikisht një njeri kur vlerëson një tjetër. 2. Sa më i ndërgjegjshëm të jesh për gabimet, aq më e madhe është mundësia për t'i korrigjuar ato, por korrigjimi është një proces shumë i ndërlikuar 3. Ndër gabimet më kryesore të vlerësimit përmendim: - a- Efekti i kontrastit - b- Përshtypja e parë - c- Gabimi qendror - d- Gabimi i ekstremeve
<i>Mundësitë</i> 1. Vlerësimi duhet të jetë pjesë përbërëse e planit të zhvillimit të shkollës dhe e planit vjetor të shkollës. - Secila shkollë duhet të ketë një politikë të shkruar për vlerësimin në nivel shkolle (d.m.th, që të mbulojë edhe Vlerësimin Sumativ, edhe Vlerësimin Formativ, si dhe Kodin e Etikës për vlerësim. - Politika e shkollës për vlerësim duhet të jetë në përputhje me Kornizën e Kurrikulës, parimet dhe standardet e përcaktuara nga MASH për vlerësimin në nivel shkolle. - Politika e vlerësimit duhet të përfshijë: një përzgjedhje të metodave të vlerësimit si dhe zhvillimin e instrumenteve; realizimin e vlerësimeve; klasifikimin dhe dhënien e informacionit që del nga gjetjet e procesit të vlerësimit, me rezultate të ndara edhe në baza gjinore. - Secila shkollë duhet rregullisht ta kryejë monitorimin për kapacitetet dhe praktikën e saj të vlerësimit, në mënyrë që të çojë drejt një plan veprimi për të forcuar vlerësimin në përputhje me politikën e shkollës.	<i>Rreziqet e vlerësimit</i> Ka mësues që vlerësojnë sipas disa kritereve, të cilat janë thjesht të tyre dhe nuk kanë parasysh objektivat e programit lëndor. Për rrjedhojë, ndodh që, te mësues të ndryshëm, e njëjta notë t'u takojë nxënësve me njohuri dhe aftësi tepër të ndryshme. Çdo vlerësim bazohet në objektivat e programit. Kjo do të thotë se çdo provim, me shkrim ose me gojë, apo me demonstrim praktik, ka për qëllim të matë se sa është përbushur një objektivi i caktuar ose sa janë përbushur disa objektiva. Objektivat e programit, janë elementi kryesor i gjithë veprimtarisë vlerësuese të mësuesit. Ka mësues që u japin nxënësve kërkesa tepër të vështira. Teksti i nxënësit nuk i ka këto kërkesa, por ata i gjejnë zakonisht në botime të hershme, mbase qysh nga koha kur kanë qenë studentë ose edhe në botime të reja të specializuara për nxënësit e rrallë. Kjo prirje e vjetruar haset jo pak dhe i dëmton nxënësit aq sa ata shkurohen, u zbehet vullneti dhe u vështirësohet lënda.

Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetësi (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;

- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i mbështetur në kritere dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar me kërkesa (pyetje):
 - e përgjigje alternative të shumta;
 - me përgjigje të hapura të shkurtra;
 - me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

si edhe çdo instrument tjetër që mësime dhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Llojet më të përdorshme të vlerësimit

Vlerësimi diagnostikues: përmes këtij vlerësimi identifikohen vështirësitë e të nxënësit ose problemet që kanë të bëjnë me të nxënësit. Po ashtu përmes vlerësimit diagnostikues identifikohen anët e dobëta dhe të forta të mësime dhënies, përcaktohen shkaqet e ndryshme të problemeve në të nxënë etj., në mënyrë që të merren masat për përmirësimin dhe avancimin e saj dhe për formulimin e planit për veprim në ndihmë të nxënësve (Pasku, 2012).

Vlerësimi formues: përmes këtij vlerësimi synojmë të identifikojmë gabimet, të metat dhe vështirësitë në punën me nxënësit, me qëllim që t'ju japim ndihmë. Vlerësimi formues mbikëqyr ecurinë, procesin, përparimin e nxënësve, me qëllim që të sjellë përmirësime. Kontrollon përparimin e nxënësve në nxënësve gjatë procesit mësimor, pra kontrollon shkallën e zotërimit të objektivave udhëzues.

Vlerësimi përmbledhës: përcakton arritjet në përfundim të vitit mësimor, në përfundim të programit mësimor. Shërben për të marrë vendime për nxënësit, mësime dhënësit, programet etj. Ka për qëllim vlerësimin me notë dhe certifikimin e nxënësve, gjithashtu siguron informata për të gjykuar përvetësimin e objektivave të lëndës dhe efektshmërisë së programit mësimor.

Vetëvlerësimi: është proces gjatë të cilit institucioni, shkolla, mësime dhënësi, nxënësi mbledhin informacion për veten e tyre dhe bëjnë gjykimin e vlerave të tyre. Këtë vlerësim nxënësi e realizon duke krahasuar rezultatet e veta me standardet e arritjeve. Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit kanë mundësi që në lidhje me qëllimet e caktuara të mësimit të vlerësojnë veten, arritjet e tyre. Vetëvlerësimi i bazuar në kritere të drejta krijon bazë për motivimin, përmirësimin dhe çuarjen më tej të procesit të të nxënësit te nxënësit (QTKA, 2003).

Cilëndo metodë që mësuesit përzgjedhin të përdorin, ata duhet të reflektojnë së bashku me nxënësit e tyre mbi punën e kryer, të zhvillojnë aftësinë e nxënësve për të parë me sy kritik përparimin e tyre vetjak, si dhe përparimin e nxënësve të tjerë në klasë. Është thelbësore të theksohet se nuk është portofoli në vetvete mjeti që sjell zhvillimin

dhe përparimin, por janë rrugët dhe mënyrat sesi nxënësit dhe mësuesit e përdorin atë në klasë që sjell një analizë kritike të punës së bërë dhe të arritjes së synimeve e qëllimeve të vëna nga të dyja palët (Brown, 2007).

Vlerësimi tradicional / Vlerësimi alternativ

Marrja në analizë e vlerësimit tradicional dhe atij alternativ kërkon një hapësirë shumë të madhe kohore dhe fizike, por realisht një krahasim i këtyre dy grupimeve të mëdha të vlerësimit është në fakt, siç do të pasqyrohet dhe më tej, reflektim i ndryshimeve të mëdha në vetë sistemin arsimor dhe kryesisht në metodat e përdorura në mësimdhënien e gjuhës shqipe.

Fatkeqësisht, akoma edhe sot, në shkollat tona nocioni i “vlerësimit” mbart në vetvete një vizion të testeve, provimeve apo dhe të një liste të gjatë me nota. Të gjitha këto konsiderohen shumë të rëndësishme dhe përgjithësisht mendohet se masin në mënyrë objektive, të saktë dhe të besueshme arritjet e nxënësve.

“Provimet janë një nga format e kontrollit përfundimtar të dijes së nxënësve që zhvillohen në fund të vitit mësimor. Ato kanë për qëllim që të evidentojnë gjendjen reale të nivelit të dijenive, për çdo nxënës, të përcaktojnë shkallën e përgatitjes për të vijuar më tej në një kategori shkolle më të lartë apo për t’u sistemuar në punë” (Didaktika, 1986).

Ky sistem ka përparësi të shumta për sa i takon lehtësive në administrim, arrin të krahasojë lehtësisht individët (vlerësim i bazuar në normë) dhe që të gjithë e dine se një notë 9 është më e mirë se një notë 7. Në këtë mënyrë ofrohet në mënyrë efikase “klasifikimi i atyre, të cilët qëndrojnë në majë, në mes apo në fund, duke i drejtuar ata drejt një pozicionimi të caktuar në shoqëri” (Moon & Mayes, 1995).

Por sa real është ky vlerësim dhe kjo notë? A është bërë vlerësimi me notë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë? A do të bënte një mësues tjetër, apo i njëjti mësues, por në një ditë tjetër, të njëjtin vlerësim për të njëjtin provim? A duhet të jetë qëllimi i vlerësimit përzgjedhja dhe renditja e nxënësve apo duhet vlerësimi të luajë një rol edukues dhe konstruktiv? Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe e shumë të tjerave të ngjashme me këto, gjatë këtyre 3 dhjetëvjeçarëve të fundit në botë dhe këtij dhjetëvjeçari të fundit në Shqipëri, kanë sjellë ndryshime dramatike në mënyrën e perceptimit të vlerësimit dhe aplikimit të tij në praktikë. Testet tradicionale ndryshojnë nga vlerësimi alternativ pasi “nxënësit vlerësohen mbi atë çka ata integrojnë dhe prodhojnë më shumë sesa mbi atë çka ata janë të aftë të kujtojnë dhe riprodhojnë” (Huerta-Macias, 1995). Vlerësimi alternativ është një trend i ri në mjedisin mësimor shqiptar. Gjithnjë e më tepër në këto mjedise është duke u folur për portofola, ditarë, konferenca, vëzhgime etj. dhe interesi si i nxënësve, ashtu edhe i mësuesve në këto alternative vlerësimi është gjithnjë e në rritje. Arsyeja kryesore e këtij interesimi vjen si pasojë e faktit se këto lloj vlerësimesh ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga vlerësimi tradicional madje shumë prej tyre

motivojnë punën dhe përparimin e nxënësve në të nxënit e tyre.

Përfundime

Në shkollën 9-vjeçare Ali Demi, në qytetin e Tiranës, një nga problematikat e hasura gjatë vlerësimit të nxënësve është vlerësimi i eseve në gjuhë të huaj, kryesisht i klasave të 9-ta. Edhe nxënësit në këtë pikë kanë më shumë pakënaqësi pasi mendojnë se nuk janë trajtuar njësoj me nxënësit e tjerë, ose nuk kanë marrë pikët e duhura. Në momentin e vlerësimit të një eseje mësuesi duhet të hartojë një model përgjigje. Gjithashtu është mirë që ta vlerësojë esenë pa parë emrin e nxënësit e të jetë i kujdesshëm nëse po zbaton të njëjtat kritere vlerësimi për të gjithë.

Një tjetër pikë e dobët është diktimi në ciklin fillor ku i është lënë shumë pak hapësirë rubrikës së diktimit. Kështu, hapësira nuk është e mjaftueshme për nxënësit pasi ata kanë shumë probleme me drejtshkrimin në gjuhë të huaj.

Një problem tjetër është vlerësimi i detyrave të shtëpisë, pasi detyrat mund të realizohen por nuk kanë paraqitjen apo përmbajtjen e duhur dhe në të shumtën e rasteve janë të realizuara nga më të mëdhenjtë.

Një dobësi tjetër e vlerësimit është edhe vlerësimi me gojë. Pakënaqësitë më të mëdha të nxënësve shfaqen në vlerësimin me gojë. Kështu vlerësimi me gojë nuk ka një standard dhe nxënësit nuk janë të vetëdijshëm për mënyrën e vlerësimit. Për këtë arsye shpesh dëgjojmë pse këtë notë apo tjetrën. Kështu lind nevoja për të krijuar një standard për vlerësimin me gojë dhe kjo t'i prezantohet nxënësve. Po ashtu një mënyrë për të krijuar transparencë në vlerësim është duke vendosur nxënësit në rolin e mësuesit dhe duke u dhënë atyre liri të vlerësojnë njëri – tjetrin.

BIBLIOGRAFIA:

BROWN, h. (2007), *Teaching by Principles "An interactive Approach to Language Pedagogy"*. Pearson Longman.

HUERTA-MACIAS, A. (1995), *Alternative assessment: Responses to commonly asked questions*. TESOL Journal, no. 5.

KATEDRA e pedagogjisë dhe e psikologjisë në Bashkëpunim me INSTITUTIN e studimeve pedagogjike (1986), *Didaktika*, Tiranë: Shtypshkronja "Mihal Duri".

KRAJA, m. (2002), *Pedagogjia*, botim i Shtëpisë Botuese të Librit Universitar, Tiranë.

MOON, B. & MAYES, A. (1995), *Teaching and Learning in the Secondary School*. Routledge London: The Open University.

MUSAI, B. (2002), *Metodologji e mësimdhënies*. Pegi, Tiranë.

PASKU, v. (2012), *Vlerësimi, monitorimi dhe supervizioni në arsim*. Gurten, Tiranë.

QTKA. (2003), *Mësimdhënia me në qendër nxënësin*. Shtëpia botuese e Librit Universitar, Tiranë.

VENDI I GREQIZMAVE NË TERMINOLOGJINË SHKENCORE

Dr. Antela Voulis

E-mail: antelavoulis@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Greqishtja është një gjuhë që gjithmonë i ka dhënë njerëzimit në shkencë, kulturë dhe art. Terminologjia e saj zbatohet kudo, nga mikro te makro-kozmosi, nga filozofia te ekonomia. Ne me të vërtetë mund të përkthejmë tekste të ngarkuara me terma shkencorë grekë, por ose do t'i perifrarojmë në gjuhën tonë (ato jo të ngulitura mirë në shqipe), gjë që do të çonte në shtrirjen ose zgjerimin e tekstit origjinal, ose do t'i lëmë termat siç janë. Në çdo përkthim, është mirë që përkthyesi të mbajë parasysh publikun të cilit i drejtohet. Një publik i specializuar në një fushë të veçantë e ka të vështirë të pranojë një përkthim vulgar, ashtu si masa e zakonshme (populli) e ka shumë të vështirë, në mos të pamundur, të pranojë ose të kuptojë një përkthim tejet teknik. Në këtë artikull nxjerrim në pah probleme të përkthimit të termave grekë në gjuhën shqipe. Si korpus gjuhësor na ka shërbyer ligjëratat e ekonomistit dhe politikanit të madh grek z. Ksenofon Zolotas, ligjëratë të cilën e ka mbajtur më 2.10.1959 në Nju-Jork para Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim. Duke qenë se kjo ligjëratë e rrallë, e cila patjetër që mund të ketë hyrë në analet e gjuhësisë, ekonomisë e diplomacisë greke, na ra në dorë, ne e kemi sjellë në shqipe në dy variante: përkthimi i parë i qëndron më pranë origjinalit (tekst i kuptueshëm vetëm nga specialistët), ndërsa i dyti mëton t'i përshtatet pritshmërive të një publiku sa më të gjerë. Në fund do të tregojmë përparësitë e secilit variant përkthimi.

Fjalët çelës: terminologji, terma shkencorë, përkthim, gjuhë

ABSTRACT

Greek is a language that has always given humanity in science, culture and art. Its terminology applies everywhere, from the micro to the macro-cosmos, from philosophy to economics. We can really translate texts loaded with Greek scientific terms but either we will paraphrase them in our own language (those not well embedded in Albanian), which would lead to extension or expansion of the original text, or we shall leave the terms as they are. In any translation, the translator is good at keeping in mind the audience s/he is addressing. A public specializing in a particular field finds it difficult to accept a vulgar translation, just as the ordinary mass (the people) find it very difficult, if not impossible, to accept or understand a highly technical translation. This article highlights the problems of translating Greek terms into Albanian. The lecture of the great Greek economist and politician Mr. Ksenofon Xenophon served us as a linguistic corpus, lecture which he held on November 2, 1959 in New York before the International Bank for Reconstruction and Development. Since this rare lecture, which may have entered the annals of Greek linguistics, economics and diplomacy, has come to our disposal, we have brought it into Albanian in two variants: The first translation is closer to the original (text only understood by specialists!), While the second tends to fit the expectations of a wider audience. At the end we show the advantages of each translation variant.

Keywords: language, scientific terms, terminology, translation

Hyrje

Sot shumë lëmenj të shkencës e të teknikës pasurohen me terma të rinj, por nuk duhet harruar që bazën e tyre e kanë tek gjuhët e antikitetit. Bëhet fjalë për greqishten e vjetër dhe latinishten. Në thuajse çdo pjesë të botës ka njerëz të arsimuar që kanë njohuri të gjuhës greke. Në shumë vende të botës, edhe në ditët e sotme greqishtja mësohet si gjuhë e dytë nëpër shkolla dhe universitete. Universaliteti i greqishtes provohet edhe nga fakti se një material i një fushe shkencore në një gjuhë të huaj mund të lexohet më me lehtësi, sesa një material tjetër në të njëjtën gjuhë që flet për një temë të përgjithshme. Arsyeja për këtë është se shumë fjalë të përdorura nga shkencëtarët në vende të ndryshme të botës kanë një burim të përbashkët, greqishten. Terminologjia shkencore ka karakter të theksuar ndërkombëtar, aq sa disa pretendojnë se ajo është aq afër të qenit një gjuhë pothuajse ndërkombëtare.²⁰¹

Dihet tashmë se në fusha të ndryshme të shkencës, fjala vjen në filozofi, në mjekësi, shkenca të natyrës hasim gjithmonë terma, koncepte, nocione, fjalë të cilat janë me burim nga greqishtja. Për ta bërë bindës shtjellimin tonë, do të sjellim një shembull të rrallë, të qenësishëm se si mund të ligjërohet në njërin prej gjuhëve më të mëdha, siç është anglishtja duke përdorur kryesisht fjalë me burim nga greqishtja. Dhe kjo nuk ndodh sot, por 60 vjet më parë në Nju-Jork.

Ligjërata e mëposhtme, edhe pse është në atë formë me vetëdije të plotë të autorit, dëshmon se sa e pranishme është fjala greke në gjuhë të ndryshme të botës.

Kemi marrë në shqyrtim ligjëratën e thukët të ekonomistit të famshëm grek Ksenofon Zolotas²⁰², mjeshtër i rrallë i përdorimit të fjalës greke dhe termave grekë në rrafsh ndërkombëtar dhe e kemi sjellë në shqipe.

Ligjërata e Ksenofon Zolotas para Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim më 2 tetor 1959, në Nju-Jork

Ekonomisti grek Z. Zolotas, më 2 tetor 1959, gjatë një mbledhjeje në BNRZH në Nju-Jork (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim), mbajti një fjalim, i cili shquhet për përdorim, pothuajse nga fillimi në fund, të fjalëve me burim grek. Ka

201 Oscar E. Nybakken: Greek and latin in scientific terminology, The Iowa State University Press, 1979, f. 28.

202 Ksenofon Zolotas (Ξενοφών Ζολώτας) lindi në Athinë, më 26 mars 1904 dhe vdiq më 11 qershor 2004, po në Athinë. Qe pasardhës i një familjeje të pasur argjendarësh me origjinë nga Rusia. Zolotasi shquhej si ekonomist dhe politikan i madh grek, i cili arriti gjer në postin e kryeministrit të Greqisë në vitet 1989-1990. Zolotasi ka qenë një mbrojtës i paepur dhe i flakët i gjuhës greke gjatë gjithë jetës, sidomos kur ushtronte detyrën e guvernatorit të Bankës së Greqisë dhe atë të administratorit të Borxhit publik grek. Gjatë mbledhjeve të niveleve të larta, asambleve të Bankës Botërore etj. shkëlqente me aftësitë e tij ligjëruese sa në lidhje me profesionin, aq edhe në lidhje me rëndësinë që i jepte përdorimit të termave grekë.

qenë një fjalim (jo i vetmi), i cili i tregon mbarë botës, sidomos gjuhëve të mëdha e të zhvilluara, se në fjalorin e tyre kanë zënë vend shumë fjalë me origjinë greke.

Sipas tij mund të “flitet greqisht” në shumë gjuhë të botës. Po sjellim një nga fjalimet e tij lidhur me këtë çështje. Sigurisht, ka qenë fjalim me vetëdije të plotë disi i qëllimshëm, i stilit të lartë e tejet të përzgjedhur, i cili nuk mund të kuptohet lehtë nga njerëzit e zakonshëm apo bashkatdhetarët e tij grekë. Ne jemi përpjekur ta sjellim në shqipe qëllimisht në dy variante:

Në variantin e parë²⁰³, përkthyer në këtë formë të kërkuar prej nesh, jemi përpjekur që t’i qëndrojmë besnik origjinalit duke ruajtur terminologjinë e gjuhës origjinale. Zërat bazë nga fillimi në fund janë terma grekë. Në shqipe janë sjellë nyjat, lidhëzat, parafjalët, tek-tuk ndonjë folje. Termat e përdorur në ligjëratën e Zolotas janë terma që përdoren gjerësisht në gjuhën shqipe jo vetëm në fushën e ekonomisë (ekonomi, antiekonomik), por edhe në fusha të tjera si: filozofi (filantropi), gjeografi (paralel), gjuhësi (frazologji), histori (arkond, autokton, epokë, etnik), letërsi (epilog, ironi, sarkazmë), mjekësi (anemi, diagnozë), muzikë (harmoni), në terminologjinë fetare (anatemë, herezi) etj.

Në variantin e dytë²⁰⁴, përkthyer në këtë formë të kërkuar prej nesh, jemi përpjekur, ta sjellim në një shqipe të kuptueshme nga të gjithë.

Varianti I

Kyrie, It is Zeus’ anathema on our epoch for the dynamism of our economies and the heresy of our economicmethods and policies that we should agonise between the Scylla of numismaticplethora and the Charybdis of economicanaemia. It is not my idiosyncrasy to be ironic or sarcastic but my diagnosis would be that politicians are rather cryptoplethorists. Although they emphatically stigmatize numismatic plethora, energize it through their tactics and practices. Our policies have to be based more on economic and less on political criteria.	Kirié (Kirié (Shqiptarët e shqiptojnë Qirié) (gr. Κύριος) / Zotërinj), Është anatema e Zeusit ndaj epokës sonë për shkak të dinamizmit të ekonomive tona dhe herezisë së metodave dhe politikave tona ekonomike që po e bëjmë Skilën e pletorës numizmatike dhe Karibdën e anemisë ekonomike të përjetojnë agoni. Nuk është në idiosinkrasinë time të bëhem ironik ose sarkastik, por diagnoza që do t’i bëja situatës është se politikanët janë tepër kriptopletoristë. Megjithëse e stigmatizojnë emfatikshëm pletorën numizmatike, e energizojnë atë nëpërmjet taktikave dhe praktikave të tyre. Politikat tona duhet të bazohen më tepër në kritere ekonomike dhe më pak në ato politike.
--	---

203 Përkthyer nga Viola Jonuzi.

204 Përkthyer nga Granit Zela.

Our gnomon has to be a metron between political, strategic and philanthropic scopes. Political magic has always been antieconomic. In an epoch characterised by monopolies, oligopolies, menopsonies, monopolistic antagonism and polymorphous inelasticities, our policies have to be more orthological. But this should not be metamorphosed into plethorophobia which is endemic among academic economists. Numismatic symmetry should not antagonize economic acme. A greater harmonization between the practices of the economic and numismatic archons is basic. Parallel to this, we have to synchronize and harmonize more and more our economic and numismatic policies panethnically. These scopes are more practical now, when the prognostics of the political and economic barometer are halcyonic. The history of our didymous organisations in this sphere has been didactic and their gnostic practices will always be a tonic to the polyonymous and idiomorphous ethnical economics. The genesis of the programmed organisations will dynamize these policies. I sympathise, therefore, with the aposties and the hierarchy of our organisations in their zeal to programme orthodox economic and numismatic policies, although I have some logomachy with them. I apologize for having tyrannized you with my hellenic phraseology. In my epilogue, I emphasize my eulogy to the philoxenous autochthons of this cosmopolitan metropolis and my encomium to you, Kyrie, and the stenographers.	Gnomi ynë duhet të jetë si metër midis qëllimeve politike, strategjike dhe filantropike. Magjia politike ka qenë gjithnjë anti-ekonomike. Në një epokë të karakterizuar nga monopolet, oligopolet, monopsonisja, antagonizmi monopolistik dhe moselasticiteti polimorf politikat tona duhet të jenë më tepër ortologjike. Megjithatë, nuk duhet lejuar që kjo, nëpërmjet metamorfozës, të kthehet në pletorofobi që është endemike ndërmjet ekonomistëve akademikë. Simetria numizmatike nuk duhet të kthehet në antagonizëm ndaj apogjeut ekonomik. Harmonizimi më i madh midis praktikave të arkondëve ekonomikë dhe numizmatikë është bazik. Paralelisht me këtë, duhet të sinkronizojmë dhe harmonizojmë gjithnjë e më shumë politikat ekonomike dhe numizmatike në aspektin e panetnicitetit. Këto fushëveprime janë më shumë praktike tani, në një kohë kur prognozat e barometrit politik dhe ekonomik janë halkionike. Historia e organizatave didime në këtë sferë ka qenë shumë didaktike dhe praktikat gnostike do të jenë gjithmonë një faktor tonik ndaj ekonomive polionome dhe idiomorfe etnike. Gjeneza e organizatave të programuara do t'i japin dinamizëm këtyre politikave. Prandaj, unë simpatizoj apostujt dhe hierarkinë e organizatave tona për zellin që kanë treguar ndaj politikave ekonomike dhe numizmatike ortodokse të programit, megjithëse pata një logomaki me ta. Ndiej të them apologjinë time që ju tiranizova me frazelogjinë time helene. Si për epilog, dua që eulogjia ime të jetë emfatike për autoktonët filoksenë të metropolit kozmopolit dhe enkomia ime për ju, Zotëri, dhe për stenografët. Përktheu: V. Jonuzi
---	---

Varianti II

Kyrie, It is Zeus' anathema on our epoch for the dynamism of our economies and the heresy of our economic methods and policies that we should agonise between the Scylla of numismatic plethora and the Charybdis of economic anaemia. It is not my idiosyncrasy to be ironic or sarcastic but my diagnosis would be that politicians are rather cryptoplethorists. Although they emphatically stigmatize numismatic plethora, energize it through their tactics and practices. Our policies have to be based more on economic and less on political criteria. Our gnomon has to be a metron between political, strategic and philanthropic scopes. Political magic has always been antieconomic. In an epoch characterised by monopolies, oligopolies, menopsonies, monopolistic antagonism and polymorphous inelasticities, our policies have to be more orthological. But this should not be metamorphosed into plethorophobia which is endemic among academic economists. Numismatic symmetry should not antagonize economic acme. These scopes are more practical now, when the prognostics of the political and economic barometer are halcyonic. The history of our didymous organisations in this sphere has been didactic and their gnostic practices will always be a tonic to the polyonymous and idiomorphous ethnical economics.	Kirié, Është mallkimi i Zeusit për këtë epokë ndaj dinamizmit të ekonomive, herezisë së metodave dhe politikave tona ekonomike arsyjeja pse jemi në gjendje agonie mes Shillës së inflacionit financiar dhe Karibdës së anemisë ekonomike. Nuk është arsytim i stërholluar për t'u treguar ironik apo sarkastik por sipas diagnozës që unë i bëj kësaj gjendjeje politikanët janë njerëz me agenda dhe plane veprimi kriptopletoriste (sh.i.p.) Fjala kriptopletorist është përdorur për herë të parë nga ekonomisti grek Profesor Ksenofon Zolotas (Xenophon Zolotas, 1904-2004), i cili mendonte se politikanët janë kriptopletoristë. Pjesa e parë e fjalës "crypto" do të thotë sekret ose e fshehtë, ndërsa "plethora" do të thotë bollëk. Ai donte të thoshte se politikanët janë njerëz me agenda të fshehta ose me motive të panjohura. Megjithëse ata e damkosin me forcë inflacionin monetar, në të vërtetë e fuqizojnë atë me anë të taktikave dhe praktikave që zbatojnë. Politikat tona duhet të mbështeten më shumë në kriteret ekonomike dhe më pak në kriteret politike. Busulla jonë orientuese duhet të jetë një kompas që rrotullohet mes fushës politike, strategjike dhe filantropike. Truket magjike të politikës kanë qenë gjithnjë anti-ekonomike. Një epokë ku mbizotërojnë monopolet, oligopolet, blerësit e monopolizuar, antagonizmi i monopoleve dhe mungesa shumëformëshe e elasticitetit të tregjeve, politikat tona duhet të jenë shumë më të sakta. Por kjo nuk duhet të shndërrohet në fobi ndaj bollëkut diçka që ndodh rëndom mes ekonomistëve akademikë. Barazia monetare nuk duhet të luftojë lulëzimin ekonomik. Një harmonizim më i madh mes udhëheqësve ekonomik dhe financiar është themelor. Paralelisht me këtë, është e nevojshme të sinkronizohen dhe harmonizohen gjithnjë e më shumë politikat tona ekonomike dhe financiare përtej kombëtare.
---	---

The genesis of the programmed organisations will dynamize these policies. I sympathise, therefore, with the aposties and the hierarchy of our organisations in their zeal to programme orthodox economic and numismatic policies, although I have some logomachy with them. I apologize for having tyrannized you with my hellenic phraseology. In my epilogue, I emphasize my eulogy to the philoxenous autochthons of this cosmopolitan metropolis and my encomium to you, Kyrie, and the stenographers.	Këto fusha veprimi janë më praktike tani, pasi protagonistët e barometrit politik dhe ekonomik janë paqësorë. Historia e organizatave tona me natyrë të dyfishtë në këtë fushë ka qenë didaktike dhe praktikë e tyre njohëse do t'i japin gjithmonë tonin ekonomisë shumëëmërshe dhe shumë-formëshe. Origjina e organizatave të programuara do t'i gjallërojë këto politika. Rrjedhimisht, unë jam për krahasues të udhëheqësve dhe hierarkisë në organizatat tona për zellin e tyre për të programuar ekonominë tradicionale dhe politikat financiare, pavarësisht nga pikëpamjet e kundërta që ndaj me ta. Ju kërkoj ndjesë që ju torturova me terminologjinë e vjetër greke. Në fund të kësaj ligjërate, dua të theksoj lëvdatat e zjarra për vendësit bujarë të këtij metropoli kozmopolit dhe nderimet më të larta për Ju, Qirie dhe për stenografët. Përktheu: G.Zela
--	--

Për aq sa na lejon trajtesa e një artikulli, nga analiza e këtij teksti të përkthyer në dy variante, ngrihen dhe dalin në pah probleme të rëndësishme të përkthimit.

Me të drejtë lind pyetja. Cili variant duhet pranuar? I pari, i cili, për hir të së vërtetës, duhet thënë se është më pranë origjinalit, apo i dyti, i cili është larguar relativisht nga origjinali, por nga ana tjetër është më i kuptueshëm?

Varianti i parë kërkon njohuri shumë të thella shkencore dhe enciklopedike. Kërkon domosdoshmëri një lexues të kultivuar, me shqollim të shëndoshë dhe me dije e njohuri mbi mesataren.

I dyti, përkundrazi, është një tekst divulgativ, relativisht i thjeshtuar qëllimisht në një gjuhë që i afrohet asaj të masës, gjuhës së një publiku të zakonshëm. Janë bërë përpjekje për të përdorur fjalën shqipe në vend të asaj greke, çka e bën tekstin më të kuptueshëm për shqipfolësit.

Mund të përdorej edhe një mënyrë tjetër përkthimi duke vendosur shënime në fund të faqes, perifrime, ose shpjegime në kllapa, për çdo term grek. Si dhe të shënohej gjegjësi a sinonimi që do t'i shkonte për shtat në shqipe. Kjo do ta rëndonte shumë tekstin, si rrjedhim do ta bënte të lodhshëm për lexuesin. Duke qenë fjalë të karakterit pasiv (rrjedhimisht të panjohura e aq më pak të përdorshme në ligjërimin e përditshëm),

kjo e bën të vështirë si përkthimin, ashtu edhe kuptimin. Për arsye studimore, mendojmë se varianti i parë (ai më pranë origjinalit) nxjerr në pah erudicionin e thellë të autorit, ndërsa, mendojmë e gjykojmë se varianti i dytë (i kuptueshëm nga të gjithë) nxjerr në pah zotërimin mirë nga përkthyesi, të gjuhës mbërritëse (shqipes në rastin tonë), aftësinë e tij për ta thjeshtuar të ndërlikueshmen, jo se ai është i paaftë që të japë edhe formën e njëjtë a të afërt të origjinalit. Kështu, në të dyja rastet vlen për t'u marrë në konsideratë dhe të lavdërohet puna e përkthyesve.

Varianti i parë është i domosdoshëm për specialistët e mirëfilltë, për njohësit e lëndës, pra, për specialistë të fushës.

Përkundrazi, varianti i dytë, orvatet që ta bëjë tekstin divulgativ, të kuptueshëm, të rrokshëm nga masa.

Si përfundim, duke u nisur nga qëllimi se kujt i drejtohet, gjen zbatim edhe përkthimi i këtij teksti.

Në një manual a traktat shkencor, duhet (edhe për arsye erudicioni) të botohet varianti i parë. Në media, gazetë, portale, që ai të bëhet sa më i rrokshëm nga sa më shumë duhet të gjejë vend varianti i dytë i përkthimit.

Ligjërata e ekonomistit grek K. Zolotas, e pasur me terminologji me burim nga greqishtja, dëshmon se, pavarësisht nga mosnjohja e gjuhëve të njëri-tjetrit, ekonomistët do të flisnin për një temë ekonomike me terma shkencorë me burim nga greqishtja dhe do të kuptoheshin shumë mirë midis tyre, po ashtu do të flisnin e do të kuptoheshin edhe mjekët, politikanët, biologët, kimistët etj. Zgjedhja e greqishtes si burim i terminologjisë shkencore nuk ka qenë e rastësishme, por kishte arsyet e saj historike dhe përparësi praktike të caktuara, të cilat pritej të shtoheshin nga përdorimi i një burimi gjuhësor të përbashkët që kishte një fjalor të shumëllojshëm, gjithëpërfshirës me terma që ishin elastikë në formë, por edhe të qëndrueshëm në kuptime. Një fjalor terminologjik shkencor me burim gjuhësor nga greqishtja u jep shkencëtarëve sigurinë se termat e tyre do përçojnë kudo të njëjtat kuptime.

BIBLIOGRAFIA:

- BABINIOTIS, J. (2015), Gjuha greke - e shkuara, e tashmja, e ardhmja (Ελληνική γλώσσα - παρελθον, παρον, μελλον), Athinë.
- NYBAKKEN, O. E. (1979), Greek and latin in scientific terminology, The Iowa State University Press.
- WILEY-BLACKWELL (2014), A Companion to the Ancient Greek Language, Nju-Jork.
- http://www.ellinogermaniki.gr/ep/mila/links_zolotas.htm

VËZHGIME MBI FJALËT VENDËSE DHE SIVENDËSE NË SHQIPE, TË PASQYRUARA NË FJALORËT SHQIP-RUSISHT E SHQIP-ANGLISHT

Prof. Asoc. Dr. Eda Shehu

Departamenti i gjuhëve Sllave e Ballkanike

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

E-mail: edashehu_2006@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim trajtohen fjalët vendëse dhe sivendëse, të cilat i përkasin gjuhës standarde. Si klasë e veçantë njësish leksikore (emërtuese), kanë specifikën e tyre të përdorimit në çdo gjuhë dhe spikasin sidomos në përfshirjen e tyre në fjalorët dygjuhësh. Grup me interes, por edhe më problematik, përbëjnë ato fjalë vendëse apo sivendëse që paraqesin vështirësi në gjetjen e gjegjëseve të tyre në gjuhën marrëse, çka dëshmohet edhe nga format e përkthimit të tyre. Vlera e studimit të këtyre fjalëve është me interes të veçantë në procesin e të mësuarit të një gjuhe si gjuhë e huaj, në hartimin e fjalorëve etj.

Fjalët çelës: fjalë vendëse, fjalë sivendëse, fjalor dygjuhësh

ABSTRACT

This study focuses on local and equivalent words, which belong to a standard language. As a separate class of lexical (denominator) items, they constitute the specificity of use in each language and stand out in particular their involvement in bilingual dictionaries. Interest group, but also more problematic, constitute local or equivalent words that present difficulties in finding their subjects in the receiving language which is also evidenced by the forms of their translation. The value of studying these words is of particular interest in the process of learning a language as a foreign language, in compiling dictionaries, etc.

Keywords: bilingual dictionaries, local and equivalent words

Gjatë vëzhgimit të leksikut në çdo gjuhë, sikurse edhe në shqipe, mund të veçohet një kategori fjalësh që shënojnë realie (objekte, procese, cilësi). Në mënyrë të veçantë ato spikasin kur përqasen me një gjuhë tjetër, në të cilën mungojnë realiet përkatëse dhe kuptimi i tyre jepet me mjete gjuhësore të tjera, duke shprehur në mënyrë barazvlerëse ose të përafërt realien që mungon në të. Dhënia e kuptimit të këtyre fjalëve në gjuhën marrëse, që quhen zakonisht fjalë vendëse²⁰⁵, për të zbuluar sa më qartë e saktë realiet, shumë rrallë paraqiten në gjuhën marrëse me trajtën fonetike (a fonologjike) të gjuhës

205 H. Shehu, "A duhet të përfshihen dialektizmat e krahinorizma fonetikë në një fjalor shqip-gjuhë e huaj?", "Studime filologjike", 1993/3-4.

dhënëse, si p.sh., për emërtimin e realieve që në gjuhën marrëse shënojnë njësi matëse, lloje gjellësh, veshjesh etj., si në shqipe²⁰⁶: *lekë, aga, bej* (në rusishte²⁰⁷: лек, ара, бей), në anglishte²⁰⁸: lek, aga bej, dynym (lek, agha, bey, dynym), në forma togfjalëshash, si për *lakror* në rusishte: пирог с воцной начинкой, në anglishte për *turli*: *mixed dish*.

Në studimet rreth leksikut të shqipes fjalët vendëse janë trajtuar nga Hajri Shehu²⁰⁹, por duke pranuar si të tilla vetëm fjalët shqipe që shënojnë realie të veçanta, të vetme për arealin gjuhësor shqip. Ato janë studiuar dhe dhënë në pjesën më të madhe në korpusin e paraqitur nga prof. Çabej²¹⁰ ku, mbizotërojnë fjalë me prejardhje shqipe, që përdoren në këtë areal gjuhësor, si fjalë të të folmeve, dialektizmat etj. (*sharof* (qen stani), *shelqe*, *shtëpresë*, *sembër*, *lëshkorre* etj.), të cilat nuk përbëjnë në tërësinë e tyre fjalë të futura në gjuhën e sotme standarde shqipe dhe jepen në fjalorë dygjuhësh në mënyrë të kufizuar²¹¹.

Siç është përmendur edhe më sipër, si grup të veçantë të kategorive të fjalëve vendëse mund të pranohen edhe njësi gjuhësore, karakteristike për një areal të veçantë, por që e kanë origjinën nga një gjuhë tjetër, të huazuar prej saj në rrjedhë të kohërave, ndoshta prej shekujsh për shkaqe të ndryshme historike, të futura nga gjuha pushtuese si, p.sh. në shqipe nga turqishtja. Duke gjalluar për një kohë të gjatë në gjuhën e dhënë, ndonëse me prejardhje nga një gjuhë tjetër, ato janë rrënjësor në të, duke u ndier prej subjektit folës njësoj si fjalët e veta. Të tilla janë në shqipe një numër i madh fjalësh turke, të cilat mund të quhen edhe pranohen si shqipe dhe që mund të quhen fjalë sivendëse, si, p.sh., sot në shqipe: *bakllava*, *revani*, *hasude* etj. Dhe këto fjalë në një fjalor dygjuhësh, si p.sh. shqip-rusisht²¹² ose shqip-anglisht²¹³, a në ndonjë fjalor tjetër, ndonëse me origjinën nga turqishtja, perceptohen si shqipe. Meqë këto njësi përbëjnë një grup të veçantë që shënojnë realie që mungojnë në gjuhët e mësipërme, do t'i përfshinin në kategorinë e fjalëve vendëse (shqipe), por meqë ato realisht nuk janë shqipe, do t'i quanim sivendëse.

Fjalët vendëse dhe sivendëse shpesh mund të përfshihen si njësi në fjalorët dygjuhësh që i përkasin gjuhës standarde. Nga gjuha jostandarde, si të tilla, mund të jenë një pjesë, e pasqyruar në fjalorin dygjuhësh, si *dialektizmat*, fjalët e të folmeve, historizmat, që edhe kur përdoren janë në masë të kufizuar. Pjesa tjetër, si të nevojshme për një komunikim të gjerë, pasqyrohen në fjalorë dygjuhësh, ku gjuha amtare del si gjuhë dhënëse, si p.sh., në një fjalor shqip - gjuhë e huaj, si, në rastin tonë, në fjalorët shqip-rusisht ose shqip-anglisht. Ka rëndësi të theksohet, se dhe pasqyrimi i tyre në gjuhën dhënëse mund të ketë karakter relativ dhe subjektiv dhe varet edhe nga madhësia e fjalorit; kështu sa më

206 *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë, 2006.

207 M. Mançe, *Fjalor shqip-rusisht*, Tiranë, 2007.

208 P. Qesku, *Fjalor shqip-anglisht*, Tiranë, 1999.

209 Shih 1.

210 E. Çabej, *Studime etimologjike në fusha të shqipes* (I-II), Prishtinë, 1976.

211 Shih 3, 4.

212 Shih 3.

213 Shih 4.

i madh të jetë fjalori, aq më të përfaqësuara janë ato në të, ndonëse kjo varet edhe nga koncepti i hartuesit. Kështu, p.sh., fjala shqipe *shapkat*, si fjalë vendëse shqipe, jepet në fjalorin shqip - anglisht (*corn-meal pie*), por mungon në fjalorin shqip-rusisht. Nga ana tjetër, *pekmez* jepet në rusishte: *сгущённый виноградный сок*, por mungon në anglishte.

Fjalët vendëse, si klasë e veçantë njësish leksikore (emërtuese), siç u theksua më sipër, përbëjnë specifikën e përdorimit në çdo gjuhë dhe spikatin sidomos në përfshirjen e tyre në fjalorët dygjuhësh. Përdorimi në një gjuhë të caktuar lidhet me pasqyrimin prej tyre të veçorive të kulturës së një kombi që flet një gjuhë të caktuar, formimin e tij psikik, etnik, kulturor, material, shpirtëror etj²¹⁴.

Grup me interes, por edhe problematik, përbëjnë ato fjalë vendëse apo sivendëse që paraqesin vështirësi në gjetjen e gjegjëseve të tyre në gjuhën marrëse, çka dëshmohet edhe nga format e përkthimit të tyre. Në shumicën e rasteve këto fjalë jepen me mjete gjuhësore, të cilat u përgjigjen në mënyrë të përafërt kuptimore realieve që mungojnë në gjuhën marrëse, si: *duvak* (shq.) = *bride's veil* (angl.).

Vlera e studimit të tyre është me interes të veçantë në hartimin e fjalorëve dygjuhësh (gjuhë amtare - gjuhë e huaj), të cilët mund t'u vijnë në ndihmë përkthyesve për gjetjen e barazvlerësve të tyre në gjuhët marrëse, (nga gjuhët dhënëse), si p.sh. mënyra e dhënies në rusishte apo në anglishte e fjalës *behar* e shqipes si gjuhë dhënëse. Në këtë rast në rusishte fjala jepet në formë të tillë, në të cilën zërthehet kuptimi i realies që pasqyrohet në gjuhën marrëse, ndonëse jo në mënyrën e duhur; kështu fjala *behar*, e shqipes, si gjuhë dhënëse, jepet në rusishte: *лето*²¹⁵, kurse në anglishte: *warm-season*²¹⁶. Lidhur me rolin e tyre si fjalë vendëse për përcaktimi e identitetit të saktë të kuptimit të fjalëve, mbi bazën e realieve të cilat ato shprehin në procesin e përkthimit, çka e shndërron këtë proces në një akt social, duhet përmendur punimi i Sider Florinit "Realia në përkthim"²¹⁷. Megjithatë, ndryshe nga punimi i cituar, në të cilin trajtohen dy gjuhë gjenetikusht të afërta, në studimin tonë janë bërë objekt vëzhgimi veçoritë e fjalëve vendëse, paraqitur në rrafshin përqasës me tri gjuhë gjenetikusht të largëta, që u përkasin tri grupeve gjuhësore me natyrë të ndryshme nga pikëpamja e tipologjisë strukturore, semantiko-lesksikore: gjuha shqipe - sintetike e përzier; gjuha angleze - analitike dhe gjuha ruse - kryesisht sintetike. Nga ana tjetër, këtu përfshihen në përqasje edhe fjalët shqipe, të prejardhura nga turqishtja, si gjuhë

214 E. Çabej, *Studime etimologjike në fusha të shqipes* (I-II), Prishtinë, 1976.

215 Shih 3.

216 Shih 4.

217 S.Florin, *Realia in Translation*, dans *Translation as Social Action: Russian and Bulgarian Perspectives*, Routledge, Londres, 1993, p. 123.

shumë e largët gjenetikisht në krahasim me tri gjuhët e mësipërme, por që në shqipe konsiderohen si vendëse, për shkak të ngulitjes së tyre shumëshekullore, si *bakllava*, *revani* etj.. Për këtë arsye ato përbëjnë përbën një objekt me interes të veçantë studimi, nga pikëpamja e vlerësimit të tyre në rrafsh përqasës me anglishten dhe rusishten, si gjuhë të një familjeje tjetër gjuhësore.

Studimi i fjalëve vendëse dhe sivendëse në këtë punim bëhet duke i ndarë në dy grupe: a) të pasqyruara në dy fjalorët e mësipërm; b) të papërfshira në fjalorë, por që përbëjnë një objekt me interes të veçantë, e që kryesisht përdoren në të folur (në thjeshtligjërime).

Interes të veçantë ato përbëjnë, nëse vështrohen edhe nga ana e prejardhjes së tyre dhe si të tilla mund të ndahen në dy kategori kryesore: a) të përdorura vetëm në mjedisin gjuhësor shqiptar, si: *opingë*, *shapkat*, *duvak*, *shtojzavalle*, *bjeshkë* b) të ardhura edhe nga ndonjë gjuhë tjetër, si në rastin tonë nga gjuha turke (për shqipen), por që përdoren prej kohësh (ndoshta prej shekujsh), si, p.sh., fjalët sivendëse shqipe: *raki*, *bakllava*, *pelte*, *paluze*, *japarak*, *llokum*²¹⁸.

Në marrëdhënie me format e brendshme, të pasqyruara në fjalorët e mësipërm, këto mund të klasifikohen gjithashtu në dy grupe: a) me të njëjtën formë siç paraqitet në gjuhën marrëse, por që kuptimi i tyre jepet në forma të ndryshme: 1. pa shpjegim pas saj: si *iso* - подпевание (rus.), *boshtër* - elder (angl.); 2. me shpjegime: *trahana* - кушанье из дрожжевого теста с молоком (rus.); 3) me formë të brendshme të afërta: *behar* - worm season (angl.) dhe 4) formë të brendshme të ndryshme: *opingë* - green-hide shoe (ang.)

Duhet theksuar se fjalët e papasqyruara në fjalor mund të jenë emërtime me përdorim shumë të kufizuar në gjuhën dhënëse (në shqipe) si dialektizma, historizma [*shapkat* (lloj byreku), *dible* (lloj bakllavaje)]

Si fjalët vendëse ashtu edhe ato sivendëse mund të vështrohen si njësi që përfshihen në grupe të ndryshme tematike. Më poshtë po japim një varg grupesh, por duke u përqendruar në tri grupe kryesore, të cilat takohen me shumicën e rasteve në fjalorët shqip-rusisht e shqip-anglisht, si: *emërtime gjellësh*, *veshjesh* dhe *njësi matëse*. Kjo do të thotë, se si bazë e korpusit leksikor shërbejnë fjalët shqipe, të nxjerra në mënyrë të përzgjedhur nga dy fjalorët e mësipërm, duke i paraqitur në formë tematike.

A. Paraqitja tematike

1. bimë²¹⁹: a) drurë: *bredh, hormoq, qarr*; b) shkurre: *boshter, bezgë, kulmak*: lule (barëra): *manushaqe, lulehelm, zymbyl, jonxhë, sherebelë, manxura, çaj mali*;
2. kafshë, shpendë: *pelikan, karabullak, shkabë, sokol, dardaf, lundërza*;
3. gjellë: *turli, qull, mëmëligë, kaçamak, fli, qumështor, tavë dheu, tavë kosi, qull, trahana, pispili, japrak, tarator*;
4. meze: *kole, paçe, korzë*;
5. ëmbëlsira: *bakllava, bollokume, ashure, hasude, sultjash, trazake*;
6. qenie mitologjike: *shtojzavalle, zanë*;
7. mot: *behar*,
8. lloj këpuce: *opingë*;
9. lloj palltoje: *xhubletë, gunë, bërruc*;
10. lloj kapeleje: *qylaf, qeleshe*;
11. perçe: *duvak, pece*;
12. pajime kafshësh: *hejbe, samar, palldëm*
13. masë drithë: *okë, karroqe*
14. masë toke: *dynym*,
15. përmasë: *pashë, çepirok*;
16. monedhë: *lek, qindarkë*;
17. lojë: *kaladibrançe, asër, topadjegësi, syllambyllasi, doçe-kanoçe*
18. muzikë: *kaba, iso*;
19. vegël muzikore: *çifteli, qyp, lahutë*;
20. lloj mbathjeje: *poture, brekushe, çitjane*;
21. objekt kulti: *teqe, tyrbe, vakëf*;
22. person si përkatësi e një sektit fetar: *bektashi*;
23. titull fetar: *imam, erenler, baba, dervish, haxhi*;
24. festë fetare: *bajram, novruz*;
25. rit fetar: *iftar, syfyr, mevlud*;
26. titull sunduesi historik: *bej, aga, kulak, qehaja*;
27. lloj peshku: *krap, belushkë, koran*;
28. lloj pije: *rehani*;

219 Shih më me hollësi: I. Mitrushi, *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*, Tiranë, 1955.

B. Pasqyrimi / mospasqyrimi në fjalorët e dhënë

Fjalët ²²⁰	Fjalori shqip - rusisht	Fjalori shqip - anglisht
aga	Aga	Agha
asër (vrap)	--	--
baba (i teqesë)	--	--
bajloz	Эммиссар	Giant
bajram	Байрам	Bairam
ballokume	--	--
bej	Бей	Bey
bektashi	--	Bektashi
belushkë	небольшая озёрная семейства форели	lake trout
bërruc	--	Cloak
bezgë (bimë)	--	phomis; mint
biz-i (lojë)	--	--
boshtër	--	Elder
brekushe	Шаровары	Bloomers
bukëfiqe	--	dry fig loaf
bukëvale	--	--
çepirok	--	--
çitjane	--	--
dardaf	--	--
dervish	--	--
dollma	Голубцы	Dolma
doras	--	--
duvak	--	bride's veil
dynym	мера площади, равная 0.1 га.	Dynym
ezhdërha	--	Monster
fli (byrek)	вид пирога	--
gjakës	--	--
gjerdek	--	nuptial room
groshë (para)	мелкая монета	--

220 Për një pjesë nga këto fjalë shih edhe: E.Çabej: *Studime etimologjike në fushë të shqipes* (I, II), Prishtinë, 1976.

gunë	верхняя шерстяная одежда с капюшоном	Cape
hajmali	амулет, талисман	Amulet
harapash	--	--
hasude	--	Sweetmeat
hejbe	вьючая перемётная сума, торба	Saddlebag
iftar	--	Iftar
imam		Imam
iso	Подпевание	Bourdon
japrak	Голубцы	Japrak
jonxhë	Люцерна	Lucerne
kabash	--	--
kabuni	--	--
kaçamak	полента (каша из кукурузы)	cornflour hominy
kaladibrançe	нести на спине, на плечах, на закорках	buck-buck
karabullak	--	common (great) cormorant
karkanaqe	--	egg crumpet
kërnacka	--	Sauté
kolé	--	Tripe
kollan	магазин для патронов	cartridge belt
kolloface	--	Sausage
Koran	Коран	spotted lake trout
kotruve	--	--
krap	Карп	Carp
krushkë	Свойственник	in-law
kukudh	привидение гоблин	goblin, evil person
kukurrec	бдюдо вроде шашылка из внутренностей животных	roasted entrails
kulmak	Тросник	Rush
kulumbri	--	--
lakror	пирог с воцной начинкой	Pie
lek	денежная единица албании	Lek
llukanik	вид сосисок	tripe sausage
lulehelmi	--	--
lundërza	Выдра	Barge

VËZHGIME MBI FJALËT VENDËSE DHE SIVENDËSE NË SHQIPE

manushaqe	Фиалка	Violet
manxuranë	майоран, душица	Marjoram
mbles	Сваха	go -between; match-maker
mëmëligë	--	--
mevlud	--	--
muhalebi	--	cornflour (rice) and milk pap
nevruz	--	spring festival
nuskë	Талисман	doll, stack (of cut maize)
okë	мера веса, равная 1408 граммам	Okka
opinga	крестьянская обувь	green hide shoe
palafiqe	--	dry fig loaf
palldëm	Подпруга	belly -band; girth
pashaqofte	--	--
pashë	мера длины, равная 1.62 метрам	--
pasor	--	--
pekmez	сгущённый виноградный сок	--
pelikan	Пеликан	Pelican
pelte	сладкая каша, пюре	Jelly
pogaçe (byrek)	сдобная булка, пирог с маслом	wheaten scone, butter pie
poture	--	wide breeches; bloomers
qehaja	управляющий именем, надзиратель	Warden
qeleshe	шерстяная шляпа без полей	brimless cap
qindarkë	Копейка	--
qull	мучное блюдо, каша	Mush
qumështor	сладкий молочный пирог	milk pie
qylaf	Плис	pointed scull-cap
revani	бисквитный торт, восточное лакомство	must
rosnjica	--	--
serm	Серебро	Silver
shallvare	Шаровары	wide breeches; slacks
shapkat	--	corn-meal pie
sheqerpare	--	sweetened scone
sherebelë	--	Sage
shkabë	Орёл	Eagle

shtojzavalle	нимифа	nymph, beautiful maiden
sokol	Сокол	sparrow hawk
suxhuk	Колбаса	Sausage
syfyr	--	after - midnight meal
syltjaç	рисовый пудинг на молоке	--
takije	--	soft peaked-scullycap
tarator	кефир с чесноком, огурцами и	--
tavë dheu	--	--
tavë kosi	--	--
teqe	культовое здание религиозной секты бекташи	Tekke
tirqe		woollen (worsted) cloth
trahana	кушанье из дрожжевого теста с молоком	wheatmeal porridge
trazake	--	--
turli	--	mixed dish
tyrbe	--	Shrine
vakëf	Храм	temple, holy place
verore	--	wrist band
xhube	пальто на меху, шуба	--
xhubletë	Шуба	sleeveless wool(l)en dress
yç (lojë)	--	three -piece
zanë	фея, волшебница	Fairy
zymbyl	Гиацинт	Jacinth

Nga shembujt e sjellë mund të paraqiten katër raste të pasqyrimin ose të mos pasqyrimin të fjalëve vendëse e sivendëse në fjalorët e dhënë:

1. Fjalë vendës / sivendëse - fjalë e papasqyruar në të dy fjalorët: *asër, baba (teqeje), biz, doras, dardaf,, harapash, gjakës, korzë, lkulumbri, lulehelm, mëmëligë, mevlud, pashaqofte, ballokume, trazake, pasor, kotruve, kabesh, rosnjice, çepirok, tavë kosi, tavë dheu;*
2. Fjalë vendëse / sivendëse - fjalë e pasqyruar vetëm në fjalorin *shqip-rusisht*: *ezhdërha, fli, pashë, syltjaç, tarator;*
3. Fjalë sivendëse / vendëse - fjalë e pasqyruar vetëm në fjalorin *shqip-anglisht*: *bektashi, bërruc, bukëvale, duvak, boshtër, bukëfiqë, dervish, gjerdek, hasude, iftar, imam, kabuni, karabullak, karkanaqe, kërnacka, kolë, kolloface, muhalebi, palafiqe, poture, sheqerpare, sherebelë, syfyr, takije, tirqe, turli, tyrbe, yç;*

4. Fjalë vendëse / sivendëse të pasqyruara në të dy fjalorët: *aga, bajloz, bajram, bej, belushkë, brekushe, dollma, dynym, groshë, gunë, hajmali, hejbe, iso, japrak, jonxhë, kaçamak, kaladibrance, kollen, koran, krap, krushkë, kukudh, kukurrec, kulmak, lek, llukanik, lundërza, manushaqe, nuskë, okë, opinga, palldëm, pashë, pekmez, pelte, pogaçe, qehaja, qeleshe, qindarkë, qymështor, qylaf, revani, serm, shkabë, shtojzavalle, sokol, suxhuk, vakëf, zanë, zymbyl*;

C. Format e dhënies në fjalorët përkatës:

Shqip E huaj

1. Fjalë vendëse - fjalë e huazuar nga fjala vendëse si e transkriptuar, si tek: *bej, aga, lek, dynym* etj;
2. Fjalë vendëse - fjalë me kuptim të gjerë ose e afërt nga kuptimi, si tek: *suxhuk, hasude, revani*, etj;
3. Fjalë vendëse - togfjalësh, si tek: *laktorr, qumështor, qeleshe, teqe*, etj;

D. Vendi dhe vlera e fjalëve vendëse e sivendëse në fjalorët dygjuhësh

Fjalët vendëse që u përkasin dialekteve, të cilat kanë përdorim relativisht të ngushtë dhe si të tilla nuk gjejnë vend në fjalorët dygjuhësh të përmasave mesatare, po kur sfera e përdorimit të tyre është e gjerë dhe depërtuese në gjuhë, ato përfshihen në këta fjalorë, si *hasude, revani*. Kur nuk janë të përfshira, nga mosnjohja e tyre prej autorëve të fjalorëve ose nga qëndrimi subjektiv ndaj tyre, ato duhet të futen si fjalë vendëse, meqë ato duhet të njihen për vlerën që kanë edhe për ata që mësojnë gjuhën si gjuhë dhënëse (studenti, përkthyesi), si: *trazake, pasor*.

Fjalët vendëse të të folmeve dhe historizmat mund të mos gjejnë vend në fjalorët dygjuhësh, me përjashtim të një pjese historizmesh si: *duvak, zanë, shtojzavalle*, të cilat kanë vlerë njohëse, për qëllime studimore, për të nxjerrë në pah historizmat e vendit, ndryshimet social historike etj..

Fjalët vendëse me përdorim të gjerë në gjuhë, që njihen nga një numër i madh folësish të gjuhës, duhet të gjejnë vend te fjalorët dygjuhësh. Kur nuk janë të përfshirë ata duhet të futen patjetër në të ardhmen.

Dhënia e tyre në gjuhën marrëse me mjetet gjuhësore të saj, pavarësisht se nuk ekzistojnë, si te realiteti përkatës, mund të bëhet duke u mbështetur në gjuhën marrëse mbi bazën e tiparëve të konceptit të realitetit, të shënuar nga gjuha dhënëse.

Dhënia e tyre në gjuhën marrëse mund të bëhet edhe mbi bazën e zëbrthimit leksiko-semantik të fjalës vendëse të gjuhës dhënëse, sidomos, kur kjo e fundit është e dukshme si p.sh.:

bukfiqe - “produkt i gatuar prej fiku (fiqe) në formë *buke*”. Më lehtë bëhet dhënia e tij kur njësia e gjuhës dhënëse jepet si togfjalësh si p.sh.: *tavë dheu* “gjellë në tavë prej dheu”.....

Pasqyrimi i tyre në gjuhën dhënëse mund të jenë në një ose në të dyja gjuhët ose mund të mungojë në to, si, p.sh. *hasude* në rus., s’është në anglisht, *berruc* është në anglisht, por s’është në rusisht etj.

Përfundime

Si përfundim mund të theksohet se vlera e studimit të fjalëve vendëse dhe sivendëse ka interes të veçantë praktik dhe aplikativ në punën për gjetjen dhe përcaktimin e gjegjëseve barasvlerës të përshtatshëm në procesin e hartimit të fjalorëve dygjuhësh, gjuhë amtare - gjuhë e huaj, ku gjuha amtare shërben si gjuhë dhënëse, prandaj shtrohet si detyrë e rëndësishme thellimi i studimit të tyre në një rrafsh më të gjerë për të kapërcyer prapambetjen e vërejtur deri më sot në qëndrimin e pavëmendshëm ndaj tyre si klasë e veçantë leksikore, çka ka rëndësi të veçantë jo vetëm praktike dhe aplikative, por edhe teorike të mirëfilltë. Në këtë trajtesë mëtojmë të kemi sjellë një kontribut modest për t’i hapur rrugën studimit të tyre në procesin e të mësuarit të gjuhës së huaj dhe në praktikën e përkthimit, ku si gjuhë dhënëse shërben gjuha amtare.

BIBLIOGRAFIA:

- AkAdemIA e shkencave e shqiperise (2006), *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë.
 CABEJ e. (1976), *Studime etimologjike në fushë të shqipes* (I, II), Prishtinë, 1976.
 FLORIN s. (1993), *Realia in Translation*, dans *Translation as Social Action: Russian and Bulgarian Perspectives*, Routledge, Londres, p. 123.
 HOXHA sh. (2015), *Fjalor fjalësh e shprehjesh turke*, Prishtinë.
 MANCE m. (2007), *Fjalor shqip-rusisht*, Tiranë.
 MEYER g. (2007), *Fjalor etimologjik i Gjuhës Shqipe - 1891*, Tiranë.
 MITRUSHI I. (1955), *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*, Tiranë.
 MITRUSHI I. (1966), *Dendroflora e Shqipërisë*, Tiranë.
 QESKU p. (1999), *Fjalor shqip-anglisht*, Tiranë.
 SHEHU h. (1993/3-4), *A duhet të përfshihen dialektizmat e krahinorizma fonetikë në një fjalor shqip-gjuhë e huaj?*, «Studime filologjike», Tiranë.

KONTRIBUTI I ALFABETIT DHE I FJALORIT TË «BASHKIMIT» NË LËVRIMIN DHE ZHVILLIMIN E GJUHËS SHQIPE

Ma. Marinela Prifti

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: marinela.prifti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Objekt i këtij punimi është veprimtaria e shoqërisë «Bashkimi», përkatësisht hartimi i alfabetit (një element thelbësor për një gjuhë që shkruhet për herë të parë) dhe i fjalorit të saj. Për këtë qëllim, punimi zhvillohet në një perspektivë historike, ku qasja diakronike na mundëson të përshkruajmë sfondin historik (Hyrja) në të cilin kemi vendosur veprimtarinë e kësaj shoqërie dhe situatën e gjuhës shqipe në këtë moment historik. Punimi është konceptuar në pesë seksione, secila me një interes të veçantë mbi një çështje të caktuar: *Shqipja dhe alfabetet e saj para vitit 1879; Kongresi i Manastirit dhe alfabeti njësuës; Alfabeti i «Bashkimit» dhe kritika e kohës; Tradita e fjalorëve dygjuhësh deri në vitin 1908 dhe Fjaluer i Rii i Shcypes*. Secila më vete dhe të gjitha në kohezion me njëra-tjetrën, pjesët synojnë të risjellin një panoramë të qartë mbi rolin e alfabetit të «Bashkimit» në ruajtjen dhe lëvrimin e gjuhës shqipe, mbështetjen e tij në shkronjat latine si një mjet që i vë shqiptarët në kontakt me botën moderne perëndimore, ndërsa hartimin e fjalorit si një vlerë të shtuar në dialektologjinë dhe leksikografinë shqiptare dhe një lëndë të vlefshme për studimet mbi gjuhën shqipe dhe studimet krahasuese me gjuhë të tjera.

Fjalët çelës: alfabet i njësuar, alfabeti latin, debati mbi alfabetin, fjalori i «Bashkimit», Kongresi i Manastirit

ABSTRACT

The object of this paper is the activity of the society «Bashkimi», respectively the drafting of the alphabet (an essential element for a language written for the first time) and its vocabulary. For this purpose, the paper is developed in a historical perspective, where the diachronic approach enables us to describe the historical background (Introduction) in which we have placed the activity of this society and the situation of the Albanian language at this historical moment. The paper is conceived in five sections, each one with a special interest in a particular issue: Albanian language and its alphabets before 1879; Monastery Congress and the unifying alphabet; The alphabet of «Bashkimi» and the critique of that time; The tradition of bilingual dictionaries until 1908 and the New Dictionary of Shcypa. Each separately and all in cohesion with each other, the pieces aim to bring back the clear panorama on the role of the alphabet of «Bashkimi» in the preservation and delivery of the Albanian language, its support in Latin letters as a tool that puts Albanians in contact with the modern western world, while compiling the dictionary as an added value in Albanian dialectology and lexicography and a valuable subject for studies on the Albanian language and comparative studies with other languages.

Keywords: debate on the alphabet, Latin alphabet, Monastery Congress, unified alphabet, «Union» dictionary

Hyrje

Historia e çdo gjuhe nis atëherë kur ajo shkruhet, ka thënë Çabej²²¹. Kjo nuk do të thotë se historia e shqipes fillon me fiksimin e saj në shkrim, pasi deri atëherë ka mbijetuar si gjuhë e folur, por dokumentimi i saj në shkrim, sigurisht, që e ka një kohë lindjeje. Veç dokumentimit të vonët me shkrim, gjuha shqipe, u përball me vështirësi të shumta gjatë zhvillimit të saj. Për ta mbajtur gjallë dhe më pas për ta zhvilluar atë, janë angazhuar figura të shquara të popullit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të profesioneve dhe formimeve të ndryshme: intelektualë, veprimtarë të lëvizjes kombëtare apo dhe klerikë të besimeve të ndryshme.

Kontributi i klerikëve katolikë shqiptarë në kulturën dhe gjuhën shqipe është i vërtetuar. Këtë e dëshmojnë veprat e tyre, të cilat janë një vlerë e shtuar në trashëgiminë letrare dhe gjuhësore shqiptare. Me shkrimet e tyre, bashkë me besimin fetar ata iu mësonin bashkatdhetarëve edhe gjuhën shqipe e cila në shekullin XV kërcënohej nga zhdukja, pasi deri në atë kohë mbijetonte vetëm si gjuhë e folur. Mund të përmendim Gjon Buzukun me *Mesharin* (1555), Pjetër Budin me *Doktrinën e Krishterë* (1618) dhe *Ritualin roman* (1621), Pjetër Bogdanin me *Çeta e profetëve* (1685), etj.²²² Jo më pak i vlerësuar është edhe kontributi i shoqërisë letrare «Bashkimi», të Shkodrës, e themeluar në vitin 1899. Pjesëtarë të saj ishin figura të shquara të kulturës dhe letërsisë shqipe si: Gjergj Fishta, Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, por edhe klerikë të devotshëm si Prenk Doçi, Ndoc Nikaj, Jak Serreqi, Lazër Mjeda, Pashk Bardhi, Mark Shllaku, Dodë Koleci, Ambroz Marlaskaj të cilët, veç vokacionit fetar, kultivonin me pasion edhe atë patriotik. E fshehur nën petkun fetar (për kohën ishte e ndaluar ngritja e shoqërive kulturore), shoqëria zhvillonte veprimtari në dobi të çështjes kombëtare dhe të gjuhës e kulturës shqipe, në programin e të cilës ishin përcaktuar disa detyra: hartimi i një alfabeti, i një fjalori dhe i një gramatike të gjuhës shqipe, i një abetareje dhe teksteve mësimore, botim i letërsisë artistike apo nxjerrja e ndonjë periodiku.²²³

Sipas Justin Rrotës, kjo ishte shoqëria e parë në Shqipëri që themelohej enkas për t'u marrë sistematikisht me çështjen e gjuhës shqipe.²²⁴

221 Eqerem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Çabej, Tiranë, 2008, f. 10.

222 Gaetano Petrotta, *SVOLGIMENTO STORICO DELLA CULTURA E DELLA LETTERATURA ALBANESE. Studi di storia della letteratura Albanese*, Mirror, Palermo, 2003, f. 28.

223 Tomor, Osmani, *Udhë e shkronjave shqipe: histori e alfabetit*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008, f. 412.

224 Justin, Rrota, *Për historinë e Alfabetit Shqyp*, Shtypshkronja Franceskae, Shkodër, 1936, f. 80.

Veprimtaria e shoqërisë «Bashkimi»²²⁵ nuk u ndal vetëm te alfabeti dhe fjalori i saj. Sipas pohimit të gjuhëtarit Jup Kastrati, veç prodhimtarisë, pjesa më e madhe e këtyre botimeve shquhen për gjuhën e pastër dhe një terminologji relativisht të mirë dhe mjaft të njësuar, e cila vazhdoi deri në Komisinë Letrare (1916).²²⁶

Shqipja dhe alfabetet e saj para vitit 1879

Para se të ndalemi te Fjalori i «Bashkimit», le të hedhim pak dritë mbi problemin e alfabetit, pasi është shumë e rëndësishme të theksojmë se kjo shoqëri kishte përpiluar një alfabet të vetin, i cili kishte një rëndësi jo të vogël në problemin e gjuhës shqipe në atë periudhë dhe në përpjekjet e mëdha që intelektualët dhe nacionalistët shqiptarë të kohës bënin për njësimin e alfabetit dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.

Në periudhën para vitit 1879, në Shqipëri, gëlonin shumë alfabete të gjuhës shqipe, pasi çdokush që shkruante përdorte alfabetin e vet, fenomen që përveçse shkaktonte kaos te lexuesi shqiptar, ndikonte negativisht edhe në mbarëvajtjen e gjuhës shqipe, edhe në çështjen e unitetit kombëtar. Në Veri përdorej alfabeti i Autorëve të vjetër (Buzuku, Matranga, Budi, Bardhi, Bogdani)²²⁷. Bejtexhinjtë përdornin alfabetin arab (Nezim Frakulla, Sulejman Naibi dhe Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Kyçyku etj)²²⁸. Në Jug *Shoqata Biblike Joniane*, Korfuz (1824)²²⁹, *Bleta Shqiptare* e Thimi Mitkos²³⁰ dhe Kristoforidhi në veprat e tij përdornin alfabetin grek, të cilin e kishin plotësuar me disa shkronja konvencionale të sajura po mbi bazën e këtij alfabeti. Madje, ky i fundit, në tekste të shkruara në dialektin toskë në alfabetin e tij kishte futur edhe disa shkronja latine /b/, /d/, ndërsa në tekste që shkruante në dialektin gegë përdorte alfabetin latin ku kishte futur edhe disa shkronja greke /v, δ/, për /th, dh/. Nëse do të shtojmë këtu edhe alfabetet origjinale të Dhaskal Todrit, Naum Veqilharxhit, Hoxhë Tahsinit e Vasil

225 Vetë shoqëria «Bashkimi», në 10-vjetorin e themelimit të saj në gazetën *LA NAZIONE ALBANESE*, Pallagorio (Catanzaro), më 30 shtator 1908, viti XII, Nr.18, boton një afrikull me titull «Vllazënvët Shqypëtarë». Diftim, ku paraqet veprimtarinë 10-vjeçare të saj, programin, qëllimin si dhe veprat e botuara me alfabetin e saj. 31 vepra dhe 21 gazeta e revista. Në artikull shprehet gadishmëria e shoqërisë për bashkëpunim me shoqërinë e «Stambollit» dhe «Agimin» për hartimin e një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Palok Lulash Daka, Tomor Osmani, Maks Gjinaj, *BIBLIOGRAFI PËR HISTORINË E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE 1844-2008*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 50-51.

226 Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Konferenca e parë e studimeve Albanologjike, 15 – 21 Nëntor 1962*, Tiranë 1965; f. 227. Jup Kastrati, Shoqëria «Bashkimi» e Shkodrës (1899).

227 Justin Rrota, *Për historinë e Alfabetit Shqyp*, Shtypshkronja Franceskane, Shkodër, 1936, f. 65.

228 Roumen Daskalov & Tchavdar Marinov, *Entangled Histories of the Balkans – Volume One*, BRILL, Leiden, 2013, f. 494-495.

229 Robert Elsie, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë & Pejë: Dukagjini 1997, f. 68.

230 Po aty, f. 150.

Dhimitri Rusos, mund ta kuptojmë fare mirë situatën para së cilës mund të gjendej lexuesi shqiptar i kohës.²³¹

Për të dalë nga një situatë e tillë, në Stamboll, një grup patriotësh shqiptarë, vendosën për një alfabet të përbashkët, i njohur si «Alfabeti i Stambollit». Çështja e alfabetit hapi debat midis tyre pasi kishte mendime të ndryshme për llojin e alfabetit që do të përdorej. Kishte propozime për alfabetin arab, për alfabetin grek dhe për alfabetin latin. Në fund u vendos për alfabetin latin (me 36 shkronja) i cili u ndërtua mbi parimin *një shkronjë për një tingull*, nuk kishte dyshkronjësha, por kishte disa shkronja greke, çka e bënte mjaft kompleks dhe të vështirë për botim. Pavarësisht vështirësive, «Alfabeti i Stambollit» u përhap gjerësisht në Shqipërinë Jugore e të Mesme midis myslimanëve dhe ortodoksve, por edhe në koloni shqiptare të mërgimit në Stamboll, Bukuresht e Sofje. Me të u shtypën abetare, gramatika dhe libra të tjerë shkollorë. Me të shkruan vëllezërit Frashëri, Jani Vreto, të përkohëshmet «Drita» në Stamboll, «Drita» në Bukuresht dhe «Mbrothësia» në Sofje etj.²³²

Në vitin 1899 edhe shoqëria «Bashkimi» hartoi alfabetin e saj, i cili u bazua mbi sistemin e shkrimtarëve të vjetër, por aty ku për tinguj të veçantë të shqipes ata përdornin shenja të veçanta, autorët e «Bashkimit» përdorën bashkëtingëlloren glotale /h/, që çoi në formimin e bashkëtingëlloreve dyshe. Edhe Faik Konica ka ndjekur shembullin e alfabetit të «Bashkimit», edhe ai e përdori glotalen /h/ për të formuar shkronja dyshe, përdori /rh/ për /rr/ dhe /lh// për /ll/, /ç/ për /ç/ dhe /ñ/ për /nj/.²³³ Parimi bazë mbi të cilin u ndërtua alfabeti ishte që një fonemë mund të formohej nga dy shkronja. Ky parim ishte zbatuar më parë edhe nga autorët të vjetër shqiptarë apo edhe nga Zef Jubani e Pashko Vasa. Tomor Osmani gjen pika takimi midis alfabetit të «Bashkimit» dhe alfabetit të Zef Jubanit (1871). Sipas tij, midis tyre 25 shkronja janë të njëjta dhe 11 janë të ndryshme (/c/, /ç/, /gj/, /ll/, /nj/, /q/, /rr/, /x/, /xh/, /z/, /zh/). Me alfabetin e «Albanisë» të Faik Konicës (1897), 26 shkronja janë të njëjta dhe 10 janë të ndryshme (/c/, /ç/, /ll/, /nj/, /q/, /rr/, /x/, /xh/, /z/, /zh/). Ndërsa nga Pashko Vasa mendohet të ketë marrë /é/, /e/, /rr/, /sh/ për shkronjat /e/, /ç/, /rr/, /sh/ dhe nga Jubani /gh/, /gn/, /x/, për /gj/, /nj/, /z/, etj.²³⁴

Në librin e tij *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Justin Rrota dallon disa karakteristika dhe vlera të fjalorit të «Bashkimit»²³⁵:

1. trajtimin sistematik të gjuhës;
2. mbështetjen në shkronjat latine;

231 Shaban Demiraj, Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2008, f. 19-21.

232 Justin, Rrota, *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shtypshkronja Franceskane, Shkodër, 1936, f. 66-67.

233 Justin, Rrota, *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shtypshkronja Franceskane, Shkodër, 1936, f. 82.

234 Tomor, Osmani, *Udhë e shkronjave shqipe: histori e alfabetit*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2008, f. 415.

235 Justin, Rrota, *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shtypshkronja Franceskane, Shkodër, 1936, f. 80-82.

3. futjen e germës /h/ dhe krijimin e germave të reja dyshe /dh/, /th/, /sh/, /xh/, /zh/, /ch/ (ç), /gh/ (gj);
4. dyfishimin e zanoreve të gjata;
5. mungesën e zanores /ë/;
6. përdorimin e shkronjave latine /gn/ për /nj/, /nn/ për /nd/, /l/, /ll/, /ll/, /ts/ për /c/, /c/ për /q/;
7. zëvendësimin e germës /j/ me zanoren /i/;
8. vendosjen e theksit të mprehtë në zanoren /e/ të zëshme;
9. praktikitetin, pasi librat mund të shtypeshin në çdo shtypshkronjë;
10. rëndësinë e madhe që fjalori ka për dialektologjinë shqipe, pasi është i bazuar në të folmen e Shkodrës;
11. botimin e tij me financime austriake.

Megjithatë, hartuesit e alfabetit ishin të vetëdijshëm për mangësitë që ai kishte nga pikëpamja shkencore dhe nuk pretendonin se ishte «ma i miri e ma i përkryemi». Ai u përdor jo vetëm për tekste shkollore, por edhe nga shkrimtarë të të dyja dialekteve gegë (Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi) e toskë (Çajupi, Asdreni, Skiroi, Konica). Çfarë nuk dilte me alfabetin e Stambollit botohej me alfabetin e «Bashkimit».²³⁶

Vetëm dy vjet pas shoqërisë «Bashkimi», edhe shoqëria «Agimi», nën drejtimin e Mjedës, hartoi një alfabet i cili kishte gjetur mbështetjen e episkopatës katolike të Shkodrës dhe shumicës së priftërinjve. Edhe ky alfabet, si ai i Stambollit, u bazua në parimin një tingull një shkronjë, por eliminoi shkronjat greke të tij /v, ð/ dhe për të nxjerrë tinguj të posaçëm nga germat latine përdori theksin e mprehtë /ĝ/ për /gj/, /k/ për /q/, /n/ për /nj/, ndërsa për zanoren /ë/ përdori /e/ e përmbytur /ə/ dhe për hundoret theksin e lakuar, cirkumflex /â/. Ky alfabet nuk ishte praktik në botim, për shkak të shkronjave, megjithatë me të u botuan disa tekste shkollore, kalendari «Dija» (1906), në Vjenë, fletorja «Dashamiri» në Trieste edhe ndonjë libër tjetër.²³⁷

Alfabetet e tjera me shkronja latine, por të ndryshëm midis tyre përdornin edhe Faik Konica, «Kombi» i Bostonit, «Besa», «Shqipëria», «Pellazgu» Disa intelektualë shqiptarë (si Pashko Vasa, Faik Konica, shoqëria «Bashkimi»), këmbëngulën që alfabeti të ishte praktik, pra të shtypej lehtë dhe u përpoqën ta mbajnë alfabetin e tyre sa më të afërt me ata në Evropën Perëndimore. Të tjerë zbatuan parimin “një tingull - një shkronjë” dhe përdornin shkronja nga alfabetet e tjera (vëllezërit Frashëri) ose diakritikë (shoqëria Agimi). Deri në këtë kohë, përdorimi i një alfabeti mbeti një zgjedhje individuale e secilit, pa mbajtur një qëndrim të qartë në debatin mbi alfabetin.²³⁸

236 Po aty, f. 81.

237 Justin Rrota, *Për historin e Alfabetit Shqyp*, Shtypshkronja Franceskane, Shkodër, 1936, f. 86-87.

238 Roumen Dontchev Daskalov, Tchvdar Marinov, *Entangled Histories of the Balkans*, BRILL, London, 2013, f. 503.

Kongresi i Manastirit dhe alfabeti njësues

Në këtë situatë kaotike për gjuhën shqipe, dëshira dhe nevoja akute për një alfabet të njësuar i shtyu anëtarët e shoqërisë «Bashkimi» t'i bashkoheshin nismës për mbajtjen e një kongresi për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së alfabetit. Kongresi u mbajt në qytetin e Manastirit, në Maqedoni, më 14-22 nëntor 1908. Në të morën pjesë tridhjetë e dy delegatë (laikë dhe klerikë) me të drejtë vote, midis tyre kishte shkrimtarë, studiues e publicistë, veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe klubeve shqiptare, si Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Dhimitër Buda, Mithat Frashëri, Hilë Mosi, Mihal Grameno etj. Veç tyre morën pjesë edhe tetëmbëdhjetë delegatë pa të drejtë vote, duke e shndërruar kështu kongresin në një kuvend mbarëshqiptar, pasi çështja e alfabetit nuk ishte vetëm gjuhësore, por ishte e rëndësishme edhe për të arritur unitetin kombëtar. Kongresi mori në shqyrtim: alfabetin e shoqërisë «Bashkimi», alfabetin e «Stambollit» dhe alfabetin e shoqërisë «Agimi».

Zgjedhja e një alfabeti njësues ishte shumë e vështirë dhe hapi debat të madh, prandaj u vendos të ngrihej një komision prej njëmbëdhjetë vetësh që të vendosnin për versionin përfundimtar. Me gjithë përçarjet, kundërshtitë dhe paaftësisë për të arritur një mirëkuptim (kujtojmë se debati për alfabetin zgjaste që nga vitet 1870) palët bashkoheshin në një pikë, që alfabeti të kishte për bazë shkronjat latine. Debatet ishin mbi dilemën se nga çfarë duhej të përbëhej alfabeti. A duhej të përmirësohej me shkronja të alfabeve të tjera? A duheshin përdorur diakritikët apo digrafet?²³⁹ Alfabeti duhej të ishte i ri, kombinim i tre alfabeve apo do adoptohej ndonjëri prej tyre?

Komisioni ra dakord për një alfabet të ri, me shkronja latine, të cilave t'iu jepej vlera fonetike në përputhje me kërkesat e gjuhës shqipe, por nuk ra dakord për disa shkronja për tingujt e shqipes që i mungonin latinishtes, si: /dh/, /gj/, /ll/, /nj/, /sh/, /th/.²⁴⁰ Në këto kushte, komisioni i përzgjedhur vendosi të mbështesë dy variante: një variant të ndryshuar të alfabetit të Stambollit dhe një alfabet latin, pothuaj të ngjashëm me alfabetin e shoqërisë «Bashkimi», që u konsiderua si më praktik për shtypjen e librave jashtë Shqipërisë.²⁴¹ Alfabeti i Manastirit, më shumë se për vlera shkencore shquhej për kompromisin, ai ishte një shartim i alfabetit të Stambollit me atë të «Bashkimit», ku ky i fundit kishte përparësi pasi ishte mbi bazën e shkronjave latine. Gjithashtu, për të ruajtur kompromisin u mor diçka edhe nga fjalori i De Radës. Sipas Justin Rrotës elementët kryesorë të këtij alfabeti të koalicionit ishin²⁴²:

239 Po aty, f. 503-504.

240 Demiraj, Shaban, Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 2008, f. 95-98.

241 Elsie, Robert, *Historical Dictionary of Albania*, Second edition, Jon Woronoff, Series Editor, Toronto, 2010, f. 89.

242 Po aty, f. 90.

1. nga alfabeti i «Bashkimit» (gegë): *dh, th, ll, rr, sh*;
2. nga alfabeti i «Stambollit» (toskë): *y, ç, c, q, z, x*;
3. nga alfabeti i De Radës (italo-shqiptar): *ë, gj, nj*.

Nisma për përcaktimin e këtij alfabeti të përbashkët sillte disa zhvillime pozitive për kohën: në lidhje me kulturën shqiptare, zgjeronte mundësinë e receptimit të njëtrajtshëm të saj në arealin shqipfolës, por jo vetëm, pasi bënte njësimin ortografik të kombit²⁴³; në lidhje me gjuhën, përfaqësonte më mirë fonetikisht zanoret dhe bashkëtingëlloret e shqipes; ndërsa baza e tij me shkronja latine lehtësonte kontaktet e shqiptarëve me jetën moderne dhe me mendimin e Evropës Perëndimore.²⁴⁴

Alfabeti i «Bashkimit» dhe kritika e kohës

Dalja e alfabetit të «Bashkimit» nxiti polemika edhe në shtypin shqiptar të kohës, botuar jashtë vendit. Në revista e periodikë kishte shkrime që e miratonin dhe shkrime që e kritikonin. Më poshtë, në vijë kronologjike, po japim disa vlerësime që bëheshin në shtypin e kohës për fjalorin e «Bashkimit».

Në revistën «Albania» të Faik Konicës, në Bruksel, në vitin 1899, është botuar shkrimi «TË RA: Shoqëria e Bashkimit», ku në faqen 101 të tij njoftohet së shoqëria «Bashkimi», e themeluar në Shkodër, kishte hartuar një abece (alfabet) që ndryshon pak nga ai i «Albanias», dhe se me marrëveshje synojë afrimi midis këtyre dy alfabeve. Ndërsa në vitin 1900, në nr.17 të revistës «Albania e vogël», në Bruksel, në faqen 4 të saj njoftojë mbi adoptimin e alfabetit të shoqërisë «Bashkimi» në të përkohshmet «Albania» dhe «Albania e Vogël».²⁴⁵ Nga sa shihet, Faik Konica ishte një nga mbështetësit e tij. Duke analizuar alfabetet e deriatëhershme ai gjykoi se alfabeti i Autorëve të vjetër të Veriut kishte të meta, disa shkronja të tij nuk gjendeshin në shtypshkronja dhe se nuk ishte i mjaftueshëm për toskërishten. Ndërsa alfabetin e Stambollit e gjente të papërshtatshëm për të qenë alfabeti njësues i shqipes, pasi kishte shumë të meta, përzierje shkronjash greke, sllave e latine. Si përfundim, megjithëse me të meta, për Konicën më i përshtatshëm ishte alfabeti i «Bashkimit».

Veç mbështetjes dhe miratimit, alfabeti i «Bashkimit» kishte edhe kundërshtarë të cilët shprehnin mendimin në shtypin e shkruar. Atdhetari i Kosovës (pseudonimi i Mati Logorecit), në artikullin *Mennime përmi shkrim të gjuhës kombëtare*, në revistën Albania, Bruksel, 1900, Viti IV, Nr. 1, e quante shoqërinë «Bashkimi» të Shkodrës «Shoqnia e t'shpërndamit e t'degamit të gjuhës» dhe njëkohësisht kritikoi alfabetin

243 Lloshi, Xhevat, *Rreth alfabetit të shqipes: me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit*, Logosa, Shkup, 2008, f. 25.

244 Po aty, f. 27.

245 Palok Lulash Daka, Tomor Osmani, Maks Gjinaj, *BIBLIOGRAFI PËR HISTORINË E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE 1844-2008*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 26-27.

e saj.²⁴⁶ Ndërsa në korrespondencën e botuar në gazetën *LA NAZIONE ALBANESE* Pallagorio (Catanzaro), 1904, viti VIII, Nr.12 një letër e monsinyor P. Guerinit, arqipeshkv i Shkodrës, njoftonte se kishte mbajtur një banket me pjesëmarrjen e shumë perlatëve të Shkodrës dhe Durrësit, me qëllim që të krijonin një bllok unik rreth alfabetit të Mjedës dhe kundër alfabetit të «Bashkimit».²⁴⁷

Holger Pedersen pëlqente botimet e «Bashkimit», por si alfabet zgjidhte atë të revistës «Albania». Kujtojmë këtu se «Albania», në vitin 1899 dhe 1901 ishte shprehur për afrim dhe adoptim të alfabetit të «Bashkimit», ndërsa në vitin 1904, në artikullin me titull *Problemi i shkrimit të gjuhës shqipe, i vënë në vend të vërtetë të tij*, botuar në numrin 12 të revistës «Albania» të Londrës, pohon se do t'i hiqte edhe ato pak dallime që kishte në disa shkronja me alfabetin e «Bashkimi», duke qenë se ai qe pranuar nga një pjesë e mirë e shqiptarëve, dhe, veç Shkodrës qe përhapur edhe në Elbasan, Stamboll, Rumani etj.

Alfabetin e «Bashkimit» e mbështeste edhe Asdreni. Në një shkrim të revistës «Albania», në Londër (1905), me titull *Çështja e alfabetit*, Asdreni pohonte se gjuhës shqipe i nevojitej një alfabet me shkronja latine dhe se më i përshtatshëm i dukej ai i shoqërisë «Bashkimi».

Por alfabeti i «Bashkimit» i kishte kaluar kufijtë edhe drejt Italisë. Në artikullin *Questioni ortografike* [Çështje drejtshkrimore], në gazetën *LA NAZIONE ALBANESE*, Pallagorio (Catanzaro) 1904, që trajtonte çështje të alfabetit të shqipes dhe drejtshkrimit, shoqëria «Bashkimi» konsiderohej si një nga tre institucionet më të rëndësishme për gjuhën shqipe, bashkë me revistën «Albania» e Londrës dhe «Shqiptari» i Bukureshtit, alfabetet e të cilave janë bazuar në shkronjat latine. Autori i shkrimit shprehte parapëlqimin për alfabetin e «Bashkimit» dhe këshillën që të plotësohej me siglat *mb*, *nd*, *dxh*.²⁴⁸

Alfabeti i «Bashkimit» gjeti mbështetje edhe nga shqiptarët e Amerikës. Kështu, Dok Sula (pseudonimi i Aleksandër Xhuvanit) në artikullin *Çështja e Abesë*, Kombi, Boston, 1907, vëll. II, Nr.37, pohonte karakterin indoevropian të gjuhës shqipe dhe në lidhje me alfabetet vihej në favor të atij të shoqërisë «Bashkimi». Duke sqaruar arsyet e këtij pëlqimi këshillon edhe disa ndryshime (ndërrime shkronjash /c, x, xh, dxh/ me /kj ose q, z, zj, zh, dz) me qëllim që të bëhej më i përshtatshëm.²⁴⁹

246 Po aty, f. 27.

247 Po aty, f. 35.

248 Po aty, f. 31-36.

249 Po aty, f. 44.

Tradita e fjalorëve dygjuhësh deri në vitin 1908

Në vitin 1908, shoqëria «Bashkimi», hartoi *Fjaluer i Rii i Shcypes*. Nën pushtimin osman fjalorët shërbyen për të ruajtur dhe kultivuar gjuhën shqipe dhe bashkë me tekstet e tjera (përkthime apo përshtatje liturgjike, poezi) formonin lëndën e parë letrare shqiptare. Hartimi i fjalorit «Bashkimi» u bë nën dritën e programit të Rilindjes Kombëtare për kultivimin e gjuhës shqipe të shkruar letrare dhe zhvillimit të studimeve albanistike.²⁵⁰

Ky fjalor ka disa pararendës: fjalorin latinisht-shqip të Frang Bardhit *Dictionarium latino-epiroticum, una cum nonnullis usitatoribus loquendi formulis* (1635), me 5640 zëra latinisht të përkthyer në shqip, përfshirë edhe një shtojcë me pjesë të ligjëratës, me proverba dhe me dialogë. Në parathënien e veprës së vet Bardhi pohon se qëllimi i hartimit të këtij fjalori është ruajtja e gjuhës shqipe nga “bastardimet” dhe ndihmesa për klerin e Kishës së Shenjtë Katolike që të mësonte latinishten.²⁵¹ Pas tij u hartuan edhe 100 fjalorë të tjerë, gjysma e të cilëve as që u botuan ndonjëherë. I konsideruar si zanafilla e leksikografisë shqiptare, fjalori i Frang Bardhit, ka qenë një nga burimet e fjalorit të «Bashkimit».

Fialuur i voghel, sccō p e ltinisct është hartuar nga Jak Junku dhe është botuar në Shkodër, në vitin 1895, me 200 faqe. Në parathënien e tij Junku ka pohuar se e ka hartuar fjalorin me qëllimin që të gëzojë misionarët italianë, të cilët shpesh kanë promovuar interesat e Zotit dhe Kishës së tij në Shqipëri.²⁵² Struktura e tij përbëhet nga një parathënie, katër pasqyra (e para, ka shpjegime të tipit fonetik për mënyrën se si shqiptohen tingujt; e dyta, për emërtimet gramatikore; e treta, për termat shkencor; e katërta, për simbolet dhe shpjegimet e shkurtimeve) dhe glosari. Fjalët në shqip janë në trajtën e pashquar, ndjekur nga trajta e shquar, shënimet gramatikore, trajta e shumësit dhe në fund fjalët gjegjëse në italisht. Për mbiemrat (në rastin kur janë të nyjshëm) pas trajtës përfaqësuese jepen nyjet e mbiemrit, shënimi gramatikor dhe fjala gjegjëse në italisht. Për të gjitha fjalët ndiqet gati e njëjta skemë, që nga sa duket është fare e thjeshtë. Edhe ky fjalor është shfrytëzuar nga autorët e fjalorit të «Bashkimit» si burim për vjeljen e literaturës.

Në vitin 1904 u botua *Lexikon tës albanikës glossesi (Fjalori i gjuhës shqipe)*, i Konstandin Kritoforidhit, pas vdekjes së tij, i bazuar në shkronjat greke, një lloj specifik i fjalorit shqip, që gjithashtu njëherazi shërbeu si fjalor dygjuhësh. Kjo trashëgimi e leksikografisë shqiptare, e ruajtur në dorëshkrime, ka qenë në fjalorë dygjuhësh apo shumë gjuhësh. Sipas Xhevat Lloshit, një fenomen i tillë ka ndodhur edhe në vende të

250 Xhevat Lloshi, *Compiling and Editing Bilingual Dictionaries in Albania*, BUDALEX, 1990, f. 479-487.

251 Robert, Elsie, *Historical Dictionary of Albania, Second edition*, Jon Woronoff, Series Editor, Toronto, 2010, f.33.

252 Junku, Jak, *Fialuur i voghel, sccō p e ltinisct*, Shkodër, 1895, f. V.

tjera, por në Shqipëri kishte disa arsye të veçanta²⁵³:

së pari, fjalorët ishin mjeti për të ruajtur dhe kultivuar gjuhën shqipe, kur ajo kërcënohej nga zhdukja gjatë sundimit otoman;

së dyti, zhvillimi i gjuhësisë historike - krahasuese, e cila tërhoqi interesin e gjuhëtarëve evropianë në gjuhën shqipe, nxiti krijimin e fjalorëve, (bashkëpunim i Kostandin Kristoforidhit me Johann Georg von Hahnin për hartimin e fjalorit të tij);

arsyeja e tretë është politike, hartimi i fjalorëve është mbështetur nga fuqitë evropiane, të cilat interesoheshin për fjalorët dygjuhësh, sepse përmes tyre përpiqeshin të përhapnin gjuhën e tyre për të rritur ndikimin në Shqipëri.

Kujtojmë këtu mbështetjen që dhanë austro-hungarezët apo italianët për botimet e teksteve të shoqërisë «Bashkimi» apo «Agimi».²⁵⁴

Në këtë situatë filluan të botoheshin fjalorë dygjuhësh për italishten, anglishten, gjermanishten, por duke veçuar fjalorin e Kristoforidhit, fjalorët e tjerë mbështeteshin në një bazë të ngushtë dialektore. Nga sa shohim, fjalorët pararendës janë hartuar me qëllim që t'u vinin në ndihmë misionarëve të huaj për të përhapur besimin fetar në Shqipëri.

Fjaluer i Rii i Shcypes

Fjaluer i Rii i Shcypes është produkt i veprimtarisë kulturore dhe gjuhësore të shoqërisë «Bashkimi» dhe i alfabetit që hartoi kjo shoqëri. Për hartimin e tij dhanë kontributin e tyre Dodë Koleci, Gjergj Fishta, Mark Shllaku, Pashk Bardhi, Mihal Bushati, Gjergj Koleci e Ndoc Nikaj²⁵⁵. Ai u përdor për tekste shkollore të shkollave katolike subvencionuar nga qeveria austro-hungareze, pasi përpjekjet e shqiptarëve për të njësuar alfabetin e tyre dhe përdorimin e gjuhës kombëtare në shkolla përkonin me interesat e politikës austro-hungareze për të forcuar ndikimin e saj në Shqipëri.²⁵⁶ Ky

253 Xhevat, Lloshi, *Compiling and Editing Bilingual Dictionaries in Albania*, BUDALEX, 1990, f. 479-480.

254 Në artikullin “La questione dell’alfabeto albanese”, [Çështja e alfabetit të shqipes], botuar në gazetën *LA NAZIONE ALBANESE*, Pallagorio (Catanzaro), më 15 nëntor 1901, nga Ali Efendi (pseudonim), bëhej e ditur se Shoqëria «Bashkimi» ishte themeluar në Shkodër dy vjet më parë me iniciativën e qeverisë austriake, dhe se e inkurajuar nga konsulli austriak Ippen kërkon t’ua imponojë alfabetin e saj të gjitha shkollave të Shqipërisë së Epërme. Palok Lulash Daka, Tomor Osmani, Maks Gjinaj, *Bibliografi për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe 1844-2008*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 29.

255 Xhevat Lloshi, *Parathënie e botimit anastatik në «Fjalori i Bashkimit»*; botim anastatik i “*Fjaluer i Rii i Shcypës*”: *perbâam Préie Shocniët t’Bashkimit*/përg. Nikë Ukgjini, Frano Kulli, Gjergj Fishta, 2008, f. VI.

256 Stavro Skendi, *The Albanian National Awakening 1878-1912*, Princeton University Press, 1967, f. 275.

fjalor konsiderohet nga të parët fjalorë dygjuhësh, pasi shumë fjalë të tij shpjegohen vetëm përmes italishtes. Ai ka 538 faqe dhe përmban 13482 fjalë (10017 prej të cilave gjenden edhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të vitit 1980).²⁵⁷ Lënda e tij është bazuar në të folmen e shkodrane, në trashëgiminë e veprës së shkruar nga Autorët vjetër të Veriut, por edhe nga studiues të huaj dhe albanologë.

Po cësim n'drite ket fialuer m' t' tsillin kémi mlédhe mâa t'shumen, saa ku kémi muite, t'atyné fialvé sikursé flitén nneper ghytété, fusha e malé t'dashtunés atmés s' one. Mas ktyné, kémi pase kuidés me shtû mrênne edhê ato ci ghinnén t' shtypuna n' libra, n' fialore e n' shkrimé t' shnnrichemvé diétarevé t' one e t' hueivé ci acme xélle iâne munnue me i dhâne shkelzim e hiiéshii giuhes s' one, sikursé Dom Piéter Budi, Êmx. Frang Bardhi, Êmx. Piéter Bogdani, Gustav Meyer-i, Ate Iake Iungg-u, Konstantin Kristoforidhi, e disaa tière t' tashém edhê mâa. Fialet t' cituna rishtas e t' perbâamé, saado ci shifén shpesh sidomos nneper flétoré e viérsha, pak se dukén e u iémi rueitun tui i paa giasen me i lâne per gni tiéter t' shpallun mâa t' péshuem t' ktii Fjalorit t' Bashkimit.²⁵⁸

Qëllimi parësor i hartuesve të *Fjaluer i Rii i Shcypes*, ka qenë krijimi i një fjalori shqip, siç e përcakton edhe titulli i veprës, por duke qenë se shumë fjalë shpjegohen vetëm në italisht fjalori është konsideruar si dygjuhësh. Në parathënie, autorët kanë shprehur besimin se me zhvillimin e gjuhës, kur të bëhet ribotimi i tij nuk do të jetë më nevoja për përkthimet në italisht. Pra metagjuha e fjalorit është shqipja, por shpjegimet janë në shqip dhe italisht, ndërsa ka edhe fjalë që iu mungon shpjegimi në shqip dhe shpjegohen vetëm në italisht.

Në strukturën e fjalorit përveç zërave të tij ka edhe tri pasqyra për të lehtësuar përdorimin e fjalorit, të cilat japin informacion në tri nivele: sociolinguistik (pasqyra e parë, parathënia jep shpjegime për mbledhjen e leksikut, se ai është bazuar në gjuhën e folur të Shkodrës, por edhe të shkruar në veprat e Autorëve të vjetër shqiptar, si: Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani dhe studiuesve të huaj të shqipes si Gustav Majeri, Jak Junku etj); thjesht gjuhësore (pasqyra e dytë, jep disa vëzhgime mbi sasinë e shkronjave gjithsej 34 nga të cilat 6 zanore dhe, pozicionet e theksit, llojet e tij dhe përdorimet), dhe gjuhësore - kulturore (pasqyra e tretë, shpjegon simbolet dhe fjalët e shkurtuara). Fjalori përfundon me një shtojcë.

Shumë interesante është pasqyra që shpjegon shkurtime të fjalëve, sepse sjell një vlerë në leksikologjinë dhe dialektologjinë shqiptare për mënyrën se si emërtoheshin në atë kohë klasat e fjalëve:

257 Xhevat Lloshi, *Compiling and Editing Bilingual Dictionaries in Albania*, BUDALEX, 1990, f. 479-487.

258 “PARATHËNIË në FIALUER i Rii i Shcypés”, «Fjalori i Bashkimit»: botim anastatik i «Fialuer i Rii i Shcypés»: perbâam Préie Shocniét t' Bashkimit/përg. Nikë Ukgjini, Frano Kulli, Gjergj Fishta, 2008, f. V.

vm. - vétpasuer mashkulluer (emër mashkullor);
 vf. - vétpasuer fémnuer (emër femëror);
 va. – vétpasuer asgnânxe (emër asnjnës);
 persh. – pershtueshem (mbiemër);
 persh. m. - pershtueshem mashkulluer (mbiemër mashkullor);
 persh f. - pershtueshem fémnuer (mbiemër femëror);
 persh. – pershtueshem asgnânxe (mbiemër asnjnës);
 parf. – parftillik (ndajfolje);
 shum. – shumuer (shumës);
 vech. – véchuer (njëjës);
 lidh. – lidhtoré;
 ftvep. – ftillik vépruer (folje veprorë);
 ftas. – ftillik asgnânxe (folje anjëanëse);
 ftvepas. - ftillik vépruer asgnânxe (folje veprorë asnjnëse);
 ftper. – ftillik perpaltuer (folje refleksi);
 ft. – ftillik (folje).

Ajo që bie në sy është numri i madh i fjalëve të huazuara. Rreth 1440 janë vlerësuar turqizmat, gati 12 për qind të lëndës. Xhevat Lloshi (në parathënien e Fjalorit të «Bashkimit», botimi anastatik i vitit 2008), pohon se disa nga recensuesit e kanë vlerësuar si një të metë të fjalorit dhe kanë kërkuar heqjen e tyre, por sipas tij autorët i kanë evidentuar dukshëm fjalët e huazuara dhe pastrimi i tij nga të gjitha fjalët e huaja nuk do të ishte veprimi më i dobishëm. Jashtë fjalorit janë lënë neologjizmat me synimin për t'u futur në një ribotim të fjalorit, por ky synim nuk u realizua dot.

Fjalori kodifikoi leksikun e shqipes dhe përbën një vlerë të shtuar të leksikologjisë shqipe. Ai përfshin një lëndë deri diku të zgjedhur. Fjalët jepen në çerdhen e tyre, d.m.th emri, mbiemri, folja, ndajfolja, emrat foljorë nga e njëjta rrënjë p.sh., *ashpër* (*i, e, t'*), *ashprim-* *i*, *ashproj*, *ashpruem* (*i, e, t'*), *ashpruemit* (*t'*)²⁵⁹ etj. Në fjalësin (glosarin) e tij, si kriter i renditjes së fjalëve është përdorur rendi i zakonshëm, pra fjalët janë vendosur sipas rendit alfabetik. Fjalët janë vënë në trajtën përfaqësuese të tyre dhe janë shoqëruar me shënimet gramatikore për pjesën e ligjëratës:

emrat (vm, vf, va, shkurtimet për emrin mashkullor, femëror dhe asnjnës) janë vënë

259 Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, TOENA, Tiranë, 2006, f. 319.

në rasën emërore numri njëjës, trajta e pashquar, më pas vjen trajta e shquar ndjekur nga shënimet gramatikore dhe në fund trajta e shumësit dhe shpjegimi në italisht p.sh., **Arke**, a, vñ. shum. arke-t, josë arka-t. cassa; **Burre**, i, vñ. shum. burra-t. Uomo: personaggio; **Mialte**, i, mialte, a e mialte-t, vñ. vñ, e va. shum. mialta-t. Miele.

mbiemrat (persh., shkurtimi për mbiemrin), janë vënë në trajtën e numrit njëjës të gjinisë mashkullore dhe në kllapa janë vendosur nyjet për mbiemrat e nyjshëm, p.sh., **Bleert**, (i, e, t'), persh. Verde, il verdeggiare; **Bukur** (i, e, t'), persh. Bello-a; **Dukshem**, (i, e), persh Appariscnte, di bella presenza, visibile; **Ghélber**, (i, e), persh. Verde.

Foljet (ft., shkurtim i foljes), janë vënë në mënyrën dëftore, në kohën e tashme, numri njëjës, veta e parë, më pas trajta e vetës së dytë, ndjekur nga trajta plotësuese e të kryerës së thjeshtë, shënimet gramatikore dhe në fund fjala gjegjëse në italisht bashkë me sinonimet nëse ka, p.sh., **Bertas**, bertéte, bertita, me bertite fivép.as. gridare, sgridare, strillare; **Flas**, flet, fola, me e m'u fole, fivép. i paa perm. Parlare; **Kshilloi**, on, ova, me e m'u kshillue, fivép. Consigliare; **Pùnoi**, on, ova, me e m'u pùnue, fivép. Lavorare, operare.

Fjalët e paeptueshme janë vendosur në formën e tyre të vetme shoqëruar nga shënimet gramatikore dhe shpjegimet në italisht, p.sh., ndajfoljet (parf., shkurtimi për ndajfoljen), **Fort**, parf. Moltissimo; **Kshtu** e keshtù, parf. In questo modo cosi.; **Pupthin**, parf. “Me ktsye a me etse”. Saltare o camminare a piè pari. Lidhëzat (lidh., shkurtimi për lidhëzat), p.sh.,, As, lidh. në; Por, lidh. Ma, solamente; Porsaa, lidh. Appena che, tosto che; Si, lidh. Come.

Veç shënimeve gramatikore, për fjalët e huazuara janë përdorur edhe simbole të veçanta (I) për italianizmat, p.sh., **Loilé** e lolé, persh. ci s'nnnerulét. (I), e mârre. Folle, pazzo; **Lokande**, a, vñ. shum. lokanda, t. (I). Locanda; T për turqizmat, p.sh., **Bichak**, u, vñ. shum. bichake, t. T. brisk, u; **Hardxh**, i vñ. shum. hardxhé, t. T.; S për sllavizmat, p.sh., **Ponise**, (S) (me m'u ponise), fivép.; **Kral**, i, vñ. shum. kralat, t. (S.) Rregh, i: Mret, i. Re. Janë përdorur simbole të tjera si: një pikëpyetje për fjalë që nuk ia dinin etimologjinë, p.sh., Posi? Parf. Come no?; **Shafaiét**, i, vñ. shum. shafaiéta, t(?). Gni fare mullagét e madhe. Malvone.

Janë përdorur shënime për të shpjeguar nga është marrë fjala, pasi në parathënie autorët kanë shpjeguar që, veç gjuhës së folur në fshat e në qytet, leksiku është vjelë edhe nga fjalorë pararendës si: (B) për Frang Bardhin, p.sh., **Cémal**, i, vñ. shum. cemala, t. (B.) Banditore; (Bu.) për Pjetër Budin, p.sh., **Aty**, parf. di, perfino. Aty e shtëta: perfino la bestia. (Bu.); (Bog.) për Pjetër Bogdanin, p.sh., **Kumét**, i, vñ. shu., Kumété, t. (Bog.) Notizia dhe (Kri.) për Konstandin Kristoforidhin.

Fjalori është organizuar sipas kësaj skeme fikse: fjala në trajtën e pashquar, trajta e shquar ose nyja formuese e mbiemrit, shënimet gramatikore, trajta e shumësit, shkurtimi i emrit të autorit nga është vjelë fjala, pas tyre në rastin e fjalës së huazuar vendoset simboli përkatës, shpjegimi në shqip ose sinonimet dhe në fund shpjegimi apo sinonimet në italisht dhe shembuj. Fjalët e huazuara dallohen nga simbolet: I – për fjalët italiane; S – për fjalët sllave; T – për fjalët turke; ? (!) – për fjalët që mund të kenë ardhur nga

gjuhë të tjera dhe ??? – për fjalë që nuk iu dihet domethënia. Jo të gjitha fjalët e fjalorit i përmbajnë këto elemente, por në përgjithësi ruhet ky rend.

Ndonëse është shkruar për marrësin shqiptar, për ata që nuk kanë njohuri të italishtes, ky fjalor ishte i padobishëm. Megjithatë, hartimi i këtij fjalori ishte një ngjarje e madhe për kulturën shqiptare, por edhe për ata individë që dëshironin të mësonin italishten. Ai iu mundëson lexuesve shqiptarë të lexojnë dhe shkruajnë në gjuhën italiane. Edhe pse drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi i fjalorit pasqyrojnë të folmen e Shkodrës, ai vlerësohet për përpjekjen për t'u ngritur mbi dialektet dhe për të filluar bashkimin gjuhësor.²⁶⁰

Në 100-vjetorin e Fjalorit të shoqërisë «Bashkimi», në vitin 2008, ka dalë botimi anastatik i tij në parathënien e të cilit Xhevat Lloshi veçon disa vlerësime për fjalorin:

- vjeljen e literaturës si metoda themelore e leksikologjisë moderne;
- prirjen drejt normatizimit;
- përpjekjen për të gjetur barasvlerëse shqipe për turqizmat;
- përfshirjen e varianteve për të mos lënë jashtë fjalë që nuk i përkisnin shkodranishtes;
- mospërcaktimin e prejardhjes krahinore, çfarë nxjerr si qëllim parësor të autorëve pasurinë e gjuhës shqipe;
- përpjekjen për të dhënë togfjalësha;
- praninë e shprehjeve idiomatike;²⁶¹

Fjalorë të tjerë shqip-italisht me më shumë njësi leksikore dhe frazeologjike janë hartuar në vitet pasues nga të cilët mund të përmendim:

- *Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese: il nuovo "Jungg"* (Fjalori shqip-italisht dhe italisht-shqip) i Fulvio Kordinjanos, botuar në Milano, 1930.

- *Dizionario Albanese-Italiano* (Fjalori shqip-italisht) i Anxhelo Leotit, me rreth 30.000 fjalë dhe 2500 proverba, botuar në Romë, Instituti për Evropën Orientale, në vitin 1937 i cili, sipas Norbert Joklit, nuk është thjesht një listë fjalësh, por një pasqyrë besnike e gjuhës shqipe dhe e zhvillimeve të saj pas shpalljes së Pavarësisë dhe ka përfshirë edhe fjalë që nuk ishin në fjalorët para tij. Është bazuar në dialektin toskë, por ka edhe fjalë nga dialekti gegë.²⁶²

- *Fjalori i arbëreshëve të Italisë shqip-italisht* me rreth 20.000 fjalë nga Emanuel Xhordano, botuar në vitin 1963;

- *Vocabolario albanese-italiano. Fjalor shqip-italisht* nga Carmen B. Massolini dhe Ubaldo Buttafava, botuar në Romë nga shtëpia botuese A. Signorelli, 1979;

260 Brunilda Dashi, *Italianismi nella lingua Albanese*, Edizioni Nuova Cultura, Roma, 2013, f. 4.

261 Xhevat Lloshi, *Parathënie e botimit anastatik në «Fjalori i Bashkimit»: botim anastatik i «Fjalor i Rii i Shcypës»: perbâam Préie Shocniét i 'Bashkimit/* përg. Nikë Ukgjini, Frano Kulli, Gjergj Fishta, 2008, f. IX.

262 Gabriele Mazzitelli, *Le pubblicazioni dell'Istituto per l'Europa orientale: Catalogo storico* (1921-1944), Firenze University Press, Firenze, 2016, f. 206.

- *Fjalor shqip-italisht. Dizionario albanese-italiano* nga Zef Simoni dhe Ferdinand Leka, botuar nga Çabej MÇM; Besa në vitin 1995;
- *Fjalor shqip-italisht: 27.000 fjalë* nga Abedin Preza, botuar në vitin 1996;
- *Fjalor shqip-italisht: rreth 30.000 fjalë. Vocabolario Albanese-italiano: circa 30.000 parole* nga Myzafer Kallajxhi dhe Nimete Karamani, botuar nga shtëpia botuese Toena; Botimet Enciklopedike, në vitin 1998;
- *Fjalor shqip-italisht: rreth 20.000 fjalë, Vocabolario Albanese-italiano: circa 20.000 vocaboli* nga Fatmir Toçi dhe Shpëtim Çuçka nga shtëpia botuese Toena, në vitin 2001;
- *Fjalor shqip-italisht: rreth 40.000 fjalë* nga Zef Simoni dhe Ferdinand Leka, botuar nga shtëpia botuese Infbotues, në vitin 2003;
- *Fjalor i madh shqip-italisht: 50.000 fjalë, 145.000 shembuj dhe shprehje, 1080 fjalë të urta* nga Abedin Preza dhe Ervin Preza, botuar nga shtëpia botuese Elena Gjika në vitin 2005;
- *Fjalor shqip-italisht italisht-shqip: rreth 15.000 fjalë* nga Luan Kaceli, botuar nga shtëpia botuese Ada, në vitin 2006.

Përfundime

Në vitin 1899, u themelua shoqëria letrare «Bashkimi», e Shkodrës, pjesëtarë të së cilës ishin figura të shquara të kulturës dhe letërsisë shqipe, por edhe të klerit katolik. Në programin e saj, shoqëria kishte përcaktuar disa detyra: hartimin e një alfabeti, të një fjalori dhe një gramatike të gjuhës shqipe, të një abetareje dhe teksteve mësimore, si dhe botimin e letërsisë artistike apo nxjerrjen e ndonjë periodiku. Themelimi i shoqërisë e gjeti gjuhën shqipe në vështirësi për mbijetesë, lëvrimi dhe shkrimi i të cilës pengohej edhe nga shumësia e alfabeve që ishin në përdorim. Në Veri përdorej alfabeti i Autorëve të vjetër, bejtexhinjtë përdornin alfabetin arab, ndërsa Thimi Mitko dhe Kristoforidhi, në Jug, përdornin alfabetin grek. Kësaj liste mund t'i shtojmë edhe alfabetet origjinale të Dhaskal Todrit, Naum Veqilharxhit, Hoxhë Tahsinut e Vasil Dhimitrit Rusos, çka e çorientonte lexuesin shqiptar të kohës.

Në përpjekje për të zgjidhur këtë problem, patriotët shqiptarë në Stamboll, vendosën për një alfabet të përbashkët (Alfabeti i Stambollit), alfabet latin me 36 shkronja, ndërtuar mbi parimin *një shkronjë për një tingull*. Në vitin 1899, shoqëria «Bashkimi» hartoi alfabetin e saj të bazuar mbi sistemin e shkrimtarëve të vjetër. Dy vjet pas alfabetit të «Bashkimit», edhe shoqëria «Agimi», nën drejtimin e Mjedës, hartoi një alfabet të bazuar në parimin *një tingull një shkronjë*. Deri në këtë kohë, përdorimi i një alfabeti mbi një zgjedhje individuale e secilit, pa mbajtur një qëndrim të qartë në debatin mbi alfabetin.

Çështja e alfabetit u bë shumë problematike dhe për ta zgjidhur atë u vendos thirrja

e Kongresit të Manastirit (14-22 nëntor 1908), synimi i të cilit ishte njësimi i alfabetit. Pjesë e nismës për alfabetin u bë edhe shoqëria «Bashkimi», por jo vetëm si pjesë e debatit, por edhe si ofruese e njërit prej tre modeleve që prezantoi ky Kongres. Dy variantet e tjera që Kongresi mori në shqyrtim ishin alfabeti i «Stambollit» dhe ai i shoqërisë «Agimi». Për caktimin e një alfabeti njësues kishte tre mundësi: një alfabet i ri, një kombinim i tre alfabeleve ose përshtatja e ndonjërit prej tyre. Komisioni ra dakord për një alfabet të ri, me shkronja latine dhe doli me dy variante: një variant të ndryshuar të alfabetit të Stambollit dhe një alfabet latin, pothuaj të ngjashëm me alfabetin e shoqërisë «Bashkimi», që u konsiderua si më praktik për shtypjen e librave jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, për të ruajtur kompromisin u mor diçka edhe nga fjalori i De Radës. Elementët kryesorë të këtij alfabeti të Manastirit ishin: *dh, th, ll, rr, sh* nga alfabeti i «Bashkimit»; *y, ç, c, q, z, x* nga alfabeti i «Stambollit»; dhe *ë, gj, nj* nga alfabeti i De Radës. Ky alfabet sillte disa zhvillime pozitive për kohën: i përfaqësonte më mirë fonetikisht zanoret dhe bashkëtingëlloret e shqipes; me njësimin ortografik që realizonte zgjeronte mundësinë e receptimit të njëtrajtshëm të kulturës shqiptare në arealin shqipfolës, por jo vetëm; ndërsa baza e tij me shkronja latine lehtësonte kontaktet e shqiptarëve me jetën moderne dhe me mendimin e Evropës Perëndimore.

Alfabeti i «Bashkimit» nxiti polemika edhe në shtypin shqiptar të kohës, brenda dhe jashtë vendit prej të cilit mori mbështetje dhe kritika, kur revista e periodikë botonin shkrime që e miratonin apo e kritikonin. Ndër mbështetësit mund të përmendim Faik Konicën, Asdrenin, Aleksandër Xhuvani. Jehonë pati edhe ndër botues të huaj, kështu një artikull në gazetën *LA NAZIONE ALBANESE*, do ta vlerësonte shoqërinë «Bashkimi» si një nga tre institucionet më të rëndësishme për gjuhën shqipe, bashkë me revistën «Albania» të Londrës dhe «Shqiptari» i Bukureshtit, alfabetet e të cilave ishin bazuar në shkronjat latine.

Gjatë pushtimit osman, filluan të botoheshin fjalorët dygjuhësh, të cilët jo vetëm i shërbenin ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës shqipe, por bashkë me tekstet e tjera (përkthime apo përshtatje liturgjike, poezi) formonin lëndën e parë letrare shqiptare. Në vitin 1908, shoqëria «Bashkimi», botoi *Fjaluer i Rii i Shcypes* i cili u hartua nën dritën e programit të Rilindjes Kombëtare, për kultivimin e gjuhës shqipe të shkruar letrare dhe zhvillimit të studimeve albanistike. Para fjalorit të shoqërisë «Bashkimi» kishte një traditë në hartimin e fjalorëve dygjuhësh, pasi ishin botuar: fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit *Dictionarium latino-epiroticum, una cum nonnullis usitationibus loquendi formulis* (1635); *Fjaluer i voghel, sccq p e ltinisctështë* (1895) i Jak Junkut; *Lexikon tës albanikës glossesi* (*Fjalori i gjuhës shqipe* 1904), i Konstandin Kritoforidhit. Hartimi i fjalorëve dygjuhësh gjatë kësaj periudhe u zhvillua për disa arsye: i shërbenin ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës shqipe, kur ajo kërcënohej nga zhdukja; nxitën interesin e gjuhëtarëve evropianë për gjuhën shqipe; u mbështetën nga fuqitë evropiane, të cilat përmes tyre përpiqeshin të përhapnin gjuhët e tyre, për të rritur ndikimin në Shqipëri.

Fjaluer i Rii i Shcypes u përdor për tekste shkollore të shkollave katolike, subvencionuar nga qeveria austro-hungareze dhe konsiderohet nga fjalorët e parë

dygjuhësh, pasi shumë fjalë të tij shpjegohen vetëm përmes italishtes. Lënda e tij është bazuar në të folmen shkodrane, në trashëgiminë e veprës së shkruar nga Autorët vjetër të Veriut, por edhe nga studiues të huaj dhe albanologë. Një pjesë e konsiderueshme e fjalëve të tij gjenden edhe në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe* të vitit 1980. Qëllimi parësor i hartuesve të *Fjaluer i Rii i Shcypes*, ka qenë krijimi i një fjalori shqip, por duke qenë se shumë fjalë shpjegohen vetëm në italisht, fjalori është konsideruar si dygjuhësh. Struktura e fjalorit përbëhet nga parathënia, zërat edhe tre pasqyra për të lehtësuar përdorimin e fjalorit, të cilat përcjellin informacion në tri nivele: sociolinguistik; thjesht gjuhësor dhe gjuhësor - kulturor. Fjalori përfundon me një shtojcë.

Fjalori shquhet për numrin e madh të fjalëve të huazuara në mënyrë të veçantë të turqizmeve, të cilat vlerësohen deri në 12 për qind të lëndës. Disa nga karakteristikat që e dallon këtë fjalor janë: kodifikimi i leksikut të shqipes dhe kontributi në leksikologjinë shqipe; përfshirja e një lëndë deri diku të zgjedhur; fjalët jepen në çerdhen e tyre, d.m.th emri, mbiemri, folja, ndajfolja, emrat foljorë vijnë nga e njëjta rrënjë; kriter i renditjes së fjalëve në fjalësin (glosarin) e tij, është rendi i zakonshëm, pra fjalët janë vendosur sipas rendit alfabetik; fjalët janë vënë në trajtën përfaqësuese të tyre dhe janë shoqëruar me shënimet gramatikore për pjesën e ligjëratës. Fjalori është organizuar sipas një skeme fikse: fjala në trajtën e pashquar, trajta e shquar ose nyja formuese e mbiemrit, shënimet gramatikore, trajta e shumësit, shkurtimi i emrit të autorit nga është vjelë fjala, pas tyre në rastin e fjalës së huazuar vendoset simboli përkatës, shpjegimi në shqip ose sinonimet dhe në fund shpjegimi apo sinonimet në italisht dhe shembuj.

Ndonëse ky fjalor nuk shquhet për ndonjë dobi të madhe pragmatike, pasi mund të përdorej vetëm nga marrësi shqiptar që kishte njohuri të gjuhës italiane dhe ata që dëshironin të mësonin italishten (numri i të cilëve ishte i vogël), vlera e tij qëndron në: mbledhjen e literaturës në funksion të leksikologjisë moderne; prirjen drejt normatizimit; përpjekjen për të zëvendësuar turqizmat me fjalë shqip; përfshirjen e varianteve që nuk i përkisnin shkodranishtes; mospërcaktimin e prejardhjes krahinore; prania e togfjalëshave dhe e shprehjeve idiomatike.

Fjalori «Bashkimit» u ndoq nga fjalorë të tjerë shqip-italisht të cilët kontribuan me shtimin e njësive leksikore dhe frazeologjike në leksikografinë shqiptare.


BIBLIOGRAFIA:

UKGJINI N. & KULLI F. & FISHTA GJ. (2008), *Fjalori i Bashkimit: botim anastatik i «Fjaluer i Rii i Shcypës»: perbâam Prëie Shocniët t' Bashkimit*.

ČAKA N. & ČAKA A., *Fjalori i Bashkimit në prizmin e gjuhës së sotme shqipe*, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Filologjisë Universiteti i Prishtinës, Kosovë.

CABEJ E. (2008), *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Çabej, Tiranë.

ČAKA PALOK L. & TOMOR O. & GJINAJ M. (2008) *Bibliografi për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe 1844-2008*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë.




THE ROUTLEDGE HANDBOOK OF LANGUAGE AND INTERCULTURAL COMMUNICATION

(Manuali i Routledge-it i Gjuhës dhe
Komunikimit Ndërkulturor)

Viti i botimit: 2020

Manuali i Routledge-it i Gjuhës dhe Komunikimit Ndërkulturor, një vëllim multidisiplinor, që mbush hapësirat mes demarkacioneve kombëtare dhe shërben si urë, ofron një studim gjithëpërfshirës historik të studimeve që kanë të bëjnë me gjuhën dhe komunikimin ndërkulturor, një vlerësim kritik të teorisë si në të shkuarën ashtu dhe në ditët e sotme, të hulumtimit dhe praktikës, si dhe hedh dritë mbi drejtimit që sjell e ardhmja.

Ky botim paraqet punën e disa studiuesve të rëndësishëm nga vende të ndryshme të botës; këta autorë vijnë me shumë kontribute të reja me një gamë të gjerë temash, ku përfshihen reflektimi dhe kritika, translinguizmi, raportet e drejta sociale në lidhje me komunikimin ndërkulturor. Ky libër ngre çështje, sjell qasje, larmi dhe polifoni të traditave dhe hap perspektiva që lidhen me këtë fushë gjithnjë e më të rëndësishme, pjesë e botës ku jetojmë. Mbi tridhjetë kapituj të mbushur me shembuj nga gjuhë, vende dhe kontekste kërkimore nga më të ndryshmet, ky manual kthehet në një domosdoshmëri për studentë, studiues apo profesionistë që janë të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo me fushat e komunikimit ndërkulturor, gjuhësisë së aplikuar dhe studimeve të komunikimit.




CULTURAL
CONCEPTUALIZATIONS IN
TRANSLATION AND LANGUAGE
APPLICATIONS

(Konceptualizimet kulturore në përkthim
dhe në aplikimet gjuhësore)

Viti i botimit: 2020

Ky libër përqendrohet në dukurinë e konceptualizimeve kulturore në përkthim dhe në aplikime të ndryshme gjuhësore, përfshirë këtu edhe mësimin e gjuhës së huaj - Gjuhësia kulturore është një qasje e re e studimeve gjuhësore. Në këtë botim diskutohen dukuritë shoqërore dhe konjuktive në kontekste të ndryshme si mësimdhënia e gjuhëve të huaja, modelet kulturore dhe gjuha e shenjave, duke i ilustruar ato me të dhëna të pasura empirike. Del në pah karakteri ndërdisiplinor që hedh dritë të re mbi dukuritë e gjuhës dhe kulturës që lidhen me dukurinë e konceptualizimit kulturor. Në pjesën e parë Përkthimi dhe Kultura punimet mbulojnë temat e një qasje njohëse për konceptualizimet e gjuhës burimore - përballë gjuhës mbërritëse - tekste të ndryshme të përkthyer, tekste mediatike dhe letrare. Në pjesën e dytë Modelet e Aplikuara Kulturore, punimet diskutojnë konceptualizimet kulturore të gjuhës në kuadrin mësimor, veçanërisht të mësimin të gjuhëve të huaja, në komunikimin me anë të internetit dhe komunikimin me ata që nuk dëgjojnë.




RESEARCH AND PROFESSIONAL PRACTICE IN SPECIALISED TRANSLATION

(Kërkim dhe praktikë profesionale në përkthimin e specializuar)

Viti i botimit: 2020

Përkthimi i specializuar ka marrë shumë pak vëmendje nga studiuesit akademikë, por në fakt përbën pjesën më të madhe të përkthimit profesional në shkallë botërore dhe mësohet në programe përkthimi gjithnjë e më të shumta në nivel universitar. Ky libër synon të ofrojë tre gjëra. Në radhë të parë, na jep një përshkrim të asaj që e bën qasjen ndaj përkthimit të specializuar të shquhet nga qasjet e tjera të Studimeve mbi përkthimin. Së dyti, ky libër eksploron një këndvështrim mbi përkthimin e specializuar që është shumë më pak i përqendruar tek terminologjia dhe më shumë te funksioni dhe pranimi i teksteve të specializuara (të përkthyer), ndryshe kjo, nga qasja tradicionale ndaj përkthimit të specializuar. Së treti autori përshkruan një qasje praktike të orientuar profesionalisht kah mësimdhënia e përkthimit të specializuar që vjen nga një përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie me studentët. Libri do të jetë me interes për studentët dhe studiuesit e Studimeve të Përkthimit, si edhe për përkthyesit profesionistë të cilët janë të interesuar për teorinë mbi të cilën bazohet puna e tyre përkthimore.




THE ART OF MODELLING THE
LEARNING PROCESS
UNITING EDUCATIONAL
RESEARCH AND PRACTICE

(Arti i modelimit i procesit të të mësuarit
Bashkimi i kërkimit edukativ me praktikën)

Viti i botimit: 2020

Libri bashkon konceptet dhe metodat kryesore të edukimit, psikologjisë, statistikës, ekonometrisë, mjekësisë, gjuhës dhe shkencave forenzike duke na ofruar një qasje metodike ndërdisiplinore për të studiuar proceset e të nxënës në mënyrë gjatësore. Kjo qasje mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë proceset e të mësuarit, mësimin në të ardhmen, ashtu edhe për të riparë përmbajtjen dhe formatet arsimore, mund të ndihmojë në nxitjen e aftësive të vetë-rregullimit të të nxënës.

Pjesa e parë e këtij teksti përqendrohet në pyetje të ndryshme kërkimore, si dhe pyetje që nisen nga praktika, që mund t'u referohen grupeve apo studentëve. Vazhdon me një diskutim mbi llojet e ndryshme të variablave të rezultateve në kërkimin dhe praktikën arsimore. Për secilin nga këto lloje të variablave të rezultateve, ofrohen skenarë të një matjeje të vetme ose të matjes së përsëritur me shembuj të qartë. Libri pastaj prezanton ndërvarësinë transversale dhe gjatësore të variablave që lidhen me nxënien. Përfundon me disa udhëzime të përgjithshme si nga ana kërkimore ashtu edhe praktike. Ky tekst është tepër i domosdoshëm për të gjithë ata që janë të interesuar për procesin e të nxënës tek njeriu.




TRANSFORMING UNIVERSITIES
WITH DIGITAL DISTANCE
EDUCATION

(Transformimi i Universiteteve me
Edukim digjital në distancë)

Viti i botimit: 2020

Libri Transformimi i Universiteteve me Edukim digjital në distancë trajton sistemet dhe praktikat që do të ndihmojnë menaxherët dhe vendimmarrësit të arrijnë që një institucion të funksionojë me sukses dhe të jetë gjithnjë në rritje, të mos ketë kapacitete të pamjaftueshme, kosto të larta dhe produkte të zakonshme — drejt zbatimit në nivele makro dhe operacioneve të efektshme për një sistem sa më të suksesshëm të komunikimit dhe mësimdhënies on line.

Në këtë botim shpalosen mënyrat e ndryshme të cilat palët e interesit të arsimit të lartë mund t'i aplikojnë dhe të përfitojnë nga mësimi on line me anë të internetit. Futja në sistem, shkalla dhe cilësia janë qëllime të arritshme, por kërkojnë mënyra të punës në grup dhe modele financiare përtej atyre që ofrohen. Ky libër ofron një diskurs të shkëlqyer dhe gati shterues për zhvillimin e arsimit digjital në distancë bazuar në përvojën e autorit me bashkëpunime on line në një sërë institucionesh të arsimit të lartë në mbarë botën. Libri është i ndërtuar në mënyrë të tillë që e çon lexuesin në një udhëtim zbulimi të arsimit digjital ku u kërkohet lexuesve të reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe të kuptojnë ku ndodhen në këtë udhëtim. Mark Nichols ka shtuar zërin e tij në listën (e shkurtër) të atyre që janë pjesë e arsimit të lartë që kanë pranuar mosfunksionimin e universitetit tradicional në përpjekje për reforma strukturore dhe pedagogjike, aplikim të metodave të sistemeve për mësimdhënien, si dhe menaxhimin e burimeve, për universitete të hapura.



TRANSLATION AND TRANSMIGRATION

(Përkthimi dhe transmigrimi)

Viti i botimit: 2020

Në botën tonë të globalizuar dhe transkulturore është më se e zakonshme të jetojmë mes gjuhëve të ndryshme, të kapërcejmë shpesh kufijtë gjeografikë dhe kulturorë, të komunikojmë me njerëz të ndryshëm, biznesmenë, turistë, refugjatë etj. Në këtë libër, Siri Nergaard analizon përkthimin si një përvojë personale, intime e një subjekti që jeton në gjuhë dhe kultura të ndryshme dhe e sheh të jetuarin në përkthim si një gjendje socio-psikologjike të transmigrimit me përfshirjen e plotë të emocioneve dhe sjelljes. Autorja mbështetet në teoritë e psikologjisë, antropologjisë, studimeve kulturore, semiotikë dhe filozofi, analizon situatat e përkthimit që prekin individët, dhe po ashtu edhe emigrantët. Nergaard shqyrton çështje dhe koncepte që lidhen me figurën e emigrantit, mikpritjen dhe kufirin dhe çfarë do të thotë të jetosh në përkthim. Me shembuj nga dokumentarë, fotografi, ekspozita dhe dëshmi, shembuj të jetës në përkthim përmes një larmie mënyrash dhe shprehjesh.

Ky është një libër shumë i rëndësishëm për studiuesit dhe studentët që janë të fushës së përkthimit dhe interpretimit, antropologjisë, studimeve të emigracionit dhe fushave të ngjashme.

Nergaard me Përkthimin dhe Transmigracionin, na sjell idetë e saj vërtet të shkëlqyera, duke shtyrë më tej jo vetëm kufijtë e teorive të përkthimit, por edhe të të gjitha studimeve të gjuhës, letërsisë, migrimit, emigrimit dhe kombit. Monolingvizmi e bëri detyrën e vet; jemi në epokën e re dhe emocionuese të përkthimit.

AKTIVITETE SHKENCORE NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA

Departamenti i Gjuhës Frënge në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Greke dhe, me mbështetjen e Ambasadës Greke në Shqipëri, organizuan në datën 2 mars 2020 konferencën me titull “Huazimet nga gjuha greke moderne tek gjuha frënge”. Referati u mbajt nga Prof. Anna Anastasiadis – Syméonidis e Universitetit “Aristoteli” i Selanikut të Greqisë. Kjo konferencë u ndoq me shumë interes jo vetëm nga pedagogët, por edhe nga studentët e departamenteve përkatëse duke dëshmuar kështu rëndësinë e madh që ka fenomeni i huazimeve gjuhësore, i cili lind nga kontakti mes gjuhëve dhe kulturave të ndryshme dhe çon në shkëmbimin dhe pasurimin e tyre.

* * *

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe të Leximit si edhe, me mbështetjen e Ambasadën Franceze në Tiranë, organizoi në datën 29 tetor 2020 një takim letrar me shkrimtarë, përkthyes dhe studiues, takim ky i konceptuar si një ndalesë dhe pikëtakimi mes letërsive franceze dhe asaj shqiptare. Ky aktivitet u dedikoej studentëve, të cilët nuk munguan të merrnin pjesë duke sfiduar zymtësinë e situatës së vështirë që po kalonte vendi në atë kohë.

* * *

Departamenti i Gjuhës Spanjolle në bashkëpunim me Universitetin e Ankarasë dhe Universitetin e Stambollit organizoi në datë 12 nëntor 2020 ‘Simpoziumin e III Ndërkombëtar mbi Letërsinë dhe Kulturën Hispanike’.

Simpoziumi u zhvillua me sesione të ndryshme në platformën Goolge Meet online dhe pati pjesëmarrës studiues e pedagogë nga Fakulteti Gjuhëve të Huaja dhe nga shtetet si Turqia, Spanja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Serbia, Polonia, etj. Në këtë Simpozium Ndërkombëtar pjesëmarrës ishin edhe studentë të ciklit të dytë master.





**"HUAZIMET NGA GJUHA GREKE MODERNE
TEK GJUHA FRËNGE"**

**"L'EMPRUNT DU GREC MODERNE AU
FRANÇAIS"**



Në kuadrin e muajit të Frankofonisë, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, do të zhvillohet konferenca me titull "Huaizimet nga gjuha greke moderne tek gjuha frënge". "L'emprunt du grec moderne au français", organizuar nga Departamenti i Gjuhës Frënge, Departamenti i Gjuhës Greke dhe Ambasada e Greqisë.

Referati mbahet nga **Prof. Anna Anastasiadis-Symeonidis** e Universitetit "Aristoteli" në Selanik të Greqisë.

Datë 2 mars 2020, ora 12:30
Salla "Evropa"
Godina B, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

We request your presence at our
**3rd International Symposium on Hispanic
Literature and Culture**

2020

www.fgjh.edu.al

**12 NOVEMBER 09 AM –
15:00 PM**

STATE UNIVERSITY OF TIRANA,
Faculty of Foreign Languages,
SPANISH DEPARTMENT
Albania

RSVP
By FCSVBSZ 15th Afl
+355682013559
FTQBOPMGH1@HNB.JM.DPN






**LEXOJMË DHE PËRKTHEJMË
LETËRSINË FRANCEZE**

*Nga Franca në Shqipëri
dhe nga Shqipëria në Francë*

Në kuadrin e muajit të leximit, me mbështetjen e Q.K.L.L., në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja-UT, organizohet një takim letrar i konceptuar si një ndalesë dhe pikëtakimi mes letërsisë frënge dhe asaj shqiptare

29 TETOR 2020, FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA, SALLA "EVROPA", ORA: 11:00



